



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në subjektin Bashkia Dropull

RAPORT
(Auditim Financiar)

Tiranë, 2024

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.	8
II. HYRJA	9
OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.	9
1. Objektivat dhe qëllimi.	9
2. Identifikimi i çështjes.	10
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.	10
4. Përgjegjësitë e audituesve.	11
5. Kriteret e vlerësimit	11
6. Standardet e auditimit	13
7. Metodatat e auditimit	13
8. Dokumentimi i auditimit.	14
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	15
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Dropull”	15
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	16
2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	16
2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	39
2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.	81
2.4 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.	100
IV. REKOMANDIME.....	127

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:

Bashkia Dropull, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Dropull për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Në Raportin e Monitorimit për Buxhetin 2023 të datës 29.02.2024, të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Dropull dhe të dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, janë evidentuar parashikimi sipas PBA 2023-2025, buxheti fillestar 2023, buxheti i rishikuar 2023 dhe realizimi i buxhetit 2023. Nga përlllogaritjet e grupit të auditimit, rezulton se mosrealizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 është në vlerën 42,856 mijë lekë ose i realizuar në masën 84,7%. Niveli i realizimit të të ardhurave, rezulton masën 92.3% ose me mos realizim në shumën 21,616 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Dropull për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese, administruese dhe raportimit financiar, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Organizimi dhe vlerësimi i veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm.
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023.
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 3,848 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik, Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Paragjithja e gjetjeve kryesore.

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

- Bashkia Dropull nuk ka hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për implementimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm sipas komponentëve të MFK. Për periudhën objekt auditimi rezultoi se: nuk ka hartuar PPV dhe SZHV, nuk ka përditësuar Rregulloren e Brendshme sipas strukturës organizative të miratuar, nuk ka planifikuar dhe zhvilluar programe trajnimi për stafin me qëllim përmirësimin cilësor të komunikimit dhe profesionalizmit, nuk ka hartuar regjistrin e unifikuar dhe strategjinë e riskut, gjurmët standarde të auditimit; nuk ka takime të dokumentuara të GMS, plane dhe raporte vjetore mbi problematikat e hasura dhe zgjidhjen që iu është dhënë gjatë veprimtarisë së njësisë publike duke zbehur rolin e tij për arritjen e objektivave të njësisë publike; nuk ka hartuar Listën (hartën)/manualin e proceseve të punës; mosimplementim të sistemeve dhe programeve IT të avancuara veçanërisht në procesin e vjeljes së të ardhurave vendore dhe mirëmbajtjen e atyre ekzistuese për të minimizuar riskun e komprometimit të të dhënave që këto sisteme ruajnë dhe administrojnë; plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacion të përditësuar.

- Bashkia Dropull, në drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, nuk ka plotësuar vendet vakante ku nga 5 punonjës rezulton me 3 punonjës.

- Kryetari i Bashkisë Dropull duke u nisur nga elementët specifikë që NJAB të kësaj njësie publike ka, të marrë masat për plotësimin e strukturës së NJAB konform kuadrit ligjor në fuqi, për të mos cenuar efektivitetin e aktivitetit të saj për periudhën në vijim.

- Nga Bashkia Dropull, PBA 2023-2025 dhe Plani vjetor i buxhetit 2023 janë miratuar sëbashku, duke mos miratuar veçmas Planin Vjetor 2023.

- Bashkia Dropull nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh duke mos i kushtuar rëndësi programit **042** “Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia”.

-Nga analiza e të dhënave të buxhetit rezulton se ka diferenca të dukshme midis treguesve në hartimin e planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të

ardhurave të veta në vlerën 108,507.5 mijë lekë dhe shpenzimeve të tyre në vlerën 84,362 mijë lekë, kështu nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2022 dhe 2023 të ketë mosrealizime, ndonëse vlera e të cilit vjen me trend në rënie nga 61.2% në vitin 2022 në 84.7% në vitin 2023.

- Nga auditimi *rezultoi* se në vitin 2023 janë nisur 13 projekte me burim nga të ardhurat e bashkisë në vlerën totale 145,052 mijë lekë; dhe 6 projekte me burim nga granti në vlerën totale 413,138 mijë lekë; vetëm për vitin 2023 vlera e planifikuar në buxhet për këto investime është 72,113 mijë lekë nga 145,052 mijë lekë të vlerës totale të tyre. Nga analiza e treguesve të tabelës së të ardhurave të veta, rezulton se diferenca mes realizimit faktik të të ardhurave të veta ndaj planifikimit ka trend në rritje si edhe realizimi i të ardhurave të veta; Kjo ka sjellë që në vitin 2023 “Investimet” kundrejt planifikimit të kenë një mosrealizim prej (-)7,819.4 mijë lekë dhe kundrejt faktit të vitit 2022 të jenë prej (-)33,339.2 mijë lekë.

- Në PBA 2023-2025/Planit vjetor 2023, u konstatua se fondi për detyrimet e prapambetura nuk është planifikuar veçmas në programin 04960 “planifikim për detyrimet e prapambetura”, por është përlllogaritur i përfshirë në fondin e secilit program që mbart detyrime; mos ndarja e fondeve sipas programeve përkatëse pra sipas destinacionit të përdorimit, ka sjellë likuidimin pjesor apo të plotë të detyrimeve të prapambetura (sipas rastit) dhe pamundësi likuiditeti të të gjitha faturave për “mallrave e shërbime” e “investimeve” brenda afatit 60 ditor për mungesë fondesh, duke riskuar për lindjen e detyrimeve të reja. Rezultoi se vlera e detyrimeve të prapambetura sipas bilancit përputhet me atë të raportuar në MFE.

- Bashkia Dropull është debitore nga OSHEE tani FSHU për “shërbime” në vlerën debitore progresive 4,480,059 lekë, pagesë e cila bëhet me këste sipas akt marrëveshjes së lidhur mes palëve.

- Për *Taksa e kalimit e të drejtës në pronësi* referuar paketës fiskale, rezulton se për dy vitet e njëpasnjëshme 2022 e 2023 nuk është parashikuar vlerë, për shkak të mungesës së bashkëpunimit me ASHK Rajonale Gjirokastër. Drejtoria e të Ardhurave Vendore *nuk ka bërë* rakordimet me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Gjirokastër (ASHKT), por rakordimet i bën nëpërmjet Degës së Thesarit Gjirokastër.

- Nga auditimi u konstatua se në Rregulloren e brendshme të institucionit të miratuar, nuk është caktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimit nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me agjentët tatimorë, si dhe krijimin e një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët.

- Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mbliidhet nga Agjenti Tatimor “Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) tani ASHK Vendore Gjirokastër”. Deri tani ASHK Vendore Gjirokastër nuk ka patur bashkëpunim me Bashkinë Dropull. Ndonëse nga ana e Bashkisë Dropull kanë vijuar kërkesat nga shtatori i vitit 2023 e deri më 31.12.2023, nuk është arritur asnjë bashkëpunim mes tyre. për dërgim informacioni mbi numrin e kalimeve të pronësisë, vlerën totale të tyre me qëllim rakordimin e vlerës së derdhur nëpërmjet Degës së Thesarit Gjirokastër me vlerën e përlllogaritur. Me kërkesën drejtuar ASHK Drejtoria Qendrore, konfirmohet fillimi i bashkëpunimit midis dy institucioneve, me raportimin listës emërore të procedurave të kalimit të pronësisë së objekteve të paluajtshme. Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “*Për sistemin e taksave vendore*” të ndryshuar, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme tani ASHK Rajonale, janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë si komision 3% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë jo me

vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria. U konstatua se deri në 31.12.2023 rakordimet me ASHK Vendore Gjirokastrë, për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, nuk janë kryer;

- Nga Auditimi mbi evidentimin e detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progressive për vitin 2023 u konstatua se ka diferenca nga viti 2022 në vitin 2023 prej 4,047,294 lekë më pak; duhet theksuar fakti që vlera e detyrimit ka ardhur në rënie për çdo kategori të taksës familjare: Debitor Taksa e ndërtesës nga 1,842,779 lekë në mbyllje të vitit 2022, në 1,547,601 lekë në mbyllje të vitit 2023 pra me një vlerë në rënie prej 295,178 lekë; Debitor Taksa familjare nga 2,409,132 lekë në mbyllje të vitit 2022, në 2,144,517 lekë në mbyllje të vitit 2023 me një vlerë në rënie prej 264,615 lekë; Debitor taksa e tokës bujqësore nga 6,619,233 lekë në mbyllje të vitit 2022 në 3,131,732 lekë në mbyllje të vitit 2023, me një vlerë në rënie prej 3,487,501 lekë; Vlera prej 6,823,850 lekë konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë;

- Nga auditimi rezulton se Bashkia Dropull për vitin 2023 ka patur të njëjtin numër biznesesh prej **225** në total, prej të cilëve 142 janë biznes i vogël dhe 83 janë biznes i madh; janë çregjistruar përgjithmonë 3 biznese; Megjithatë u konstatua se numri i debitorëve nga biznesi i madh dhe ai i vogël kanë ardhur me rritje nga 10 debitorë në total në mbyllje të vitit 2022 me vlerën progresive të debisë prej 901,070 lekë, në 14 debitorë në mbyllje të vitit 2023 me vlerë progresive të debisë prej 1,084,776 lekë. Vlera prej 1,084,776 lekë konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë;

- Për vitin 2023, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në Bashkia Dropull, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program Excel dhe jo me “*Bartës Informatik*”, të cilët janë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera nuk paraqesin besueshmëri duke bartur risk në vetvete pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë, gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, besueshmërinë e të dhënave, cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare.

- Nga 193 objekte inventari të pasurive të paluajtshme me kosto historike që i përkasin llog. 210 “*Toka troje terrene*”, llog. 211 “*Pyje plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” dhe llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, në vlerën 1,389,414,563 lekë, Bashkia Dropull nuk posedon titull pronësie, për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur.

- Bashkia Dropull nuk ka marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, ndërtesa, pyje e kullota për Bashkia Dropull dhe njësitë në varësi.

- Bashkia Dropull nuk ka marrë masat e duhura për të reflektuar në pasqyrat financiare në llogarinë përkatëse në total 25,311Ha (hektarë), nga të cilat 10,641Ha të sipërfaqeve të pyjeve, 14,911Ha të sipërfaqeve të kullotave, 28.1Ha Tokë joproduktive dhe 30Ha shkëmbore e ujore, të kaluara në favor të saj sipas VKM-ve përkatëse.

f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Kryetari i Bashkisë Dropull të marrë masa për përmirësimin e komponentëve të MFK dhe veçanërisht për forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë, nëpërmjet: rritjes dhe forcimit të aktivitetit GMS, të Kordinatorit të MFK dhe Kordinatorit të riskut; përditësimin e Rregullores së brendshme sipas strukturave të miratuara, miratimit të gjurmëve të auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; forcimit dhe standardizimit në implementimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT të avancuara, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe monitorimit në bashki. Të merren masa nga koordinatori i MFK dhe koordinatori i riskut për hartimin e Planit të Përgjithshëm vendor dhe Strategjisë së Zhvillimit vendor duke analizuar grafikun e takimeve për hartimin e raporteve vjetore me qëllim arritjen e objektivave institucionale në shërbim të komunitetit.

- Kryetari i bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik me Koordinatorin e MFK, Koordinatorin e Riskut dhe Drejtoria e financës dhe buxhetit, të marrin masa që me hartimin e PBA-së dhe Planit vjetor të buxhetit, të miratojnë në Këshillin Bashkiak veçmas Planin vjetor të buxhetit; duke i kushtuar vëmendje planifikimit në buxhet të fondeve për ato programe që kanë të bëjnë kryesisht me ndërgjegjësimin mjedisor, shërbimin shëndetësor, tregjet, shërbimin urban, dhe rritjes e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të pyllëzuara.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës dhe buxhetit të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve sipas programeve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

-Kryetari i Bashkisë, GMS me Koordinatorin e riskut dhe Drejtoria e Financës dhe buxhetit, të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrin të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjeve të detyrimeve të reja dhe monitorimit të zbatimit të kontratave për investime/shërbime/malrra; për të paguar rregullisht këstet sipas akt marrëveshjes së lidhur me ish –OSHEE (tani FSHU) për likuidimin e plotë të detyrimit prej 4,480,059 lekë deri në fund të vitit 2024; për likuidimin e faturave për mallra/shërbime/investime duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi për likuidimin e tyre në afat dhe sipas radhës, për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim parandalimin e lindjes së detyrimeve të papambetura dhe deklarimin e vlerës së saktë të tyre në MFE.

- Drejtoria e Financës dhe buxhetit të bëjë planifikim sa më realist të fondeve të çdo programi në PBA dhe Planin vjetor buxhetor, si për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi për likuidimin e tyre brenda afatit të përcaktuar dhe sipas radhës, por edhe për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit ushtrimor.

- Kryetari i bashkisë të caktojë një person përgjegjës për të lidhur marrëveshjet me ato institucione të cilat do të jenë në rolin e agjentit tatimor;

- Drejtoria e Ardhurave vendore Bashkia Dropull të marrë masat për të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Dropull nga taksat që mbledhen nga këta agjentë. Në rast se agjentët tatimor nuk realizojnë sakt mbledhjen e të ardhurave, Bashkia

Dropull të fillojë procedurat për penalizmin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura;

- Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me personin përgjegjës për çështjet ligjore, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore ndaj pesë debitorëve problematikë për arkëtimin e shumës progresive 868,276 lekë.

- Drejtoria e të Ardhurave Vendore të përditësojë planin periodik dhe vjetor të punës për të siguruar vjeljen brenda afateve të përcaktuara të taksave dhe tarifave vendore të vitit ushtrimor si për familjarë edhe për biznesin; për rritjen e arkëtimit nga ana e debitorëve për të minimizuar vlerën progresive të debisë prej 6,823,850 lekë për 947 debitorët familjarë dhe 1,084,776 lekë për 14 debitorët e biznesit;

- Kryetari i Bashkisë Dropull të marrë masa për pajisjen e Drejtorisë së Financës dhe Njësive Vartëse, me programe kompjuterike financiare për mbajtjen e kontabilitetit me qëllim shmangien e risqeve të mundshme të informacionit kontabël.

-Kryetari i Bashkisë Dropull, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masat e duhura për regjistrimin e 193 objekteve të pasurive të paluajtshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim dokumentimin me akte pronësie të aktiveve kapitale në pasqyrat financiare të Njesisë.

-Nga Bashkia Dropull, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, të kryhet analiza e situatës së aktiveve të Njesisë, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, si dhe të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masat e duhura për evidencimin e sipërfaqeve të pyjeve e kullotave të kaluara në administrim të Bashkisë Dropull me VKM përkatëse, edhe nëse ato janë të pa vlerësuara, të evidentohen në shënimet shpjeguese të paqyrave financiare.

- Kryetari i Bashkisë Dropull të marrë masat e menjëherëshme për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë në funksion të proceseve të punës në këtë Bashki.

Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projektraportit, është dërguar me shkresën nr. 431/2 prot datë 27.05.2024 Projektraporti i auditimit. Nga Bashkia Dropull bazuar në shkresën me nr. 455/10 prot., datë 13.06.2024, administruar nga KLSH me nr. 431/3 prot, datë 18.06.2024, janë pranuar rekomandimet e dërguara me Projektraportin e Auditimit nuk është kërkuar që të kryhet takim përmbyllës pranë ambjenteve të KLSH, duke vijuar me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

a- Opinioni i auditimit financiar:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Dropull për vitin ushtrimor nga 01.01.2023 – 31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare vjetore paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të subjektit Bashkia Dropull më 31 dhjetor 2023, referuar kuadrin rregullator; Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik; Standardet

Kombëtare të Kontabilitetit; UMFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinionin e pamodifikuar me theksim të çështjes:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga Subjekti Bashkia Dropull, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej **3,848 mijë lekë**, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021 kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar, fakt ky që përbën bazën për opinion (ISA-705; ISSAI-1705). Këto aspekte nuk konsiderohen materiale, prandaj vetëm meritojnë evidentim, si theksim çështjesh. Për këto arsye kemi dhënë opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në paragrafin e mëposhtëm:

“Theksimi i çështjes”.

-Bashkia Dropull nuk ka marrë masat e duhura për të reflektuar në pasqyrat financiare në llogarinë përkatëse në total 25,311Ha (hektarë), nga të cilat 10,641Ha të sipërfaqeve të pyjeve, 14,911Ha të sipërfaqeve të kullotave, 28.1Ha Tokë joproductive dhe 30Ha shkëmbore e ujore, të kaluara në favor të saj sipas VKM Nr. 433 dt 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 431/1prot., datë 03.04.2024 “Auditim financiar në Bashkinë Dropull”, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 08.04.2024 – 10.05.2024, në subjektin Bashkia Dropull për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2023 - 31.12.2023, u krye “Auditim Financiar” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. E.M., Auditues i lartë, Përgjegjës Grupi
2. S.J., Auditues e parë, anëtare,

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

1. Objektivat dhe qëllimi.

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në këtë fazë të auditimit, hartohet Projektaporti i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Dropull.

2. Identifikimi i çështjes.

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi baza të riskut, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Dropull, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Dropull.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Kryetari i Bashkisë Dropull (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Dropull, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi,

efektivitet dhe efizienzë.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.¹

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

4. Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Dropull në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kutueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Dropull është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*", paragrafi 44-51.

5. Kriteret e vlerësimit

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të

¹ Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, neni 15

Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021”; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” .

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar;

VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

6. Standardet e auditimit.

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

7. Metodatat e auditimit.

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampionëve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*². Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin.

² ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepcave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisë kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

8. Dokumentimi i auditimit.

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur

opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u hartuan dhe u mbajtën 1 aktverifiim dhe 5 aktkonstatime. Nga ana e Bashkisë Dropull nuk janë paraqitur pretendime në lidhje me aktet e mbajtura duke vijuar me hartimin e Projektraportit të Auditimit dhe Informacionit përmbledhës.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Dropull”.

Zona Gjeografike: Dropulli kufizohet në veri me bashkinë Libohovë, në veriperëndim me Bashkinë Gjirokastrë, në perëndim me Bashkinë Devinenë ju me Bashkinë Konispol dhe në juglindje ndodhet pika kufitare e Kakavijës e cila e kufizon me Shtetin Grek. Kryeqendra e Bashkisë është Jorgucati.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 ka një popullsi prej 3.503 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 23.131 banorë. Bashkia Dropull shtrihet në një sipërfaqe prej 466.67 km² me një densitet prej 49.56 banorë/km².

Kjo bashki përbëhet nga 3 njësi administrative, të cilat janë: Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm dhe Pogoni. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Gjirokastrë dhe e qarkut Gjirokastrë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj 41 fshatra.

Të dhëna të tjera: Bashkia e Dropullit përbëhet nga pjesëtarë të pakicës etnike greke në Shqipëri. Derviciani njihen nga vendasit si kryeqendra e zonës, pasi në të zhvillohen pothuajse të gjitha aktivitetet e rëndësishme politike, kulturore dhe fetare të minoritetit. Megjithatë, qendra e komunës do të jetë në Jorgucati, një pikë e ndërmjetme mes dy komunave që ishin më parë.

Zonat e minoritetit kanë njohur viteve të fundit përmirësim të infrastrukturës rrugore në brendësi të fshatrave të vegjël që shtrihen mes kodrave, përgjatë rrugës që lidh Gjirokastrën me Kakavijën. Falë granteve qeveritare, por edhe ndihmave financiare nga Greqia, shumë fshatra kanë zgjidhur edhe problemet e ujit të pijshëm. Por në këto 25 vite të tranzicionit, zonës së Dropullit i është rikthyer plaga e vjetër e emigracionit, vala e parë e së cilës nisi në vitet 20-30. Në fshatrat e Dropullit mungojnë moshat e reja, shumë shtëpi janë mbyllur me vite dhe shumë toka kanë mbetur djerrë. Krahinia e Dropullit ruan një pasuri të rrallë etnokulturore. Zona ka ruajtur dhe transmetuar vallen e bukur të krahinës, kostumet e pasura dhe motivet epirote të klarinetës. Me zbatimin e reformës së re administrative territoriale, disa nga pyjet dhe kullotat iu transferuan Bashkisë së Dropullit.

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;

b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;

c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;

ç) ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;

d) realizimit të shërbimeve në formë të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;

dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;

e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Bashkia Dropull, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Dropull për periudhën e aktivitetit të vitit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe zbatimin e kuadrit rregullator ligjor të raportimit financiar.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

2.1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm;

2.1.3. Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm.

1.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike.

Bazuar në Misionin e Vetëqeverisjes Vendore “për të siguruar qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve” nëpërmjet: zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative; për të rritur cilësinë e jetës si dhe shtuar aktivitetet për t’i shërbyer popullsisë së bashkisë Dropull³; referuar dhe Ligjit nr. 10296 dt. 08.07.2010, kreu III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, neni 19, Bashkia Dropull, për çdo vit ka përgatitur “Deklaratën dhe Pyetëtorin e Vetëvlerësimit” dhe i ka dërguar në MFE/ Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar/ Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit. Më poshtë po i analizojmë në mënyrë të detajuar, duke përcaktuar mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

³ Misioni dhe Vizioni përbëjnë dhe hapin 2 të ciklit të MFK sipas Manualit të MFK miratuar me Urdhër të Ministrisë të Financave nr. 8980/2010 dhe përditësuar me atë nr. 108/2016.

1. Mjedisi i kontrollit

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxherial dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrave, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Referuar nenit 20 të Ligjit nr. 10296 “Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli”, titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Nga auditimi u konstatua se, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, Kreu II, neni 8, pika 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit”; neni 9 pika 4/a “Përgjegjshmëria menaxheriale e Nëpunësit Autorizues”, në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4,2,10/a “Roli i nëpunësit autorizues të njësisë”, **u konstatua se nuk janë hartuar/miratuar**: “Plan i Përgjithshëm Vendor” - [PPV] me Fokus Strategjia e Zhvillimit Vendor, Analiza & Vlerësimi Territorit, Parashikimet e Planit, Vlerësimi Strategjik Mjedisor, Materiali hartografik si dhe “Rregullore e Planit Vendor”, të cilët hartohen si bashkëpunim i Bashkisë me KKT⁴ dhe miratohen me VKB Dropull; Gjithashtu Bashkia Dropull *nuk ka hartuar dhe miratuar* Strategjinë e Zhvillimit Vendor - [SZHV], ku paraqiten synimet kryesore për çdo fushë përgjegjësie dhe identifikohen veprimet që njësia duhet të ndërmarrë për realizimin e tyre, duke parashikuar edhe kostot përkatëse, kjo në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” Kreu VI, neni 32 pika 2/a,b,c.

Qarku	Qendra e Bashkisë Dropull	Njësitë Administrative	Numri i fshatrave	Numri i popullsisë
Gjirokastrë	Sofratikë	Dropull i Sipërm	18	23,131
		Dropull i Poshtëm	16	
		Pogon	7	

Punoi:Grupi i Auditimit

1.1. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

a. Bashkia Dropull ushtron funksionet e veta me Rregulloren e Brendshme “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe procedurat për zbatimin e kompetencave vendore në administratën dhe njësitë administrative të Bashkisë Dropull”, hartimi dhe miratimi i të cilës është mbështetur në zbatimin e Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9 pika 1/1 germa ‘b’, Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak [VKB] të çdo viti respektiv “Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi dhe njësive administrative” si dhe Urdhrit të Kryetarit “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Dropull dhe të Njësive Administrative Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm, Pogon dhe Sektorit të MZHS-së”: Rregullore e miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 7 datë 28.02.2023 dhe nr. 375 prot., datë 28.02.2023 dhe i përket Strukturës Organizative miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 02 datë 04.01.2023 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Dropull dhe të Njësive Administrative Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm, Pogon dhe Sektorit të MZHS-së” me nr. 3 prot., datë 04.01.2023;

⁴ Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) emëruar sipas VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017

Për periudhën nën auditim, ndryshimet në strukturën organizative të miratuara me VKB janë konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, si dhe këto janë pasqyruar në *Rregulloren e brendshme të njësisë*.

b. Mbi respektimin e etikës nga punonjësit e institucionit, Bashkia Dropull nuk ka hartuar dhe miratuar “Kodin e Etikës së Bashkisë Dropull” të veçantë, por në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë e ka pasqyruar të plotë me objekt “Për zbatimin e parimeve të etikës gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”; konform Ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1/1 germa “b”, VKM nr. 306 datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil.

c. Me Urdhër të Kryetarit nr. 8 datë 17.01.2022 dhe me nr. prot., 74 datë 17.01.2022 është hartuar dhe miratuar “Rregulloren e Posaçme për Parandalimin e konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, në zbatim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1/1 germa ‘b’, neni 46; Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar; Kjo Rregullore përcakton rastet e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike dhe ka si qëllim parandalimin e tyre.

“Kodi i Etikës” dhe “Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesit” përcaktojnë rregullat e sjelljes së nëpunësve të administratës publike, sipas standardeve të kërkuara, i ndihmon ata për arritjen e këtyre standardeve si dhe vë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë nëpunësi i administratës publike. Kjo ndikon në mbarëvajtjen e funksionimit të institucionit, duke mos lejuar cenimin e aktivitetit të tij në çdo aspekt.

1.2 Politikat menaxheriale dhe stili i Punës

a. Punësimi në Bashkinë Dropull bëhet në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 243/2015 i ndryshuar me VKM nr. 746/2018 Kreu I pika 1,2.

▪ Kjo procedurë rregullohet nga vet Strukturat e Bashkisë Dropull:

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse [DBNJSHM] është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM nr. 243/2015 i ndryshuar Kreu II;

- Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr. 243/2015 i ndryshuar;

- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pika e,ë,f,g të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Për *vitin 2023* [KPP] në Bashkinë Dropull është ngritur me Urdhër të Kryetarit (për çdo rast) KPP i cili përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë: dy anëtarë të përhershëm Drejtori në DBNJSHM dhe Drejtori në DBFMS, ndërsa 3 (tre) anëtarët e tjerë përfaqësojnë menaxherin kryesor të strukturës që ka nxjerrë shpalljen (1), një (1) akademik dhe një (1) ekspert të fushës, konform VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar me VKM nr. 746/2018, Kreu III pika 2,3.

- Strukturat përgjegjëse të çdo bashkie hartojnë në fillim të çdo viti “Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil dhe miratimin e numrit të aplikantëve jashtë shërbimit civil” në zbatim të Ligjit

nr. 152/2015 “Për nëpunësin civil” neni 18, VKM nr. 108/2014 “Për plani vjetor të pranimit në shërbimin civil”, të atyre me Kontratë Pune konform Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë” i ndryshuar, VKB “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Dropull”. Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil hartohet mbi nevojat e institucionit për personel për vitin e ri ushtrimor dhe përmban: numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës vakante të hapura për konkurrim, klasifikimin e tyre për çdo kategori dhe klasë, vendin e publikimit. Për vitin 2023 është miratuar me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë nr. 1 datë 04.01.2023 dhe nr. 6 prot., datë 04.01.2023. Publikimi i vendeve vakante nga ana e Bashkisë Dropull bëhet në faqen zyrtare të saj, në Portalin Kombëtar të Punësimit të AKPA si dhe në stendat për njoftime publike të Institucionit, konform kuadrit ligjor në fuqi.

- Përshkrimin e punës të çdo pozicioni si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët, duhet të jenë të përshkruara në Formularin e Përshkrimit të Pozicionit të Punës. Ato janë pjesë e rëndësishme e politikave dhe praktikave që lidhen me burimet njerëzore. Si të tilla *Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë kriteret dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit*. Për këto arsye kriteret duhet të jenë pjesë në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, neni “përshkrimet e punës” si dhe e dosjes së personelit. [DBNJSHB]⁵ nga ana e saj pasi harton planin vjetor të punësimit, ndjek procedurën nga shpallja e njoftimit deri në përfundimin e saj, praktikë e cila në përfundim bëhet pjesë e dosjes së personelit.

Në Bashkinë Dropull struktura organizative ka pësuar ndryshime, të cilat janë miratuar me Vendim të Kryetarit së Bashkisë, pasqyruar edhe në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të saj. DBNJSHB si struktura përgjegjëse për personelin, harton çdo fillim viti Planin Vjetor të pranimit në shërbimin civil për Bashkinë Dropull, në përputhje me Strukturat organizative të çdo viti, të miratuara nga Kryetari i Bashkisë me emërtimet e pozicioneve përkatëse. Vendimet janë konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

- Struktura organizative e Bashkisë Dropull për dy vitet 2022 dhe 2023 ka këtë kompozim:

Nr	Viti	Numri drejtorive	Numri sektorëve	Numri i punonjësve
1	2022	6	9	158
2	2023	7	13	165

Shpërndarja e pozicioneve në strukturën organizative për vitet 2022 e 2023 sipas ligjit që rregullon marrëdhëniet e punës, pasqyrohet si më poshtë:

Niveli pozicionit	Status i Nëpunësit Civil 2022 2023	Vende vakante 2022 2023	Kodi i Punës 2022 / 2023
Kategori e lartë	0 0	0 0	2
E mesme drejtuese	6 7	0 2	3
E ulët drejtuese	5 8	0 4	1
Ekzekutive	26 26	3 7	24
Totali	37 41	3 13	27

Burimi: Bashkia Dropull

⁵ Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme

- Nga informacioni shkresor i vënë në dispozicion, rezultoi se numri i largimeve të punonjësve për arsye të ndryshme në Bashkinë Dropull ka qenë i konsiderueshëm.

Një pasqyrim më i detajuar i numrit me arsyen e largimeve, jepet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Arsyeja e lirimit të vendeve	2022	Punësimi 2022	2023	Punësimi 2023
1	KMCAP	-		-	
2	Pension	5		9	
3	Largim me dëshirë/dorëheqje	12		6	
4	Shkurtime/ristrukturime	-		-	
5	Zgjidhje Kontrate/përfundim	6		5	
6	Largim për mosparaqitje në punë/ shkelje të përsëritura	4		-	
7	Ndërruar jete	-		-	
8	Refuzim të vendit të punës	-		-	
9	Leje Lindje	-		1	
TOTALI		27	39	21	27

Burimi: Bashkia Dropull

Numri i përgjithshëm i personelit në Bashkinë Dropull, referuar strukturave organizative në planifikim për vitin 2022 është 158 punonjës dhe për vitin 2023 është 165 punonjës.

1.3 Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Dropull funksionon me një Strukturë që bazohet në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”.

A. Organi Përfaqësues i Bashkisë - Këshilli Bashkiak

B. Organi Ekzekutiv i Bashkisë - Kryetari i Bashkisë

Për periudhën 01.01.2023- 31.12.2023 që ne auditojmë, struktura organizative e Bashkisë Dropull ka pësuar ndryshime nga ajo e mëparshme, të cilat miratohen me Vendim të Këshillit Bashkiak. Një pasqyrim të kompozimit të Strukturës organizative të Bashkisë Dropull paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Viti	VKB / Urdhër Kryetari	Njësi Administrative	Drejtori	Sektor	Punonjës sipas strukturës
2022	Urdhër Kr. nr.2/1 datë. 05.01.2022	3	6	9	158
2023	Urdhër Kr. nr. 2 datë 04.01.2023	3	7	13	165

Burimi: Bashkia Dropull/DABNJ

- Ndryshimet në strukturën e Bashkisë Dropull pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi i strukturës	Nr. sektorëve		Nr. i punonjësve	
		2022	2023	2022	2023
1	Kabineti			8	8
2	Njësia Koordinimit Integritetit Evropian dhe Ndihmës Huaj	1	1	2	2
3	Drejtorja e Buxhetit, Financës dhe Ndihmës sociale	2	2	11	11
4	Drejtorja e Shërbimit Urban dhe Shërbimeve publike + IMTV	3	2	24	8
5	Drejtorja e Shërbimeve Publike	-	1	-	27
6	Drejtorja e të Ardhurave	1	1	6	6
7	Drejtorja e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	2	2	10	9

8	Drejtoria e Auditimit të Brendshëm	1	1	5	5
9	Drejtoria e Administrimit të Ujrave, pyjeve, livadheve dhe kullotave	1	1	16	23
10	Policia Bashkiake	1	1	7	7
11	MZSH	1	1	17	16
12	NJA Dropull i Poshtëm	1	1	18	12
13	NJA Dropull i Sipërm	1	1	14	14
14	NJA Pogon	1	1	7	7
15	Arsimi parashkollor & parauniversitar	-	-	8	9
16	Gjendja civile	-	-	-	-

Punoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar edhe në tabelat e mësipërme **u konstatua** se:

1. Në vitin 2023 ka patur rikompozim të strukturës organizative me krijimin e drejtorive të reja dhe ndryshim të numrit të punonjësve në disa prej tyre, ndryshime të cilat nuk janë pasqyruar në rregulloren e Brendshme të Bashkisë Dropull;

2. Në strukturën organizative të Bashkisë Dropull nuk janë përfshirë punonjësit e gjendjes civile.

- Ndërsa shpërndarja e punonjësve në strukturën organizative sipas njësive përbërëse të saj, pasqyrohen si më poshtë:

STRUKTURA		2023	
		PLAN	FAKT
1	Administrata e Bashkisë me Njësi Varësie	133	122
2	NJA Dropull i Poshtëm	11	11
3	NJA Dropull i Sipërm	14	14
4	NJA Pogon	7	7
VENDE VAKANTE		11	
TOTALI		165	154

Burimi: Bashkia Dropull/DBNJ

Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2023 janë punësuar pesë (5) punonjës sezonalë, në pozicionin “punëtor për menaxhimin e liqeneve” në Drejtorinë e Administrimit të Ujrave, pyjeve, livadheve dhe kullotave / Bashkia Dropull, konform kuadrit ligjor në fuqi.

- Referuar Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” mbi funksionet e bashkive, po japim një pasqyrim se si është kompozuar Struktura e Bashkisë Dropull për vitin 2023, në zbatim të funksioneve që i jep ky ligj.

Emërtimi i funksionit	Shërbimet	Njësia përgjegjëse në Strukturë/ Njësi Varësie
	- Për Ujin e pijshëm	- Ujësjiellës SHA
	- Ujërat e ndotura, ujerat e shiut, mirëmbajtje e rrugëve, varrezat publike, etj	- Drejtoria e Shërbimit Urban dhe e Shërbimeve Publike
1. Infrastruktura dhe Shërbimet Publike - neni 23	- Dekori, gjelbërimi, etj.	-Njësitë Administrative: Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm, Pogon
	- Planifikim, zhvillim, kontrolli i territorit	
	- Sistemi arsimor parashkollor dhe bazë	- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve mbështetëse
	- Shërbimi parësor shëndetësor	
2. Shërbimet sociale neni 24	- Shërbimet sociale	- Drejtoria e Buxhetit, e Financës dhe e Mbrojtjes

		Sociale
3. Kultura, sporti dhe shërbimet argëtuese - neni 25	- Trashëgimia kulturore, identiteti lokal, biblioteka, Sporti, turizmi, kopshte, çerdhe etj	- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Shërbimeve Mbështetëse
4. Mjedisi - neni 26	- Ajri, toka, uji, zhurmat, aktivitete edukuese	- Drejtoria e Administrimit të Ujrave, të Pyjeve, të Livadheve dhe Kullotave
5. Bujqësi, pyje, kullota, natyrë, biodiversitet - neni 27	- Infrastrukturë e ujitje kullimit, toka bujqësore, informimi bujqësor e blegtoral, skemat e granteve, pyje & kullota, natyra & biodiversiteti	
6. Ekonomia vendore - neni 28	- Plane strategjike, tregjet, biznesi i vogël, grante për biznesin, informim publik etj.	- Drejtoria e të Ardhurave - Njësia për Koordinim e integrim Evropian / Zyra me një Ndalesë
7. Siguria publike - neni 29	- Mbrojtja civile, emergjencat civile, parandalim dhe zgjidhje konflikti, kundërvajtjet administrative, - Shërbimi zjarrfikës	- Policia Bashkiake - DSHP - IMTV - MZSH
8. Kompetenca të Deleguara - neni 30		- Gjendja Civile

Punoi: Grupi i Auditimit

Nga auditimi i strukturave organizative që ka kompozuar Bashkia me të cilat ka ushtruar funksionet e veta konform kompetencave që i jep ligji, **u konstatua** se ka shërbime të cilat nuk mbulohen me njësi përkatëse në strukturë, duke riskuar mungesën e ofrimit të tyre për komunitetin: “shërbimi parësor shëndetësor” i funksionit “infrastruktura dhe shërbimet publike” dhe funksioni “Mjedisi” të cilët nuk kanë njësi në strukturën organizative dhe as specialist përgjegjës për këto shërbime; shërbimi “mbrojtja civile”⁶ ka vetëm një specialist përgjegjës për transportin dhe emergjencat civile në DSHP.

1.4 Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Bashkia Dropull aktivitetin e saj funksional e mbështet në Rregulloren e Brendshme, e miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 7 datë 28.02.2023 dhe nr. 375 prot., datë 28.02.2023, e cila i përket Strukturës Organizative miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 02 datë 04.01.2023 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Dropull dhe të Njësive Administrative Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm, Pogon dhe Sektorit të MZHS-së” me nr. 3 prot., datë 04.01.2023;

Për periudhën nën auditim, ndryshimet në strukturën organizative të miratuara me VKB janë konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, si dhe këto janë pasqyruar në *Rregulloren e brendshme të njësisë*.

1.5 Aftësitë profesionale të punonjësve.

Për të audituar dosjet e personelit, përzgjedhëm dosjet e të punësuarve për vitin 2023 në aparatin e bashkisë dhe Njësive Administrative për kategoritë: ngritje në detyrë, pranim në shërbimin civil, me Kod pune; si dhe dosjet e punonjësve të larguar nga Bashkia Dropull. Emërimet/largimet i janë nënshtruar, Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”.

⁶ Në zbatim të Ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile” i shfuqizuar me Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”

a. *Mbi rregullsinë dhe plotësinë e dosjeve të personelit* përzgjedhëm kryesisht dosjet e të punësuarve në vitin 2023 në aparatit e bashkisë dhe në ndërmarrjet e varësisë për kategoritë: ngritje në detyrë, pranim në shërbimin civil, me Kod pune; si dhe dosjet e punonjësve të larguar nga Bashkia Dropull. Emërimet/largimet i janë nënshtruar, Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”. Rezultoi se dosjet përgjithësisht përmbanin dokumentet bazë të punonjësit, por **u konstatua** se për punonjësit që i janë nënshtruar procedurave “lëvizje paralele” apo “ngritje në detyrë” nuk ishte krijuar praktikë (fashikull) e veçantë e dokumenteve të përditësuara të punonjësit për pozicionin e ri, si pjesë përbërëse e dosjes kryesore të personelit.

- *Dosjet e punonjësve të larguar* në praktikën e plotë të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga njoftimi deri në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, mungonte procesverbali i dorëzimit të bazës materiale që ka patur punonjësi në ngarkim;

Për të gjitha këto konstatime, nuk janë zbatuar: VKM nr. 117 datë 5.3.2014 Lidhja 1 e 2 i ndryshuar me VKM nr. 833/2020 “ Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” Kreu VII, XIV. etj

b *Mbi trajnimin e punonjësve në Bashkinë Dropull.*

Stafi administrativ ka zhvilluar trajnime sipas programeve të detyrueshëm ofruar nga ASPA pjesë e procedurës për përfundimin e statusit të nëpunësit civil dhe jo vetëm. Nga auditimi **rezultoi** se nga Bashkia Dropull, struktura përgjegjëse e saj [DBNJSHM] ka hartuar Planin vjetor të trajnimeve për punonjësit e saj, dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë me nr. 695 prot., datë 28.04.2023; trajnimet e punonjësve realizohen nga programet që ofron ASPA, duke patur kështu një orientim mbi rëndësinë në përzgjedhjen e atyre temave që lidhen ngushtë me proceset e punës të përditshmërisë; me qëllim njohja nga ana e tyre me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Manualin për MFK.

2. Menaxhimi i Riskut

2.1 Regjistri i Riskut Grupi i auditimit lidhur me menaxhimin e riskut, kërkoi t’i vihet në dispozicion Regjistri i riskut, ku jepet një pasqyrim i identifikimit të risqeve të çdo njësie të strukturës dhe masat që duhen marrë për parandalimin apo minimizimin e pasojave në Bashkinë Dropull nga Drejtoria e Buxhetit, Financës dhe Mbrojtjes Sociale ka hartuar dhe miratuar Regjistrin e vet të Riskut me nr. 2345 prot., datë 17.12.2020, ku është bërë i mundur identifikimi i risqeve që vijnë nga burime të brendshme dhe atyre që vijnë nga burime të jashtme, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

Regjistri i Riskut është i bazuar në analizën e riskut të çdo drejtorie dhe ka si *Synim* “*Planifikimin dhe Përdorimin me efikasitet, efikasitet dhe transparencë të fondeve buxhetore në përputhje me misionin e Bashkisë, për arritjen e objektivave*”. Ky regjistër përmban përshkrimin e risqeve për çdo drejtori/sector, nivelin e risqeve, kontrollet ekzistuese, veprimet e ndërmarra për të adresuar risqet, zotëruesi i riskut si dhe situatën e riskut pas detyrës së fundit, si dhe mënyrën apo rrugëzgjdhjen e situatës në rastin e ndodhjes apo konstatimit të dukurisë.

Konstatim: Nga Bashkia Dropull nuk është hartuar Regjistri i Riskut i unifikuar i njësisë, në moszbatim të Ligjit 10296 dt. 08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 dt. 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të Riskut në njësitë publike”.

➤ Bashkia Dropull ka ngritur *Grupin e Menaxhimit Strategjik [GMS]* me Vendimin e Kryetarit nr. 1 datë 24.01.2022 me nr. 137 prot., datë 24.01.2022 “Për ngritjen e GMS dhe caktimin e EMP në Bashkinë Dropull, në kuadër të përgatitjes së PBA 2023-2025”. Për vitin 2023 për arsye të mosndryshimit të menaxherëve të njësisë publike dhe të programeve buxhetore, Vendimi i Kryetarit i miratuar për vitin 2022 ka qenë i vlefshëm edhe për vitin 2023.

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Statusi në GMS
1	Dh.T.	Kryetar i Bashkisë	Kryetar
2	P.Dh.	N/Kryetar	Koordinator MFK Koordinator Risku
3	P.	N/Kryetar	Anëtar
4	Th.	Dr. Financës	NZ/Sekretar
5	L.Xh.	Dr. Ardhurave	Anëtar
6	A.T.	Dr. Shërbimeve Urbane	-/-
7	A.	Dr. BNJSHB	-/-
8	L.N.	Dr. Shërbimeve Bujqësi	-/-
9	A.	Përgjegjës MZSH	-/-
10	J.	Përgjegjës DSHP	-/-
11	E.	Përgjegjës AKS	-/-
12	K.	Përgjegjës Buxheti & Ndhima ekonomike	-/-

Burimi: Bashkia Dropull

Nga auditimi rezultoi se GMS ka realizuar takime vetëm për përgatitjen e PBA -së dhe Projekt Planit vjetor të Buxhetit, ka hartuar dhe miratuar planin e punës dhe grafikun e takimeve për përgatitjen e PBA dhe buxhetin e vitit pasardhës me nr. 39 prot., datë 10.01.2022 (për vitin 2023), raportin vjetor të analizës së aktivitetit të GMS për përgatitjen e PBA 2023-2025 me nr. 114 prot., datë 20.01.2023; *rezultoi* se nuk ka takime të tjera të dokumentuara të aktivitetit të tij, nuk ka plan vjetor pune dhe grafik takimesh rrjedhimisht as raporte vjetore të aktivitetit të tij, të përcaktuara në Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manualin e MFK Kap. II/2.2.6 ku citohet: *../...GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të garantojë se komponentët e MFK-së dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësisë. GMS duhet të zhvillojë aktivitetet e mëposhtme:*

- Të nxisë realizimin e objektivave dhe qëllimeve strategjike të njësisë;
- Të garantojë se brenda njësisë ekziston një kuadër i përshtatshëm dhe efektiv i MFK, që siguron vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve;
- Të kuptojë se si njësia realizon objektivat e MFK;
- Të rishikojë procesin e menaxhimit të riskut;
- Të garantojë se drejtuesit dhe punonjësit e njësisë janë të pajisur me aftësitë dhe udhëzimet e nevojshme për të vënë në zbatim kontrole të brendshme efektive dhe për të menaxhuar risqet;
- Të shqyrtojë nëse mjedisi i kontrollit dhe procedurat mund t’i përmbushin objektivat e tyre;
- Të vendosë standardet dhe vlerat e njësisë;
- Të verifikojë raportet e audituesve mbi MFK dhe përputhshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore;
- Të përcaktojë nëse janë raportuar dobësi materiale, kushte të tjera të raportueshme, apo gjetje të tjera;
- Të rishikojë përmirësimet e sugjeruara për MFK si dhe të ndjekë në vazhdimësi korrigjimin e dobësive në kontrollin e brendshëm;
- Të verifikojë deklaratën e titullarit të njësisë mbi sistemin e kontrollit të brendshëm;

- Të udhëheqë dhe të mbikqyrë procesin e ndryshimit, që shton kapacitetin e njësisë për të punuar me rezultate të larta”; Si dhe.../... “Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të mblidhet të paktën katër herë në vit. Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t’i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë”.

Nr	Viti	Nr. Anëtarëve GMS	EMP	Nr. i Programeve	Nr. Anëtarëve EMP
1	2021	12	8	13	27
2	2022	12	8	13	28
3	2023				

Konstatim: GMS/Bashkia Dropull si çdo vit ka hartuar planin e punës dhe grafikun e takimeve për përgatitjen e PBA dhe buxhetin e vitit pasardhës, duke e kufizuar aktivitetin e GMS vetëm për përgatitjen e buxheteve të njësisë. Kjo ka ardhur si rezultat i mos pasjes mjaftueshëm të njohurive rreth rolit të GMS, duke mos realizuar takime të dokumentuara të GMS për rolin dhe aktivitetin e tij në shërbim të Njësisë publike, si dhe mos përpilimit të raportit vjetor mbi aktivitetin e tij, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Kap II neni 8, pika 8/b; nenit 27 pika 1,2; dhe “Manualin e Menaxhimit financiar dhe kontrollin” miratuar nga Ministri MFE me nr. 8980 /2010 dhe ai i ri me nr. 108/2016 Kap II pika 2.2.6.

2.2 Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.

Duhet theksuar se në procesin e miratimit të planeve vjetore të punës, duhet të merren parasysh risqet më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu e rëndësishme është që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike. Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut.

Nga auditimi **u konstatua** se në lidhje me identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut, nga Bashkia Dropull nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut, në moszbatim të Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Manualit të MFK, Kap. III, paragrafi 3.2..

2.3 Gjurmët e Auditimit janë një instrument mbështetës për menaxhimin e njësisë. Gjurmët e Auditimit përfshijnë operacione të cilat nisin dhe përfundojnë brenda një strukture organizative, por që mund të përshkojnë gjatë rrugës së tyre, disa struktura organizative, dhe madje disa njësi. Gjurma e Auditimit informon mbi: Përshkrimin e qartë të ecurisë së operacionit; Gjurmimin e operacionit prej fillimit në fund; Të gjithë dokumentet që janë marrë ose janë gjeneruar gjatë procesit; Aktivitetet e rëndësishme të kontrollit, që garantojnë ecurinë e duhur të operacionit; Kush e merr një vendim të caktuar gjatë ecurisë së operacionit; Sistemet e IT-së që mbështesin operacionin; Kush mban përgjegjësinë finale për procesin – veçanërisht në rastet kur në kryerjen e një operacioni marrin pjesë disa njësi organizative.

Konstatim: Nga auditimi rezulton se, gjurmët standarde të auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari i njësisë, si një dokument *i unifikuar* për të gjitha proceset e Bashkisë Dropull, në kundërshtim kjo me ligjin nr. 10296/2010 i ndryshuar, neni 16 pika 2; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” kapitulli V; Udhëzimit nr. 30 dt. 27.12.2011 i ndryshuar, neni 121 e 122. » Lidhur me Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Sistemeve IT, nga specialisti IT i Bashkisë Dropull, u vu në dispozicion ky informacion është sipas tabelës në PRA.

▪ Nga specialisti IT çdo vit paraqiten në Drejtorinë e financës kërkesat buxhetore mbi nevojat institucionale për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe pajisjeve IT. Kështu për vitin 2023, kërkesat buxhetore janë si më poshtë:

Shpenzime Operative	Plan	Fakt	
Lidhje Internet	180,000	139,000	
Mirëmbajtje, shërbime pajisje informatike	150,000	40,450	
Nëntotali	330,000	179,450	54.4%
Shpenzime për Investime			
Pajisje Informatike	0	0	
Nëntotali	0	0	0
Totali	330,000	179,450	54.4%

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelat respektive, **rezultoi** se nuk është bërë analizë e mirëfilltë mbi nevojat e atyre strukturave të njësisë për programe të avancuara, me qëllim rritjen e efektivitetit të shërbimeve, si në rastin e administrimit dhe menaxhimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore etj.

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe komunikimi mbi implementimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT, rezultoi se nga ana e bashkisë janë marrë masat dhe situatë është përmirësuar lidhur me standartizimin e infrastrukturës IT, por u **konstatua** se *nuk janë* zhvilluar programe trajnimi për përdoruesit e sistemeve IT, *nuk është mundësuar* pjesëmarrja për trajnim e specialistit IT.

2.4.Lista (Harta) e Proceseve/Manuali i Procedurave të punës.

Pamja e përgjithshme e procesit përmban një vështrim të përgjithshëm të aktiviteteve dhe procedurave që parashikojnë mënyrën e realizimit të proceseve të veçanta, sikurse dhe dokumentacionin që përdoret gjatë ecurisë së tyre. Ajo garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit, që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të procesit; shkresat/ formularët tip si dhe disa Seksione të tjera plotësuese të tyre (procedurave).

Konstatim: Bashkia Dropull nuk ka hartuar listën (hartën)/manualin e proceseve të punës, në moszbatim të Ligjit nr. 10296 /2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 dhe Manualin e ri me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108/2016 Kapitulli III pika 3.3.

3. Veprimtaritë e Kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Proceset kryesore të punës janë të shkruara në rregulloren e brendshme ku në bazë të strukturës së miratuar ekziston dhe ndarja e detyrave.

Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhet të jenë: Të përshtatshme; Efektive nga pikëpamja e koston; Të gjithanshme; Të dokumentuara qartë etj.

▪ Në Bashkinë Dropull për realizimin e objektivave me efikasitet, ekzistojnë dhe përdoren manuale për proceset kryesore operacionale dhe financiare, të cilët specifikojnë qarkullimin e dokumentacionit:

Nr.	Sektorët	Manualet që përdoren
1	Sektori i Financës	» Manuali i Klasifikimit të llogarive
		» Manuali i pasqyrave financiare
2	Drejtoria e Shërbimit Urban dhe Shërbimeve Publike	» Manuali teknik i punimeve të ndërtimit në fuqi, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015” Për miratimin e manualeve teknike të punimeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave të tyre.
3	Njësia e Prokurimit	» Manuali mbi prokurimin elektronik në SPE të blerjeve me vlerë të vogël
		» Manuali mbi përdorimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE)

Lloji i Kontrollit që duhet të zbatohen në çdo njësi publike janë: parandalues dhe pas faktit. Në Bashkinë Dropull kontrollet pas faktit realizohen nga NJAB të Bashkisë etj., pra jo nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit; ndërsa ato parandaluese janë dhe paraqiten si më poshtë vijon:

a. Kontrole në shqyrtimin e dokumentacionit që nënshkruhet, praktika e saj dhe verifikohet saktësia e materialit;

b. Ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person (NA-NZ);

c. Të gjitha angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA&NZ (sistemi i dy firmave);

d. Çdo dalje e Aktiveve afatgjata autorizohet dhe monitorohet nga NA; kontroll i dokumenteve të inventarëve, regjistrave financiarë, librat e kontabilitetit etj.

e. Ka rregullore për Sistemet IT të cilat *iu janë vënë* në dispozicion çdo përdoruesi;

f. Parashikuar procedura të qarta mbi komunikimin e shkresave brenda dhe jashtë Bashkisë: hyrja, trajtimi, mbajtja e dokumentacionit lidhur me depozitimin e protokollimin, komunikimin shkresor dhe elektronik;

g. Komunikimi dhe trajtimi urdhrave të brendshëm dhe udhëzimeve përshtatur sipas përgjegjësive individuale të çdo pozicioni;

h. Institucioni ka parashikuar politika të ruajtjes së dokumenteve, ka një plan masash për trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin gjatë punës;

i. Bashkia Dropull ka hartuar dhe ka miratuar nga Titullari në cilësinë e NA, Manualin e proceseve për menaxhimin e aktiveve vendore” me nr. 1926 prot., datë 29.12.2023. Ky dokument është një kombinim i “Manualit të proceseve të punës” dhe Rregullores për menaxhimin e aktiveve të Bashkisë, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik.

j.1 Bashkia Dropull me Urdhër e Kryetarit nr. 1222 datë 11.07.2017 dhe nr. 3006 prot., datë 11.07.2017, ka miratuar Rregullore “Për hetimin administrativ të sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga njësia e sinjalizimit” me nr.22/3 prot. Datë 07.01.2020, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, neni 13 pika 10;

2. Ka hartuar Rregullore “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja nga njësia e sinjalizimit” shoqëruar me regjistrin, formulari tip I dhe tip II, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” neni 19 pika 8;

Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, grupit të auditimit iu vu në dispozicion raporti vjetor i dërguar në ILDKPKI⁷ me nr. 50/1 prot., datë 11.01.2024 për vitin 2023, i cili rezulton pa raste sinjalizimi të brendshëm, për pasojë dhe asnjë rast për mbrojtje të sinjalizuesit; Deri më 31.12.2023 në bashkinë Dropull nuk ka patur raste informacioni nga njësia e sinjalizimit;

k. Bashkia Skrapar ka faqen e saj zyrtare në web me adresë <https://www.bashkiadropull.gov.al/> dhe pasaportën e Bashkisë në Portalin Porta Vendore me adresë <https://portavendore.al/bashkia-Dropull/pasaporta-e-bashkise-Dropull/>, të cilat përdorin një lidhje të sigurt (connectionsecurity) HTTPS (HyperTextTransferProtocolSecure), që do të thotë se serveri i faqes së internetit përdor një certifikatë sigurie, për të vërtetuar identitetin e internetit në shfletuesit e ndryshëm;

» **Plani i Kontrollit të Brendshëm** është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen. Mungesa e planeve të kontrollit kanë ndikuar dhe në mos monitorimin e detyrave që menaxherët i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre;

Konstatim: Nga Bashkia Dropull nuk është hartuar/miraturar një Plan i Kontrollit të Brendshëm periodik apo vjetor, kjo në moszbatim të nenit 22, pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, “Manualit për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”Kapitulli III pika 3.3.

4. Informacioni dhe Komunikimi.

Drejtuesit e institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit; si dhe gjatë vitit 2023 nuk kanë kryer trajnime mbi Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të organizuar nga ASPA. Mungesa e realizimit të takimeve të GMS dhe e trajnimeve të stafit për njohjen dhe zbatimin e ligjit “Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ka riskuar harmonizimin në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e detyrave gjatë procedurave apo proceseve brenda sektorëve/drejtorive si dhe ndërmjet sektorëve/drejtorive me drejtorinë ligjore, me qëllim ruajtjen e komunikimit ndërmjet njësite brenda strukturës së Bashkisë, Bashkisë me njësitë Administrative dhe Bashkisë me institucione të tjera publike dhe jo vetëm. Informacioni shkëmbehet në nivel Horizontal dhe Vertikal. Bashkia Dropull disponon një Rregullore të Brendshme hartuar dhe miraturar mbështetur strukturës organizative me të cilën funksionon bashkia sipas VKB-ve përkatëse.

a. Në Bashkinë Dropull me Urdhrin e Kryetarit nr. 74 datë 23.08.2019, është caktuar *Koordinatori për Informim dhe Koordinatori i Transparencës* konform Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 15, 16 dhe Ligjit nr. 119/2014 “Për Informimin Publik”. Koordinatori për Informim ka përpiluar raporte periodike 6 mujore dhe i ka përcjellë te titullari. Pra një detyrim i vërtetë i Koordinatorit është se ai krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve sipas shkronja b, pika 2 e nenit 10. Çdo informacion dhe njoftim publikohen në WEB-in e Bashkisë Dropull.

Mos hartimi dhe mos miratimi i Manualit të Procedurave dhe i Gjurmëve të Auditimit të unifikuar të njësisë, mos përditësimi i Rregullores së brendshme referuar strukturës organizative të miraturar me ndryshime, riskon të pasurit e një komunikimi jo shumë efektiv e harmonik, si dhe paqartësi në ndarjen e detyrave dhe monitorimin e zbatimit të tyre;

b. Buxheti diskutohet në të gjitha nivelet e Institucionit (edhe ato të varësisë);

c. Zhvillohen analiza vjetore të arritjeve të objektivave të Bashkisë Dropull;

⁷ Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

- d. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve mbështetëse, është përgjegjëse për komunikimin me Subjektet kryesore të jashtme (ka korrespondencë shkresore zyrtare dhe elektronike sipas rastit) si dhe e çdo dokumenti administrativ (operacional e financiar) në institucion; ajo përzgjedh formën e komunikimit (shkresor të protokolluar apo elektronik) sipas rastit. Duhet të aplikohet rregullisht komunikimi elektronik ose shkresor (komunikim i brendshëm), duke evituar komunikimin verbal me qëllim forcimin e gjurmës së auditimit;
- e. Çdo muaj bëhet akt rakodimi me Degën e Thesarit dhe raportimi i bëhet Titullarit të Bashkisë (NA);
- f. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për çdo problem apo paqartësi, në rrugë shkresore të protokolluar dhe elektronike.

5. Monitorimi

Mos hartimi i gjurmëve të auditimit dhe mos përditësimi i rregullores së brendshme, ka sjellë një proces monitorimi jo efektiv, pasqyruar kjo në aktivitetin e kufizuar të GMS dhe rrjedhimisht në hartimin e raporteve vjetore vetëm për përgatitjen e PBA, të mungesës së dokumentimit të raporteve periodike të menaxherëve të nivelit të ulët dhe të mesëm mbi ecurinë dhe realizimin e produkteve të njësisë publike (bashkisë), si dhe identifikimin e fushave të cilat nuk janë realizuar në masën e pritshme, duke analizuar dhe shkaqet përkatëse. Ky raportim duhet të bëhet nga personi përgjegjës i çdo drejtorie tek eprori dhe eprorët ia përcjellin titullarit, në cilësinë e NA dhe Kryetarit të GMS. Raportimi mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë, përmban informacione dhe evidenca të ndryshme, ku bazohet dhe Raporti 4, 8 mujor dhe vjetor i monitorimit, i cili i dërgohet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ky Raportim bëhet në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 68 /2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, nenit 65 të ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë” e të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22/2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore” dërgohet në Këshillin Bashkiak dhe MFE: Për vitin 2023 mbi raportimin e zbatimit të buxhetit për 4 mujorin e I (janar-prill) me shkresën nr. 764 prot., datë 19.05.2023; për 8 mujorin (janar-gusht) me shkresën nr. 1387 prot., datë 26.09.2023 dhe atë vjetor me shkresën nr. 335/1 prot., dt. 29.02.2024; Raportet për në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të sistemeve të kontrollit të cilat përmbajnë: Pyetësorin e Vetëvlerësimit, Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Regjistrin e Menaxhimit të Riskut, Raporti për Funkcionimin e Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm, Plani i Veprimit për MFK; Gjithashtu nga ana e Bashkisë Dropull: “Drejtoria e Shërbimit Urban” dhe “Drejtoria e Administrimit të Ujrave, Pyjeve, Livadhe dhe Kullotave” raportojnë çdo vit te Agjencia Kombëtare e Mjedisit/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në zbatim të Ligjit nr. 10431/2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar, Ligjit nr. 10463/2011 “Për Menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar si dhe VKM nr. 687/2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”. Çdo akt administrativ i Bashkisë Dropull publikohet në faqen zyrtare të saj konform kjo Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” Kreu VI, neni 15 dhe Programit të Transparencës konform ligjit nr. 119/2014 “Për informimin publik”.

Duke analizuar me kujdes të gjitha procedurat që ndiqen në funksion të arritjes së objektivave të Bashkisë, **u konstatua** se baza rregullatore mbi të cilën mbështetet aktiviteti funksional i saj, është e paplotë për rrugët që duhen ndjekur në konturimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit, duke e parë si sistem dinamik (të jetë koherent me çdo akt ligjor apo nënligjor që miratohet). Kjo arrihet duke forcuar aktivitetin e GMS, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të

punës për çdo drejtori dhe njësi varësie dhe atë të koordinatorit të MFK dhe të riskut, në zbatim të Ligjit nr. 10296 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Manualit MFK, Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të riskut”, me qëllim që të mund të kontrollojnë, të konstatojnë dhe të sistemojnë në kohë reale edhe parregullsinë më të vogël të procedurave të përditshme, duke minimizuar riskun e kthimit të tyre në fenomen.

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera në Bashkinë Dropull është si më poshtë vijon:

Mjedisi i kontrollit:

1. Kryetari i Bashkisë Dropull dhe GMS *nuk kanë hartuar dhe miratuar*: “Planin e Përgjithshëm Vendor” - [PPV] me Fokus Strategjia e Zhvillimit Vendor, Analiza & Vlerësimi Territorit, Parashikimet e Planit, Vlerësimi Strategjik Mjedisor, Materiali hartografik si dhe “Rregullore e Planit Vendor”, si bashkëpunim i Bashkisë me KKT⁸ dhe miratohen me VKB Dropull; Gjithashtu Bashkia Dropull *nuk ka hartuar* Strategjinë e Zhvillimit Vendor - [SZHV], ku paraqiten synimet kryesore për çdo fushë përgjegjësie dhe identifikohen veprimet që njësia duhet të ndërmarrë për realizimin e tyre, duke parashikuar edhe kostot përkatëse;

2. Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelat e strukturave organizative u konstatua se:- Në vitin 2023 ka patur rikompozim të strukturës organizative me krijimin e drejtorive të reja dhe ndryshim të numrit të punonjësve në disa prej tyre, ndryshime të cilat *nuk janë reflektuar* në rregulloren e Brendshme të Bashkisë Dropull;

- Në strukturën organizative të Bashkisë Dropull nuk janë përfshirë punonjësit e gjendjes civile.

3. Nga auditimi i strukturave organizative që ka kompozuar Bashkia Dropull, nga verifikimet e dokumentacionit dhe analiza e informacionit të pasqyruar edhe në tabelë, rezultoi se ka shërbime të cilat nuk mbulohen me njësi përkatëse në strukturë, duke riskuar mungesën e ofrimit të tyre për komunitetin: “Shërbimi parësor shëndetësor” i funksionit “Infrastruktura dhe shërbimet publike” (neni 23) dhe funksioni “Mbrojtja e Mjedisit” (neni 26) të cilët nuk kanë njësi në strukturën organizative dhe as specialist përgjegjës për këto shërbime; shërbimi “mbrojtja civile” ka vetëm një specialist përgjegjës për transportin dhe emergjencat civile në strukturën e DSHP;

Pra Bashkia Dropull në fillim të vitit 2023 e në vijim nuk ka funksionuar me një strukturë organizative që i mbulon të gjitha funksionet/nënfunksionet për të ofruar të gjitha shërbimet komunitetit, duke ushtruar kompetencat që i atribuon Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Kreu VII në nenet 23-30;

4. Nga testi me zgjedhje të dosjeve të personelit (kampioni që përzgjedhëm), emëruar/larguar në 2023 rezultoi se përgjithësisht dosjet e personelit përmbanin dokumentacionin përkatës të dosjeve, por u konstatuan edhe këto mangësi:

- Në *dosjet e personelit* për punonjësit që i janë nënshtruar procedurave “lëvizje paralele” apo “ngritje në detyrë” nuk ishte krijuar praktikë (fashikull) e veçantë e dokumenteve të përditësuara të punonjësit për pozicionin e ri, si pjesë përbërëse e dosjes kryesore të personelit.

- *Dosjet e punonjësve të larguar* në praktikën e plotë të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga njoftimi deri në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, mungonte procesverbali i dorëzimit të bazës materiale që ka patur punonjësi në ngarkim;

⁸ Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) emëruar sipas VKM-së Nr. 519, datë 20.09.2017

Për të gjitha këto konstatime, nuk janë zbatuar: Ligji nr. 152/2013 i ndryshuar “Për nëpunësin civil” neni 17 pika 1,4; VKM nr. 117, datë 5.3.2014 Lidhja 1 e 2 e ndryshuar; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” Kreu VII, XIV.

5. Nëpunësi Autorizues dhe struktura përgjegjëse e bashkisë Dropull/Drejtoria e Administrimit dhe Burimeve Njerëzore, kanë hartuar dhe miratuar plane vjetore për trajnimin e stafit në programet e ofruara nga ASPA, por nuk ka hartuar programe vjetore për trajnimin e punonjësve mbi njohjen dhe zbatimin e kodit të etikës, mirëmbajtjen edhe përdorimin e pajisjeve IT etj, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e komunikimit brenda institucionit dhe në cilësinë e shërbimeve ndaj komunitetit, këto në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 64 pika h, Ligjit nr. 10296 /2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar dhe “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Kapitulli III pika 3.1

Menaxhimi i riskut:

6 Nga Bashkia Dropull nuk është hartuar Regjistri i Riskut *i unifikuar* i njësisë, në moszbatim të Ligjit 10296 dt. 08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 dt. 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të Riskut në njësitë publike”.

Bashkia Dropull deri më 31.12.2023 nuk ka realizuar takime të dokumentuara të GMS për rolin dhe aktivitetin e tij në shërbim të Njësisë publike, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Kreu II neni 8, pika 8/b; nenit 27 pika 1,2; dhe “Manualin e Menaxhimit financiar dhe kontrollin” miratuar nga Ministri MFE me nr. 8980 /2010 dhe ai i ri me nr. 108/2016 Kapitulli II pika 2.2.6.

7. GMS/Bashkia Dropull si çdo vit ka hartuar planin e punës dhe grafikun e takimeve për përgatitjen e PBA dhe buxhetin e vitit pasardhës, duke e kufizuar aktivitetin e GMS vetëm për përgatitjen e buxheteve të njësisë. Kjo ka ardhur si rezultat i mos pasjes njaftueshëm të njohurive rreth rolit të GMS, duke mos realizuar takime të dokumentuara të GMS për rolin dhe aktivitetin e tij në shërbim të Njësisë publike, si dhe mos përpilimit të raportit vjetor mbi aktivitetin e tij, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Kap II neni 8, pika 8/b; nenit 27 pika 1,2; dhe “Manualin e Menaxhimit financiar dhe kontrollin” miratuar nga Ministri MFE me nr. 8980 /2010 dhe ai i ri me nr. 108/2016 Kap II pika 2.2.6.

8. U konstatua se në lidhje me identifikimin e riskut, vlerësimin e riskut, adresimin e riskut dhe shqyrtimin e riskut, nga Bashkia Dropull nuk është hartuar *strategjia e menaxhimit të riskut*, në moszbatim të Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Manualit të MFK, Kap. III, paragrafi 3.2.

9. Nga auditimi rezultoi se, *gjurmët standarde të auditimit* nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari i njësisë, si një dokument *i unifikuar* për të gjitha proceset e Bashkisë Dropull, në kundërshtim kjo me ligjin nr. 10296/2010 i ndryshuar, neni 16 pika 2; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” kapitulli V; Udhëzimit nr. 30 dt. 27.12.2011 i ndryshuar, neni 121 e122.

10. Nga verifikimi i dokumentacionit dhe komunikimi mbi implementimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT, u konstatua se:

- *nuk është bërë* analizë e mirëfilltë mbi nevojat e atyre strukturave të njësisë për programe të avancuara, me qëllim rritjen e efektivitetit të shërbimeve, si në rastin e administrimit dhe menaxhimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore etj.
- *nuk janë* zhvilluar programe trajnimi për përdoruesit e sistemeve IT, *nuk është mundësuar* pjesëmarrja për trajnim e specialistit IT.

11. Bashkia Dropull nuk ka hartuar listën (hartën)/manualin e proceseve të punës, në moszbatim të Ligjit nr. 10296 /2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 dhe Manualin e ri me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108/2016 Kapitulli III pika 3.3;

Veprimtaritë e kontrollit:

12. Nga Bashkia Dropull nuk është hartuar/miratuar një Plan i Kontrollit të Brendshëm periodik apo vjetor, kjo në moszbatim të nenit 22, pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, “Manualit për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” Kapitulli III pika 3.3. (sipas Aneksit nr. 11).

Informimi dhe komunikimi:

11. Drejtuesit e institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit si dhe nga numri i kufizuar i trajnimeve mbi Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të organizuar nga ASPA; Mungesa e realizimit të takimeve të GMS dhe e trajnimeve të stafit për njohjen dhe zbatimin e ligjit “Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ka riskuar harmonizimin në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e detyrave gjatë procedurave apo proceseve brenda sektorëve/drejtorive si dhe ndërmjet sektorëve/drejtorive me drejtorinë e burimeve njerëzore, me qëllim pasjen dhe ruajtjen e një komunikimi me efektivitet, ndërmjet njësive brenda strukturës së Bashkisë, Bashkisë me ndërmarrjet në varësi të saj dhe Bashkisë me institucione të tjera publike dhe jo vetëm.

Monitorimi:

12. Nga auditimi i procedurave që ndiqen në funksion të arritjes së objektivave të Bashkisë, u konstata se baza rregullatore mbi të cilën mbështetet aktiviteti funksional i saj, është e paplotë për rrugët që duhen ndjekur në konturimin dhe forcimin e sistemeve të kontrollit, duke e parë si sistem dinamik (të jetë koherent me çdo akt ligjor apo nënligjor që miratohet). Kjo arrihet duke forcuar aktivitetin e GMS që është rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie dhe atë të koordinatorit të MFK dhe të Riskut, në zbatim të Ligjit nr. 10296 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Manualit MFK, Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të riskut”; Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; Udhëzimin nr. 16, dt. 20.07,2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Udhëzimi nr. 21/2016 “Për menaxherët e të gjitha niveleve”; Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” Kreu VI, neni 32 pika 2/a,b,c; Ligji nr. 152 datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin civil në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 dt. 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 9 / 3,4 5; neni 11 pika 1/c, e, f; neni 12; neni 19/1,2,3; neni 20; Ligji nr. 10325/2010 “Për bazën e të dhënave shtetërore”; VKM nr. 117 dt. 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” Lidhja 1 e 2 e ndryshuar; VKM nr. 243/2014 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; VKM nr. 142 /2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”; Ligji nr. 119/2014 “Për informimin publik” dhe Udhëzimi i viti 2016 “Mbi detyrat e Koordinatorit të Informimit dhe transparencës”.

1.2. Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm sipas përcaktimeve në VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për Miratimin e kritereve të krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik".

▪ Struktura e Auditimit të Brendshëm, në Bashkinë Dropull, ka filluar funksionimin e saj nga muaji Prill 2016, me emërtimin "Njësia e Auditimit të Brendshëm", e cila që prej vitit 2022 funksionon në nivel drejtorie me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 62, datë 24.11.2021, konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1075/1 datë 09.12.2021.

Kjo strukturë ushtron veprimtarinë e saj në tre Bashki; Dropull, Finiq dhe Libohovë, nëpërmjet akt marrëveshjeve të lidhura midis titullarëve të tre bashkive; Bashkia Dropull dhe Libohovë, me nr. 328/1 prot, të ofertuesit dhe nr. 319 prot, të përfituesit, datë 15.03.2016, miratuar nga Ministri i Financave me shkresën nr. 4152/1 prot, datë 01.04.2016, rikonfirmuar me shkresën e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8447 prot, datë 12.05.2021, si dhe Bashkia Dropull dhe Finiq, me nr. 1333 prot, të ofertuesit dhe nr. 2465 prot, të përfituesit, datë 04.10.2016, miratuar nga Ministri i Financave me shkresën nr. 13475/1 prot, datë 31.10.2016, rikonfirmuar me shkresën e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 17390/1 prot, datë 05.11.2021, kjo në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", nenit 10, shkronja "c", si dhe nenit 64, shkronja "a" të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", pikat 3 dhe 6, të VKM nr. 83, datë 3.2.2016, pika 6 shkronja "a", "Për miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik".

Kuadri rregullator mbi të cilën mbështetet aktiviteti i NJAB Bashkia Dropull, në zbatim të akteve ligjore/nënligjore në fuqi është si mëposhtë:

- Karta e Auditimit të Brendshëm luan rol të rëndësishëm në përmbushjen e objektivave të veprimtarisë audituese të NJAB Bashkia Dropull, është miratuar me Vendimin nr. 1 datë 13.10.2020, me nr. 1916 prot., datë 13.10.2020, dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr. 1916/1 prot., datë 13.10.2020.

- Kodi Etik i Auditimit të Brendshëm ka për qëllim të promovojë një kulturë etike nga ana e Njësisë së Auditimit të Brendshëm. Kodi Etik i NJAB e Bashkisë Dropull është miratuar me Vendimin nr. 2 datë 13.10.2020, me nr. 1915/1 prot., datë 13.10.2020, dhe dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, me shkresën nr. 1915/2 prot., datë 13.10.2020.

- Plani strategjik dhe plani vjetor, janë hartuar sipas kërkesave të nenit 18/2 të seksionit 3, kreu II të Manualit të Auditimit të Brendshëm, si dhe të nenit 14, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Manualin e Auditimit të Brendshëm (kap.III), pika 3.5 "Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm", për vitin 2023, janë miratuar dhe janë dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr. 1773 prot., datë 19.10.2022; Plani vjetor i rishikuar me nr. 1398/1 datë 28.09.2023;

- Plani vjetor i auditimit është dokumenti bazë i veprimtarisë audituese, i cili parashtron kritere e procedura të parashikuara në dispozita ligjore, si; fushat prioritare, frekuencën e auditimeve, përmirësimet e kapaciteteve audituese, zhvillimin e burimeve njerëzore, bilancin e burimeve dhe nevojave për auditim, koston e auditimit, etj.

▪ Njësia e auditimit të brendshëm - [NJAB] në Bashkinë Dropull, është e organizuar në nivel Drejtorie që prej gjysmës së dytë të vitit 2021⁹ me pesë pozicione në strukturë, por funksionon me 3 auditues të brendshëm. Siç u përshkrua edhe më lart, NJAB Bashkia Dropull ushtron veprimtarinë e saj edhe në Bashkitë Libohovë dhe Finiq, për shkak të mungesës së burimeve

⁹ Para Vendimit të KB nr.62 datë 24.11.2021 NJAB ka qenë e organizuar në nivel sektori

njerëzore dhe kërkesave specifike që kërkojnë pozicionet për këtë strukturë, konform kjo kërkesave të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” pikat 3 dhe 6 të, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, rëndësia e të cilës konsiston në faktin se “Njësia e Auditimit të Brendshëm” ka funksion kryesor mbështetjen e menaxhimit të lartë në zbatimin e objektivave, për Bashkinë Dropull, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, germa “c” si dhe nenit 64, germa “a” të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

▪ Përbërja e strukturës së NJAB në Bashkinë Dropull nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

NjAB	Drejtor	Përgjegjës	Specialist Auditues	Kualifikimi profesional	Statusi	Numri i punonjesve Plan / Fakt
Viti 2023	1	1	1	Ekonomist	Me certifikatë	5 3

Burimi: Bashkia Dropull/ NJAB

Referuar ligjit nr.114/2015 “Për Auditin e Brendshëm“ në çdo institucion bazuar në disa kriterë të përcaktuara në VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Mbi Miratimin e Kriterëve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 2 dhe nr. 3 prot., datë 04.01.2023 “Për miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Dropull dhe të Njësive Administrative Dropull i Sipërm, Dropull i Poshtëm, Pogon dhe Sektorit të MZSH-së për vitin 2023”;

Nr	Struktura e NJAB	2022		2023	
		plan	fakt	plan	fakt
1	Drejtor	x	x	x	x
2	Përgjegjës	x	x	x	x
3	Auditues	x	x	x	x
Totali i audituesve në NJAB		5	3	5	3

Nga verifikimi i Strukturave organizative, NJAB e Bashkisë Dropull deri në 31.05.2021 ka qenë e organizuar në nivel sektori me 3 auditues (1+2) dhe me VKM nr. 62 datë 01.06.2021 u organizua në nivel drejtorie (1+4) dhe vazhdon të funksionojë me këtë strukturë. Vendimet e Kryetarit nr. 62 datë 01.06.2021 dhe nr. 3/1 datë 05.01.2022 kanë miratuar strukturën e NJAB konform Ligjit nr.114/2015 “Për Auditin e Brendshëm“ dhe VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Mbi Miratimin e Kriterëve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; Ndonëse janë shpallur vendet vakante në portalin për punësim të AKPA, ende dy vendet vazhdojnë të jenë të paplotësuara. NJAB Bashkia Dropull nisur nga disa elementë specifikë, të tillë si: audituesit e NJAB janë me përvojë të gjatë në fushën e auditimit dhe të çertifikuar, kuadri ligjor në fuqi konkretisht VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” pika 3, ka hapësirë për punësim si specialist auditues të paçertifikuar; informatizimi i shumë proceseve operacionale në bashki dhe shumëllojshmëria e tyre, lind si domosdoshmëri plotësimin e dy vendeve vakante me specialistë të fushave kryesisht ligjore, ekonomike dhe jo vetëm. E gjitha kjo për të mos cenuar efektivitetin e aktivitetit të NJAB për periudhën në vijim.

Të tre audituesit janë të pajisur me çertifikatën e “Audituesit të brendshëm” në zbatim të ligjit nr.114/2015, “Manualit të Auditimit të Brendshëm” miratuar nga Ministër i Financave nr.100/2016 dhe VKM nr. 83/2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

Gjatë periudhës nën auditim, NJAB ka funksionuar dhe vazhdon të funksionojë me këtë personel:

Nr	Periudha	Pozicioni	Vjetërsi në pune	Vjetërsi në auditim	Çertifikimi
	2022-2023				
1.	S.	Drejtori i njësisë	38	32	Në vitin 2005
2.	M.	Përgjegjës sektori	32	27	Në vitin 2005
3.	A.	Auditues	14	5	Në vitin 2019
4	Vakant	-//-	>3	>1	√
5	Vakant	-//-	>3	0	jo

Burimi: Bashkia Dropull/ NJAB

b Trajnimet e [NJAB] dhe certifikimet

Referuar ligjit nr.10296/2010, Manualit të MFK miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr. 8980, dt. 15.07.2010, Manuali i Ri me Urdhrin e Ministrit të FE nr.108/2016 të MFK, Ligjit nr.114/2015 “Mbi Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, nga bashkia Dropull është hartuar një plan vjetor trajnimesh për audituesit e NJAB, referuar planit vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik me Urdhrin nr. 248 datë 31.12.2021; Për vitin 2023 NJAB ka kryer trajnimet si më poshtë vijon:

Nr	Temat e Trajnimit	Periudha
1	Trajnim i detyruar vjetor	30.10-04.11
Jashtë planit vjetor		
2	- Auditim i bazuar në risk “Menaxhim i të ardhurave vendore /Projekti SECO - Menaxhimi i Riskut	29.05-31 05

Burimi: NJAB/ Bashkia Dropull

Trajnimi i audituesve të [NJAB] duhet të përmbushi planin vjetor prej 40 orëve në vit për çdo auditues të certifikuar, përcaktuar dhe programuar nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Kjo për mirëfunksionimin e auditimit të brendshëm në njësinë publike, për të cilën gjatë procedurës audituese, duhet të mbështetet në zbatimin me korrektësi të 7 (shtatë) parimeve të përgjithshme, të cilat janë:

a) ligjshmëria, b) paanësia, c) integriteti, ç) pavarësia dhe objektiviteti, d) profesionalizmi & zhvillimi i vazhdueshëm profesional dh) kompetenca e) konfidencialiteti.

Nga sa më lart përshkruam, audituesit e [NJAB] të bashkisë Dropull për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 rezultojnë të kenë zhvilluar orët e plota të trajnimit të detyrueshm të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, vërtetuar kjo nga Vërtetimet e lëshuara nga DPHKBFP/DHAB si dhe certifikatat me të cilat janë pajisur për temat jashtë planifikimit vjetor, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore në fuqi.

II Hartimi dhe zbatimi i planeve të Auditimit të Brendshëm:

2.1 [NJAB] e Bashkisë Dropull ka hartuar dhe miratuar nga Kryetar i Bashkisë Planet Strategjike dhe ato Vjetore respektive, konform përcaktimeve ligjore, i ka dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në MFE/Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, brenda afatit kohor (20 Tetor). Plani Strategjik (2023-2025), përmban këto 5 (pesë) pasqyra:

Pasqyra Nr.1 - Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar për vitin 2023-2025;

Pasqyra Nr.2 - Plani i Angazhimeve të NJAB për vitin 2023;

plotësuar

Pasqyra Nr.3 - Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2023;

plotësuar

Pasqyra Nr.4 - Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2023;

plotësuar

Pasqyra Nr.5 - Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet që auditohen për vitin 2023;

plotësuar

plotësuar

▪ Subjektet që janë objekt auditimi nga NJAB Bashkia Dropull janë:

- Drejtoritë /Sektorët e strukturës së Bashkisë Dropull;

- MZSH Dropull

- Është hartuar dhe miratuar Regjistri i Riskut të veprimtarisë së NJAB për vitin 2023, i cili rezulton si më poshtë vijon:

Niveli i Riskut	Numri i Risqeve
I Lartë	2
I Mesëm	4
I Ulët	5
Totali	11

Punoi: Grupi i Auditimit

▪ Planifikimi dhe grafiku i shpërndarjes së misioneve audituese është bërë mbi bazë risku dhe paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Viti	2022			2023		
	lartë	mesëm	ulët	lartë	mesëm	ulët
Numri i auditimeve plan	5			5		
Numri i auditimeve fakt	5			5		
Numri për cdo nivel fakt	2	3	-	3	2	-
Shprehur në % (ndaj planit)	40	60		60	40	

Punoi:Grupi i Auditimit

- Referuar të dhënave në tabelë rezulton se në dy vite 2022 dhe 2023, është realizuar numri i auditimeve të planifikuara në Planet Strategjikë dhe ata Vjetorë; është pasqyruar e argumentuar arsyeja e ndryshimit të planit vjetor 2023 për shtimin e një misioni auditues në relacionin e dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE;

- Gjithashtu rezultoi se në planifikimin e misioneve audituese strategjikë dhe vjetorë është respektuar raporti [60% me 40%] mes sistemeve/fushave me risk të lartë dhe sistemeve/fushave me risk të mesëm/ulët, në zbatim kjo të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” Kapitulli III paragrafi 3 pika 1.6 e 1.7; 3.2; 3.4; 3.5.

2.2 Auditimet e planifikuara dhe të realizuar nga [NJAB] e Bashkisë Dropull, të klasifikuara sipas llojit, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financiar	Kombinuar	Performa	Tjera
1	Viti 2022	5	5	4	-	1	-	-
2	Viti 2023	5	5	5	-	-	-	-

3	B.Dropull +B.Libohovë +B.Finiq	14	14	14	-	-	-	-
---	--------------------------------------	----	----	----	---	---	---	---

Burimi: NJAB/Bashkia Dropull

- Nga auditimi i raportimeve vjetore hartuar nga [NJAB] mbi aktivitetin e saj për çdo vit ushtrimor, të dhënat mbi gjetjet/rekomandimet dhe statusin e zbatimit të tyre, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS				RAPORTIMIT			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej në vlerë	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	Viti 2022	12	-	12	-	-	-	-	
2	Viti 2023	20	3	13	4	1	1	-	
	Trendi	↗	↗	↗	↗	↗	↗		
	TOTALI	32	3	25	4	1	1	-	

Burimi: NJAB/Bashkia Dropull

▪ Përsa i përket planifikimit dhe realizimit të auditimeve nga NJAB të Bashkisë Dropull për periudhën 2022-2023, nga auditimi rezultoi se [NJAB] ka realizuar numrin e angazhimeve audituese të miratuara në “Planin vjetor dhe Strategjik” për vitin 2023 i ndryshuar;

Në Raportin vjetor që [NJAB] e Bashkisë Dropull ka paraqitur në DPHKBFP/DHAB në MFE, ka dhënë sqarime mbi arsyet e ndryshimit të planit vjetor, si dhe është hartuar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë programi i ndryshuar vjetor;

▪ Realizimi i auditimeve nga [NJAB] të Bashkisë Dropull për periudhën nën auditim 2023, pasqyrohen në tabelën më poshtë:

Nr.	Titulli i Angazhimit të auditimit në vitin 2023	Statusi/ Realizimi
1	Auditim <i>Përputhshmërie</i> i realizuar nga data 15.11.2023 - 28.12.2023, për periudhën 01.01.2023 - 31.10.2023, në lidhje me “Vlerësimin e funksionimit të sistemit të të ardhurave”	√
2	Auditim <i>Përputhshmërie</i> i realizuar nga data 19.06.2023 – 10.07.2023, për periudhën 01.01.2022 - 31.05.2023, në lidhje me “Vlerësimin e funksionimit të Sektorit të MZSH”	√
3	Auditim <i>Përputhshmërie</i> i realizuar nga data 10.04.2023 – 31.05.2023 (me shkëputje), për periudhën deri në 31.12.2022, në lidhje me “Vlerësimin e detyrimeve të prapambetura”	√
4	Auditim <i>Përputhshmërie</i> i realizuar nga data 10.04.2023 – 31.05.2023, për periudhën deri në 31.12.2022, në lidhje me “Vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të prapambetura”	√
5	Auditim <i>Përputhshmërie</i> i realizuar nga data 18.09.2023 – 22.09.2023, sipas Urdhrit të Titullarit me nr. 146 prot., datë 18.09.2023, në lidhje me “Vlerësimin e procedurës së blerjes së makinës teknologjike dhe kontenierë për mbledhjen e mbetjeve urbane”	√

Punoi: Grupi i auditimit

- Nga auditimi rezultoi se [NJAB] ka realizuar numrin e angazhimeve audituese të miratuara në “Planin vjetor dhe Strategjik” për vitin 2023;

- Nga auditimi i dosjeve të Subjekteve të audituara për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, rezultoi se dosjet përmbanin gjithë dokumentacionin dhe inventarizuar konform akteve ligjore/nënligjore në fuqi;

- Nga auditimi i dosjeve të auditimit rezultoi se nga ana e subjekteve të audituara, janë hartuar planet e veprimit brenda afatit 30 ditor; është raportuar nga subjektet e audituara brenda afatit 6

mujor, gjë që ka sjellë monitorimin nga [NJAB] për zbatimin e rekomandimeve të lëna subjekteve të audituara brenda afateve të përcaktuara, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

- Nga ana e NJAB janë realizuar misione audituese “Mbi vlerësimin e detyrimeve të prapambetura” dhe “Mbi Zbatimin e rekomandimeve të lëna” ku dhe është vlerësuar statusi i zbatimit të tyre, kjo në zbatim të Udhëzimit nr. 42 datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”.

III. Sigurimi i cilësisë në auditimet e kryera dhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna; Raportimi në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm/MFE.

3.1 Në Njësinë e auditimit të brendshëm, Sigurimi i Cilësisë në të gjitha angazhimet e Auditimit të Brendshëm të kryera si çdo vit edhe për vitin 2023, është kryer nga grupi i punës që ka realizuar angazhimin e auditimit, pra nga [NJAB] të bashkisë Dropull. Sigurimi i cilësisë është pjesë e procesit që bën të mundur zbatimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” me emërtesën “Njësia e Auditimit të Brendshëm”.
- Programi për Sigurimin e Cilësisë së punës së Auditimit Brendshëm për vitin 2023 dhe Vlerësimin e Performancës së veprimtarisë së Auditit të Brendshëm për vitin 2022 është raportuar zyrtarisht me nr. 407/1 prot., datë 03.03.2023; (pasqyruar te tabelat në Projekt Raportin e Auditimit dërguar në Bashkinë Dropull me shkresën nr. 431/2 prot datë 27.05.2024.)

3.2 Raporti vjetor i veprimtarisë së NJAB Bashkia Dropull dhe Vlerësimi i Performancës së veprimtarisë së Auditit të Brendshëm për vitin 2023 është dërguar zyrtarisht në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm [DHAB] me nr. 231 prot., datë 13.02.2024;

- Për periudhën 2022-2023 nga Njësia e Auditit të Brendshëm të Bashkisë së Dropull janë lënë në total **32** rekomandime, nga të cilat janë pranuar dhe zbatuar plotësisht **3** rekomandime, në proces zbatimi **25** rekomandime dhe **4** pa zbatuar; Ndërsa vetëm në vitin 2023 janë lënë dhe pranuar **20** rekomandime, nga të cilat rezultojnë: **3** rekomandime të zbatuara, **13** rekomandime në proces zbatimi dhe **4** rekomandime pazbatuar; rekomandim shpërbllim dëmi është lënë **1**, pranuar dhe zbatuar.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelat respektive, rezulton se NJAB nga pesë (5) auditime të planifikuara dhe të realizuara gjatë vitit 2023, ka lënë 20 rekomandime, pra numri i rekomandimeve ka ardhur në rritje në krahasim me vitin 2022, por nëse rekomandimet e lëna në auditimet e vitit 2022 janë të statusit “në proces”, për vitin 2023 janë 4 rekomandime me statusin “pa zbatuar”.

- Nga auditimi rezultoi se për vitin 2023 është raportuar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm/MFE, me formatet e miratuara konform kuadrit ligjor në fuqi.

Dosja e përhershme: Audituesit e Brendshëm duhet të njohin mirë njësinë publike, veprimtaritë operacionale dhe sistemin financiar me qëllim që të sigurojnë se puna e tyre do të jetë e përshtatshme për organizatën vlerësimin e sistemeve, proceseve të cilat janë pjesë e aktiviteteve të përditshme të njësisë që auditohet. Njësia e Auditimit të Brendshëm mban një dosje të përhershme për çdo njësi apo strukturë të saj, ku kryen angazhim auditimi, dosje të cilës i referohet për auditimin pasardhës që do të kryhet.

Nga auditimi mbi vlerësimin e veprimtarisë së Njësisë së auditimit të brendshëm në Bashkinë Dropull, për periudhën e audituar 2023 u konstatua se:

1. Bashkia Dropull ka krijuar Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm [DAB] që e ushtron funksionin e vet me tre auditues në Strukturën e saj organizative (1 drejtor+1përgjegjës+1 auditues), me dy vende vakante, në kundërshtim me Ligjin nr.114/2015 “Mbi Auditimin e Brendshëm”, “Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.100/2016, pika 3, 6 në VKM nr. 83 dt. 03.02.2016 “Për Miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar, si dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë Dropull “Për miratimin e Strukturës Organizative” për vitin 2023.

2. Nga auditimi mbi rekomandimet e lëna nga NJAB në misionet audituese të realizuara në 2 vitet e fundit 2022 dhe 2023, rezulton se numri i rekomandimeve të lëna dhe numri i atyre të zbatuara vijnë në rritje; por rezulton se për vitin 2023 ka dhe rekomandime të pazbatuara.

3. Nga Kryetari i Bashkisë dhe GMS nuk është zhvilluar një analizë mbi arsyet e moszbatimit të rekomandimeve nga ana e strukturave përgjegjëse, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës dhe arritjen e objektivave të njësisë;

Kriteri: Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manuali i auditimit të brendshëm në sektorin publik” miratuar me Urdhrin e ministrit të financave nr. 100/2016 datë 25.10.2016; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Përmenaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 83/2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; “Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, miratuar me Urdhrin e ministrit të financave nr. 8980, dt. 15.07.2010, përditësuar me atë të Urdhrit të ministrit të financave nr. 108/2016.

2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;

2.2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit sipas miratimit me Vendim të Këshillit të Bashkisë, ndryshimet gjatë vitit, analiza e tyre sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve.

2.2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me aktrakordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.

2.2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, raporti i tyre me shpenzimet e vitit sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve të FZHR dhe Ministrive të linjës etj.).

2.2.5. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga taksat e tarifat, qiratë e asetëve, tokave, pyje kullotave etj, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Dokumentacioni i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;

2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;

3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit Dropull për shpenzimet dhe të ardhurat;

4. Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;
5. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve, si fatura të palikuiduara dhe vendimeve gjyqësore;
6. Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrimet të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar.
7. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
8. Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin “Excel”, si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet, të ardhurat etj.).

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua si më poshtë vijon:

➤ Struktura organizative e Drejtorisë së Menaxhimit Financiar për vitin 2023:

Nr	Emërtimi i pozicionit në strukturë	Emër Mbiemër	Formimi arsimor	Numri i punonjësve/Periudha e ushtrimit të detyrës
1	Drejtor			
		Th.P.	Ekonomi / m.shkencor	2019-31.10.2023
		J.V.	Ekonomi / m.shkencor	01.11.2023 e në vazhdim
2	Sektori i financës			
	Përgjegjës	J.V.	-/-	2018-31.10.2023
	Specialist	S.	-/-	2018- e në vazhdim
	-/-	P.	Ekonomi / m.profesional	2021- e në vazhdim
	-/-	M.	Juridik / m.shkencor	2021- 01.10.2023
	magaziniere	K.	I mesëm	2021- e në vazhdim
3	Sektori i buxhetit dhe mbrojtjes sociale			
	Përgjegjës	K.	Ekonomi / m.shkencor	2018 e në vazhdim
	Specialistë për mbrojtjen sociale		3 punonjës	Në detyrë
	Koordinator vendor për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje		1 punonjës	
Numri total i punonjësve në strukturë			12	8 punonjës për financë & buxhetin

Burimi: Bashkia Dropull

2.1. Programimi PBA-së dhe programimi i buxhetit vjetor për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023:

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025, rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP) me Vendimin nr. 1 datë 24.01.2022 dhe me nr. 137 prot., datë 24.01.2023 të Titullarit të institucionit. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se GMS përbëhet nga dymbëdhjetë (12) anëtarë dhe se janë ngritur dhe miratuar tetë (8) EMP për trembëdhjetë (13) programe përfshirë edhe atë të të ardhurave nga taksa e tarifa vendore për Bashkinë Dropull.

Nga analiza e informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi shpërndarjen e programeve buxhetore për vitin 2023 sipas funksioneve/nënfunksioneve që NJVQV/Bashkitë janë përgjegjëse për ushtrimin e tyre të atribuar me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, (pasqyruar në tabelën respektive në Projekt Raportin e Auditimit dërguar në Bashkinë Dropull me

shkresën nr. 431/2 prot datë 27.05.2024), rezultoi se ka funksione/nënfunksiione të cilat nuk kanë asnjë program buxhetimi, si: F- “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike” (neni 23): “Transportin publik vendor” dhe “Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të kujdesit të shëndeti publik”; F- “në fushën e mbrojtjes së mjedisit” (neni 26); N/f- “Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara”; F- “në fushën e zhvillimit ekonomik vendor” (neni 28): N/f-“Ngritja dhe funksionimi i tregjeve” etj; N/f- “Administrimin e fondit pyjor dhe kullësor publik, sipas legjislacionit në fuqi”, “Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi” etj; Çdo funksion i përcaktuar në Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” përfshihet në një program të caktuar buxhetor të përcaktuar në Udhëzimin nr. 7 datë 25.05.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore” shtojca 1. Pra vihet re se nuk ka një harmonizim të planifikimit buxhetor të atyre nënfunksiioneve që edhe pse u përkasin funksioneve të ndryshme, me një studim dhe analizë profesionale do të mbështesnin apo plotësonin njëra tjetrën, me qëllim realizimin në tërësi të shërbimeve ndaj komunitetit në territorin që mbulon bashkia Dropull.

- Programimi i shpenzimeve në PBA 2023-2025 dhe i detajuar sipas programeve, pasqyrohet si më poshtë:

Planifikimi buxhetor i shpenzimeve sipas çdo viti në PBA 2023-2025							
Nr.	Kodet e programeve	Shpenzimet Viti 2023		Shpenzimet Viti 2024		Shpenzimet Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	01110	86,699	19	87,185	16.5	87,170	29
2	03280	16,371	3.6	16,800	3.2	20,795	6.9
3	04240	6,258	1.4	7,000	1.3	8,500	2.8
4	04260	22,256	4.9	13,000	2.5	13,000	4.3
5	04520	44,901	9.8	57,868	11	55,680	18.5
6	05100	24,058	5.3	25,150	4.8	26,300	8.7
7	06260	19,699	4.3	20,000	3.8	20,000	6.6
8	06370	118,110	25.9	231,197	43.9	0	0
9	08220	3,400	0.7	3,400	0.6	3,400	1.1
10	09120	4,200	0.9	4,200	0.8	4,200	1.4
11	09230	46,165	10.1	6,920	1.3	6,980	2.3
12	10430	56,998	12.5	45,430	8.6	48,430	16.1
13	10661	1,200	0.3	1,650	0.3	1,850	0.6
14	04980	6,001	1.3	7,018	1.3	4,552	1.51
TOTALI		456,319	100	526,818	100	300,857	100

Burimi: Bashkia Dropull/DFB

- Ndërsa programet buxhetore e përzgjedhura në Bashkinë Dropull për buxhetin e vitit 2023 si viti i parë në PBA 2023-2025, krahasuar me programet e miratuara nga MFE për tu patur në konsideratë nga NJVQV gjatë përgatitjes së PBA 2023-2025, pasqyrohen si në tabelën më poshtë:

Në mijë lekë

Udhëzimi nr. 7 datë 25.02.2022			Kodi buxhetuar	Emërtimi i Programit Buxhetor	Viti 2023 Plan Fakt	
Funksioni	N/ Funksioni	Kodi Programit				
1	011	01110	01110	Planifikim, Menaxhim, Administrim	90,095.9	78,646.4
3	031	03140		Shërbimet e Policisë Vendore		
		032	03280	03280	MZSH	17,084.8

4	041	04130		Mbështetje për zhvillim ekonomik	-	-	
	042	04220		Shërbimet bujqësore/inspektimi /siguria ushqimore/mbrojtja konsumatore	-	-	
			04240	04240	Kullim-Ujitja	7,008.9	5,597.5
			04260	04260	Pyje-Kullota	23,422.4	22,729.9
	045	04520	04520	Rruge Rurale	51,780.6	44,919.1	
		04570		Transporti Publik	-	-	
				04980	Fond kontigjence, fond rezervë	6,000.0	0
5	051	05100	05100	Mbetje Urbane	30,931.7	26,613.5	
6	061	06140		Planifikimi urban vendor			
	062	06260	06260	Shërbime Publike	22,695.6	18,503.5	
	063	06370		Furnizim me ujë dhe kanalizime	-	-	
7	072	07220		Shërbimet e kujdesit parësor	-	-	
8	081	08130		Sport dhe argëtim, turizëm;	1,380.0	1,058.0	
	082	08220	08220	Shërbime kulturore			
9	091	09120	09120	Arsimi bazë	4,314.0	3,661.0	
	092	09230	09230	Arsimi i Mesëm	17,885.1	15,227.3	
10	104	10430	10430	Paaftësi; Kujdesi Social	4,815.0	3,596.3	
	106	10661	10661	Strehimi Social	1,603.0	145.3	
			10910	Mbrojtje Civile	1,387.0	0	
20 Programe			14 Programe		279,017.0	237,547.1	

Burimi: Bashkia Dropull/Punoi: Grupi i auditimit

Programet afatmesme janë hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligjin nr. 57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008”, Ligjin nr. 9652/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Udhëzimin e MF nr. 7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së buxhetit”, Udhëzimin e MF nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimi plotësues i MF nr. 2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, Udhëzimin plotësues nr.6/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, Udhëzimin nr. 7 datë 25.05.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore” shtojca 1 si dhe VKB nr. 98 datë 24.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë e Dropullit për vitin 2023”. Është marrë në konsideratë Instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

Konstatim: Nga verifikimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelat e funksioneve të bashkisë dhe programeve buxhetore të caktuara në udhëzimet e MFE, rezultoi se: fondet e buxhetuara për “policinë vendore” nuk janë përfshirë në programin përkatës 03140 – “shërbimet e policisë vendore”, fondet për drejtorinë e shërbimit urban dhe e shërbimeve publike ku përfshihet dhe IMTV nuk janë përfshirë në programin përkatës 06140 – “Planifikimi urban vendor”, në moszbatim të Udhëzimit nr. 7 datë 25.05.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr.

23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” shtojca 1.

- Ndarja e shpenzimeve sipas zërave buxhetorë në PBA 2023-2025, pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Nr	Shpenzimet sipas natyrës	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj tot	000/lekë	% ndaj tot	000/lekë	% Ndaj tot
1	Paga (600)	104,588	22.9	103,994	19.7	104,217	34.6
2	Sigurime (601)	17,466	3.8	17,367	3.3	17,404	5.8
3	Shpenzime operative (602)	59,931	13.1	64,430	12.2	64,880	21.6
4	Shpenzime (603)						
5	Shpenzime (604)	2,000	0.4	2,200	0.4	2,300	0.8
6	Shpenzime (606)	42,505	9.3	45,430	8.6	48,430	16.1
7	Shpenzime (609)	6,001	1.3	7,018	1.3	4,552	1.5
8	Shpenzime për investime (230-231)	223,828	49	286,379	54.4	59,074	19.6
Shuma		456,319	100	526,818	100	300,857	100

- Ndërsa shpenzimet buxhetore të planifikuara dhe realizuara në Bashkinë Dropull për Planin e buxhetit të vitit 2023 si viti i parë në PBA 2023-2025, pasqyrohen si në tabelën më poshtë:

Në mijë lekë

Emërtimi i shpenzimit	Viti Plan	2023 Fakt	Diferenca
600	109,309.1	98,972.8	10,336.3
601	18,280.3	16,454.1	1,826.2
602	68,576	52,148.9	16,427.1
230-231	72,113	64,293.6	7,819.4
604+ 606+609	12,125.5	5,677.8	6,447.7
Totali	280,403.9	237,547.2	42,856.7

Burimi: Bashkia Dropull

Duke bërë analizën e pagave rezultoi se pesha specifike e këtyre llogarive (600-601) të shpenzimeve ndaj totalit të shpenzimeve, është 127,589.4 (109,309.1 + 18,280.3) mijë lekë ose 45.5% në vitin 2023.

- Sipas PBA 2023-2025 tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë:
Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2023-2025.

Në mijë lekë

A	Të ardhurat	Planifikimi i të Ardhurave në PBA 2023-2025		
		2023	2024	2025
1	Nga taksat	26,673	27,175	26,900
2	Jo tatimore	67,968	76,985	74,855
I	Totali	94,641	104,160	101,755
1	Transferta e pakushtëzuar	95,653	95,653	100,294
2	Transfertë specifike	50,808	50,808	50,808
	Tjera...(trashëguara)	11,850	0	0
II	Shuma e transfertave	158,311	146,969	152,123
III	Transferta te pritshme (FZHR e tjera)	203,367	276,197	48,000
Totali i burimeve të veta (I +II+III)		456,319	526,818	300,857

Nga informacioni i pasqyruar në tabelë rezultoi se Bashkia Dropull ka pritshmëri për rritje të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore dhe nga të ardhurat jotatimore;

Nga transfertat pritshmëria për rritje është pothuajse e papërfillshme, pasi granti i akorduar vitet e fundit për Bashkinë Dropull ka qenë në vlera të përafërta;

Nga transfertat të FZHR apo donatorë të ndryshëm ka pritshmëri, pasi nuk kanë munguar investimet për bashkinë Dropull.

- Nga auditimi rezultoi se Bashkia Dropull për PBA 2023-2024 dhe Projekt buxhetin e vitit 2023, ka zhvilluar takime konsultative me grupet e interesit në komunitet, konform Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; ndërsa prezantimi i PBA 2023-2024 dhe Projekt buxheti vjetor 2023 nga ana e bashkisë Dropull është publikuar në faqen Zyrtare të Bashkisë në formatin e përshtatur për publikun.

Datat	PBA 2023-2025	P.Buxheti 2023
	09/11/2022; 10/11/2022	09/11/2022; 10/11/2022
Numri i takimeve	2	2

Procesi konsultativ me komunitetin realizohet nëpërmjet njoftimit zyrtar në stenda, web-in e Bashkisë, rrjetet sociale etj., me anë të të cilave njoftohet komuniteti mbi takimin, objektin, platformën dhe adresën/linkun etj., konform ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” Kreu IV, neni 11-20.

- Buxhetet janë hartuar mbi bazën e nevojave të 3 (tre) njësisive administrative: Dropull i Poshtëm, Dropull i Sipërm, Pogon; drejtoritë e shkollave, drejtoritë/sectorët e bashkisë etj.

Në mijë lekë

Njësi Administrative	PBA 2023-2025/ Plani Buxhetit 2023
	Vlera
Aparati i Bashkisë	280,403.9
NJA Dropull i Sipërm	
NJA Dropull i Poshtëm	
NJA Pogon	

Punoi: Grupi i auditimit

Gjatë vitit 2023 ka patur investime, të cilat klasifikuar nga burimi i financimit, (pasqyruar te tabelat në Projekt Raportin e Auditimit dërguar në Bashkinë Dropull me shkresën nr. 431/2 prot datë 27.05.2024.)

Nga informacioni i vënë në dispozicion, **rezultoi** se për vitin 2023 janë parashikuar 13 projekte me burim nga të ardhurat e bashkisë në vlerën totale 145,052 nga të cilat 11 projekte në vlerën totale 44,0323 mijë lekë me afat deri në 31.12.2023 dhe 2 projekte në vlerën totale 101,020 mijë lekë me afat 2 vjeçar, deri në 31.12.2024; janë paguar plotësisht sipas planit për 6 investime në vlerën totale 36,638 mijë lekë, paguar pjesërisht për 4 investime në vlerën totale 27,656 mijë lekë dhe për 2 investime në vlerën totale të parashikuar 4,134 mijë lekë nuk ka asnjë pagesë; Janë 6 projekte me burim nga granti në vlerën totale 413,138 mijë lekë: janë paguar plotësisht sipas cdo situacioni të punimeve për 5 projekte në vlerën totale 368,575 mijë lekë, paguar pjesërisht për 1 projekt në vlerën 27,231 mijë lekë.

- Hartimi i PBA 2023-2025 rezulton të ketë kaluar të gjitha fazat e përgatitjes, konform kuadrit ligjor dhe konkretisht”:

VKB nr. 30 datë 30.06.2022 me nr. 1146 prot., datë 30.06.2022 “Miratimin e projektdokumentit të Parë të PBA 2023-2025, në Bashkinë Dropull”;

VKB nr. 51 datë 29.09.2022 me nr. 1637 prot., datë 29.09.2022 “Miratimin e Projektdokumentit të Rishikuar të PBA 2023-2025, në Bashkinë Dropull”;

VKB nr. 73 datë 21.12.2022 “Për miratimin e PBA përfundimtar 2023-2025 dhe buxhetit të Bashkisë Dropull për vitin 2023, si vit i parë i tij”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresë nr. 1256/1 prot., datë 06.01.2023, konform nenit 17 të Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.

- PBA 2023-2025 dhe Buxheti vjetor për vitin 2023 kanë pësuar këto ndryshime dhe janë miratuar në Këshillin Bashkiak si më poshtë:

Nr.	PBA 2023-2024	P. Buxheti 2023
<u>1.</u>		Nr.73 dt.21.12.2022
<u>2.</u>		Nr.14 dt.23.03.2023
<u>3.</u>		Nr.38 dt.19.07.2023
<u>4.</u>		Nr.44 dt.10.08.2023
<u>5.</u>		Nr.46 dt.28.09.2023
	1	5

Burimi: Bashkia Dropull

a. Bashkia Dropull ka hartuar e miratuar “Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit vjetor” për Bashkinë Dropull dhe njësisë të varësisë/administrative për vitin 2023, me nr. 39 prot., datë 10.01.2022, në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 33;

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në Këshillin e Njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor.

PBA 2023-2025 dhe Plani vjetor i buxhetit për vitin 2023, është miratuar me VKB nr. 73, datë 21.12.2022; Buxheti fillestar i miratuar për vitin 2023, ka pësuar katër (4) ndryshime, të cilat janë miratuar sipas VKB-ve për shtesa/pakësime apo përdorim fondesh në buxhet, të pasqyruara në tabelën e mësipërme dhe konkretisht: VKB nr. 14 datë 23.03.2023 “Për miratimin e shtesave dhe transferimeve buxhetore në buxhetin e bashkisë për vitin 2023”; VKB nr. 38 datë 19.07.2023 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile dhe shtesave buxhetore në buxhetin e Bashkisë për vitin 2023”; VKB nr. 44 datë 10.08.2023 “Për miratimin e Transferimeve buxhetore”; VKB nr. 46 datë 28.09.2023 “Për miratimin e transferimeve buxhetore”; Vendimet e Këshillit të Bashkisë për shtesat dhe pakësimet mbi të ardhurat dhe shpenzimet, miratuar me VKB nr. 14, datë 23.03.2023, VKB nr. 3 datë 19.07.2023, VKB nr. 44 datë 10.08.2023, VKB nr.46 datë 28.09.2023, janë *(pasqyruar te tabelat në Projekt Raportin e Auditimit dërguar në Bashkinë Dropull me shkresën nr. 431/2 prot datë 27.05.2024.)* Ndryshimet e propozuara dhe të miratuara në buxhetin e bashkisë për vitin 2023 me Vendim të Këshillit Bashkiak, kanë pasqyruar lëvizjet në buxhet sipas kodeve të programit, kapitullit, artikullit e vlerës, të cilat janë shoqëruar edhe me relacionet përkatëse, konform Ligjit nr. 9936

datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 26,27,28 e 29; neni 44 paragrafi për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe neni 47;

c. Vendimeve të Këshillit Bashkiak për miratimin e PBA 2023-2025 dhe Planit vjetor 2023 dhe ndryshimeve të bëra, iu janë bashkëngjitur relacionet përkatëse, në të cilat janë dhënë argumentet e nevojshme ku mbështeten këto ndryshime. VKB janë rregjistruar në librin e protokollit të Bashkisë Dropull

d. VKB-të për PBA/ Buxhetin vjetor dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit ushtrimor, janë konfirmuar për ligjshmëri nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, si dhe janë dërguar në Degën e Thesarit Gjirokastrë brenda afateve ligjore.

Konstatim: Nga Bashkia Dropull, PBA 2023-2025 dhe Planit vjetor i buxhetit 2023 janë hartuar/miratuar sëbashku, duke mos e hartuar dhe miratuar veçmas Planin Vjetor, në moszbatim të kërkesave ligjore të përcaktuara në Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 29;

➤ **Planifikimet sipas PBA-së me ndryshimet:**

në mijë lekë

Emërtimi	PBA 2023-2025		Buxheti 2023	
	Ardh.	Shpenz.	Ardh.	Shpenz.
Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës			2,502.5	
Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës	11,850.0		16,705.5	
Trashëguar nga Transferta specifike	0	0	0	0
Plani i të ardhurave viti ushtrimor	94,641.0		106,005.0	
Granti	95,653.0		103,271.0	
Transferta specifike	50,808.0		51,920.0	
Paga (600)		102,044.0		109,309.2
Sigurime shoqërore (601)		17,041.0		18,280.3
Shpenzime operative (602)		59,931.0		68,576.0
Transferta (604+606+609) Fondi Rezervë		11,400.0		12,125.5
Inv (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushtëzuara		62,536.0		72,113.0
Investime nga FZHR e M. Linjës				
Të tjera (166, 651, 603, 604, 606)				
Totali	252,952.0	252,952.0	280,404.0	280,404.0

Burimi: Bashkia Dropull

Të dhënat në tabelë janë për aparatin e Bashkisë Dropull së bashku me njësitë administrative. Referuar të dhënave të pasqyrës, konstatohet se Bashkia Dropull ka planifikuar që me të ardhurat e veta të mbulojë 37.8% të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2023. Ndërkohë që nga tabela rezulton se të ardhurat e trashëguara nga viti paraardhës janë 2,502.5 mijë lekë. Të ardhurat e veta në total për vitin 2023 janë 108,507.5 mijë lekë.

në mijë lekë

Nr	Burimet e Financimit	Viti 2023	
		Plan	Fakt
1	Transferta e Pakushtëzuar	103,271.0	103,265.0
2	Transferta specifike, sektoriale	51,920.0	51,926.0
3	Të ardhurat e veta	106,005.0	84,389.0
4	Trashëgim nga viti i kaluar	19,208.0	19,208.0
	Totali	280,404.0	258,788.0

Burimi: Bashkia Dropull

Nga verifikimi dhe të dhënat e pasqyruara në tabelë rezultoi se shpenzimet me burim të “ardhurat” nga taksat e tarifat vendore janë planifikuar: për vitin 2023 në vlerën 106,005 mijë lekë; në fakt janë shpenzuar në vlerën 84,389 mijë lekë ose 79.6%; Nga fondet e “pakushtëzuara” janë

planifikuar 103,271 mijë lekë dhe shpenzuar 99.99% e atyre; si dhe nga fondet e “specifike e sektoriale“ janë planifikuar 51,920 mijë lekë dhe shpenzuar në masën e plotë 100%.

- Gjithashtu nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, rezulton se të ardhurat për shpenzime të planifikuara bashkë me ato të trashëguara nga viti paraardhës 2021 janë 108,507.5 mijë lekë. Ndërsa buxheti fillestar *për vitin 2023* është planifikuar në vlerën e 252,952 mijë lekë, me fondet e trashëguara nga viti 2022 prej 19,208 mijë lekë (nga të ardhurat e veta & transfertat e pakushtëzuar) dhe transfertat shtesë nga granti arrin në vlerën progresive e 280,404 mijë lekë. Krahasuar me planin fillestar buxheti vjetor progresiv i planifikuar është 27,452 mijë lekë më shumë se ai fillestar dhe realizimi i tij në vlerën e 258,788 mijë lekë.

Planifikimi i Buxheteve të Bashkisë Dropull për vitin 2023 është bërë në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” pika 4 dhe 5, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015, germa “dh” të nenit 32, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkiak Dropull.

Në mijë lekë

N r	Emërtimi	Plani përfundimtar 2023	Sipas PBA 2023-2025	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600 + 601) (nga të ardhur e grant i pakushtëzuar e specifike)		119,08 5.0	
2	Shpenzime (602, 604, 606, 609) (nga të ardhura e grant i pakushtëzuar e specifike)		71,331. 0	
3	Investime Bashkia (nga të ardhura e grant i pakushtëzuar)		62,536. 0	
4	Investime nga FZSHH	0	0	
	Total i planit fillestar	252,952.0	252,95 2.0	0
	Shtesat nga Pushteti Qendror	27,451.9	0	
5	Investime grant i pakushtëzuar	9,577.0		
6	Shpenzime për pagat (600 + 601)	8,504.0		
7	Shpenzime (602, 604, 606, 609)	9,370.5		
	Gjithsej	280,403.9	252,95 2.0	27,451.9

Burimi: Bashkia Dropull

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo vit buxhetor

Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2023, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Planifikimi i buxhetit është bërë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njëjësive vendore. Janë zbatuar kriteret në çeljen e buxhetit, është bërë detajimi i planit fillestar bazuar në kompetencat që i lejon ligji për lëvizjet në buxhet.

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetet për vitin 2023 është si më poshtë:

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2023				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2023 në mijë lekë			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar miratuar me VKB nr. 73, datë 21.12.2022	Buxheti shtesë miratuar me VKB dhe shtesa nga pushteti Qendror	Vlera	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr. 73 datë 21.12.2022	Buxheti shtesë miratuar me VKB dhe shtesa nga pushteti Qendror	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë
	1	2	1+2		3	4	3+4
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023	94,641	11,364	106,005	600 601 602 604,606,60 9 230-231	102,044 17,041 59,931 11,400 62,536		109,309.1 182,80.3 68,576.0 12,125.5 72,113.0
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2023		2,502	2,502			2,502.5	
Total të ardhurat e veta	94,641	13,866	108,507		250,449.5	2,502.5	252,952.0
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	11,850	4,856	16,706				
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2023	95,653	19,205	103,271				
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2023	50,808	1,118	51,920				
Total të ardhurat nga transferata të buxhetit të shtetit	158,311	13,586	171,897			24,949.4	27,451.9
Totali i të ardhurave	252,952	27,452	280,404		252,952.0	27,451.9	280,403.9

Burimi: DMF/Bashkia Dropull

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar edhe në tabelë, *rezulton* se nga të ardhurat e veta plani fillestar ka qenë 94,641 mijë lekë dhe me një shtesë prej 13,866 mijë lekë plani progresiv për vitin 2023 është 108,507 mijë lekë;

Nga buxheti i shtetit plani fillestar ka qenë në vlerën 158,311 mijë lekë dhe me një shtesë prej 13,586 mijë lekë plani progresiv për vitin 2023 është 171,897 mijë lekë.

Mbi procedurat e prokurimit për vitin 2023.

Për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2023-31.12.2023, Bashkia Dropull ka realizuar **44** procedura prokurimi (tender) me vlerë të fondit limit në shumën **166,267,564** lekë dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën **132,585,659** lekë nga të cilat:

Për vitin 2023 janë realizuar 12 procedura tenderimi me fond limit në shumën **150,967,956** lekë dhe vlerë kontrate të lidhur në shumën **121,691,483** lekë pa TVSH.

Gjithashtu për të njëjtën periudhë objekt auditimi, ka realizuar 32 procedura blerje me vlera të vogla me fond limit në shumën **15,299,608** lekë dhe vlerë kontrate në shumën **10,894,176** lekë. (Realizimi i procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, paraqiten në Aneksin nr. 1 pika 4, Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar

nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës.

Në mijë lekë

Bashkia Dropull së bashku me njësitë vartëse. Vetëm me të ardhurat e veta vendore + transfertat e pakushtëzuar. Viti 2023.									
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti i vitit para ardhës Viti 2022	PBA Plan Viti 2023	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2023 (VKB ..., datë .../.../2022)	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2023	Çelja në thesar	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	% e realizimit
600	Paga	82,681.4	102,044.0	102,044.0	109,309.1		98,972.8		
601	Sigurime Shoqërore	13,951.0	17,041.0	17,041.0	18,280.3		16,454.1		
600	Paga	96,632.4	119,085.0	119,085.0	127,589.4	119,176.4	115,426.9	(-)3,749.5	90.5
601	+Sigurime								
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	37,702.3	59,931.0	59,931.0	68,576		52,148.9		76
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0		0
604	Transferta Korente të Brendshme	1,950.0	2,000.0	2,000.0	2,500		2,500	0	100
609	Fond emergjence	0	6,000.0	6,000.0	6,000	0	0	(-)6,000	0
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	5,464.1	3,400.0	3,400.0	3,625.5		3,177.8		87.7
602-606	Shpenzime operative	45,116.4	71,331.0	71,331.0	80,701.5	60,893.0	57,826.7	(-)3,066.3	95
	Shpenzime Korrente	141,748.8	190,416.0	190,416.0	208,290.9	180,069.4	173,253.6	(-)6,518.8	83.2
230	Kapitale të Patrupëzuara	0	9,900.0	9,900.0	9,900		9,808.8		99.1
231	Kapitale të Trupëzuara	97,632.8	52,636.0	52,636.0	62,213		54,484.8		87.6
	Shpenzime Kapitale	97,632.8	62,536.0	62,536.0	72,113	71,601	64,293.6	(-)7,307.4	89.8
	Totali (korrente + kapitale)	239,381.6	252,952.0	252,952.0	280,403.9	251,670.3	237,547.2	(-)14,123.1	84.7

Burimi: Bashkia Dropull

***Këtu nuk janë përfshirë shpenzimet me fonde nga transfertat e kushtëzuar.**

Nga analiza e vlerave në pasqyrat e mësipërme, vërehet se ka diferenca në programe të ndryshme buxhetore, ku veç atyre programeve për të cilat Bashkia Dropull nuk mund të bëjë planifikim të saktë të fondeve që do të shpenzohen (investime të reja gjatë vitit buxhetor me fonde të Ministrisë së linjës/FZHR), ka programe si: **04570-** “Transporti publik”, **04130-** “Mbështetje e zhvillimit ekonomik”, **07220-** “Kujdesi Parësor Shëndetsor” dhe **042/20-** “Shërbimi, inspektimi i tregjeve dhe mbrojtja e konsumatorit”, **036-**“Marrëdhëniet në komunitet”, **056-** “Ndërgjegjësimi mjedisor”, **062/1** “programe zhvillimi”, rezultojnë të jenë programe pa fonde buxhetore apo me

fonde të papërfillshme; gjë për të cilat tregon se Bashkia Dropull nuk ka pritshmëri për alokim të fondeve shtesë.

Diferencat e vlerave të PBA-ve në gjykimin e grupit të auditimit tregojnë jo vetëm planifikim jo të studiuar të fondeve buxhetore në PBA, por edhe paqartësi në përcaktimin dhe vlerësimin e programeve prioritare si dhe mungesë harmonizimi ndërmjet atyre programeve që i përkasin të njëjtit funksion apo funksioneve të ndryshme, por që mbështesin apo plotësojnë njëri - tjetrin, të cilat janë të lidhura ngushtësisht me planin strategjik dhe politikat institucionale

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të Këshillit Bashkiak, të pasqyruara në tabelat respektive.

Për hartimin e projekt buxhetit vjetor 2023, janë marrë në konsideratë kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës dhe drejtpërdrejtë kërkesat buxhetore sipas nevojave të çdo njësie të strukturës së bashkisë, në zbatim të nenit 40 pika 3/ç të ligjit nr. 67/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi gjithashtu se analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj; gjatë vitit 2023 është bërë raportimi periodik 4 mujor, 8 dhe 12 mujor i realizimit të buxhetit në MFE.¹⁰

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuar sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitin 2023 rezultoi se PBA 2023-2025 të jetë realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë periudhës nën auditim, buxheti i Bashkisë Dropull ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Nga auditimi rezultoi se Kryetari i Bashkisë ka raportuar në Këshillin Bashkiak për gjendjen ekonomiko-financiare të vitit të mbyllur ushtrimor 2023 miratuar me VKB nr. 6 datë 29.02.2024 dhe me nr. 322 prot., datë 29.02.2024, në zbatim të neneve 11, 64 të ligjit nr. 30/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 44. Nga pasqyra e mësipërme rezulton se janë në total 20 programe (nënfunksione), nga të cilat për vitin 2023 janë planifikuar për tu trajtuar me fonde buxhetore vetëm 14 programe.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelat e funksioneve të bashkisë dhe programeve buxhetore të caktuara në udhëzimet e MFE, rezultoi se: fondet e buxhetuara për “policinë vendore” nuk janë përfshirë në programin përkatës 03140 – “shërbimet e policisë vendore”, fondet për drejtorinë e shërbimit urban dhe e shërbimeve publike ku përfshihet dhe IMTV nuk janë përfshirë në programin përkatës 06140 – “Planifikimi urban vendor”, në moszbatim të Udhëzimit nr. 7 datë 25.05.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë

¹⁰ Informacioni i detajuar pasqyrohet mëposhtë në rubrikën Monitorimi i buxhetit

30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” shtojca 1;

2. Nga Bashkia Dropull, PBA 2022-2024 dhe Plani vjetor i buxhetit 2022 janë miratuar sëbashku, duke mos miratuar veçmas Planin Vjetor 2022, në moszbatim të kërkesave ligjore të përcaktuara në Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 29;

3. Bashkia Dropull nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh duke mos i kushtuar rëndësi programit **042** “Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia” në moszbatim të Ligjit nr. 9385/2005 “Për pyjet dhe kullotat” i ndryshuar me Ligjin nr.57/2020 neni 23 pika 3,5 dhe neni 34 pika 2; programeve **052** “Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve”, **056**-“Ndërgjegjësimi mjedisor” si programe që lidhen ngushtë me **051**-“Menaxhimi i mbetjeve”; **072/2**- “Shërbimi shëndetësor”, **036**-“Marrëdhëniet në komunitet”, **041**-“Mbështetje për zhvillim ekonomik-Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi” etj, të cilat nuk janë vlerësuar si programe prioritare nga bashkia Dropull. Kështu mungesa e planifikimit të fondeve apo planifikim në rënie i fondeve nga ana e bashkisë, tregon për një shërbim ku është cënuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj që i ofron komunitetit, të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 23-30.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” pika 4 dhe 5, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015, gërma “dh” të nenit 32, i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; Ligji nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manualit MFK, Ligjin nr.57/2020 neni 23 pika 3,5 dhe neni 34 pika 2; Udhëzimit nr. 7 datë 25.05.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” shtojca 1, si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkiak Dropull.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Gjirokastër si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Gjirokastër, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar të vitit, të miratuar me Vendim të KB ose të diktuar nga transferta e deleguar nga pushteti qendror. Për rishikimet e buxhetit dhe rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, rezulton se është respektuar disiplina buxhetore, si në planifikim ashtu edhe në realizim.

- Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2023 referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelat e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Plan	Fakt	%
1	Llogaria 600 “Paga”	109,309.1	98,972.8	90.5
2	Llogaria 601 “Sigurime shoqërore”	18,280.3	16,454.1	90
3	Llogaria 602 “Shpenzime operative”	68,576.0	52,148.9	76
4	Llogaria 604 “Transferime korrente të brendshme”	2,500.0	2,500.0	100
5	Llogaria 606 “Transferime për Buxhetet familjare dhe Individë”	3,625.5	3,177.8	87.6

6	Llogaria 609 "Rezervat"	6,000.0	0	0
7	Llogaritë 230-231 "Investime"	72,113.0	64,293.6	89.2
TOTALI		280,403.9	237,547.2	84.7

Burimi: Bashkia Dropull

Referuar të dhënave të pasqyrës më sipër, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varion në masën nga 76% deri në 100% për vitin 2023; konstatohet se llog. 609 "rezervat"

mijë lekë

Artikulli	2022			2023		
	Plan	Fakt	Dif.	Plan	Fakt	Dif.
Llog. 600 "Paga"	83,948.0	82,681.4	(-1,266.6)	109,309.1	98,972.8	(-)10,336.3
Llog. 601 "Sig.shoqërore"	14,922.0	13,951.0	(-971.0)	18,280.3	16,454.1	(-)1,826.2
Llog. 602 "Shpenzime operative"	51,988.0	37,702.3	(-)14,285.7	68,576	52,148.9	(-)16,427.1
Llog. 604 "Transferime korrente të brendshme"	2,000.0	1,950.0	(-)50.0	2,500.0	2,500.0	0.0
Llog. 606 "Transferime për Buxh. familjare& Individë"	5,666.3	5,464.1	(-)202.2	3,625.5	3,177.8	(-)447.7
Llog. 609 "Rezervat"	3,897.1	0	(-)3,897.1	6,000	0	(-)6,000.0
Llog. 230-231 "Investime"	229,076.0	97,632.8	(-)131,443.2	72,113	64,293.6	(-)7,819.4
Totali	391,497.4	239,381.6	(-)152,115.8	280,403.9	237,547.2	(-)42,856.7
		61.15%			84.72%	

Gjithashtu rezulton se niveli i planifikimit buxhetor vjen në rënie nga viti 2022 në vitin 2023 me një diferencë prej 111,093.4 mijë lekë; ndërsa niveli i realizimit (ndaj planit) në total dhe për çdo zë buxhetor vjen në rritje nga viti 2022 në vitin 2023, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Dropull dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet në çdo rast zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara.

Peshën specifike më të madhe në buxhet ndaj totalit për vitin 2023 e zënë shpenzimet në llog.600 "paga" me 109,309.1 mijë lekë ose 39% të totalit të buxhetit, e ndjekur nga llog.230 e 231 – "Investimet" me 72,113 mijë lekë ose 25.7% e totalit të buxhetit; ndërsa në vlerat më të vogla janë llog. 604 "transferime korrente të brendshme" me 2,500 mijë lekë ose 0.9% dhe llog. 606 "transferime për buxhet familjare & individë" me 3,625.5 mijë lekë ose 1.3% e vlerës totale të buxhetit.

➤ **Sipas burimeve të financimit:**

Sipas burimeve të financimit: **transferta e pakushtëzuara, transferta specifike, të ardhura të veta**, treguesit e buxhetit janë planifikuar si më poshtë:

në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Totali	Burimi i financimit			% të ardhura të veta ndaj totalit
			Transferta pakushtëzuara	Transferta e specifike/sectoriale	Të Ardhura te veta	
1	Paga	109,309.1	43,320.6	36,973.0	29,015.5	10.34
2	Sig.shoqërore	18,280.3	5,957.3	6,112.0	6,211.0	2.22
3	Shpenzime Operative	68,576.0	29,493.5	472.0	38,610.5	14.13
4	Transferta korrente të brendshme	8,500.0	1,500.0	0	7,000.0	2.50
5	Trans.Buxh.Familjare/individ	3,625.5	500.0	0	3,125.5	1.12
6	Investimet	72,113.0	39,205.0	8,363.0	24,545.0	8.75
TOTALI		280,404.0	119,976.5	51,920.0	108,507.5	38.7
në %		100	42.8	18.5	38.7	

Burimi: Bashkia Dropull

Sipas burimeve të financimit: **transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, të ardhura të veta**, treguesit e buxhetit janë realizuar si më poshtë:

në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Totali	Burimi i financimit			% nga të ardhurat e veta ndaj totalit
			Transferta pakushtëzuara	Transferta e specifike/sectoriale	Të Ardhura te veta	
1	Paga	98,972.8	39,933.7	36,973.0	22,066.0	9.30
2	Sig.shoqërore	16,454.1	5,295.8	6,112.0	5,046.3	2.12
3	Shpenzime Operative	52,148.9	23,872.3	472.0	27,804.6	53.31
4	Transferta korrente të brendshme	6,000.0	1,500.0	0	1,000.0	0.42
5	Trans.Buxh.Familjare/individë	3,177.8	465.3	0	2,712.5	1.14
6	Investimet	64,293.6	32,198.0	8,363.0	23,732.6	10
TOTALI		237,547.0	103,265.1	51,920.0	84,362.0	34.7
në %		100	43.5	21.8	34.7	

Burimi: Bashkia Dropull

➤ Realizimi faktik i buxheteve sipas periudhave ushtrimore

Nga auditimi rezulton se realizimi i Buxhetit është: për vitin 2022 është 239,381.6 mijë lekë; për vitin 2023 buxheti faktik është në vlerën e 237,547.2 mijë lekë ose (-)1,834.4 mijë lekë më pak se viti 2022; dhe se buxheti faktik ndaj atij të planifikuar (progresivit), është në masën 84.7% të tij, duke rezultuar në vlerë më të lartë se realizimi i vitit 2022.

Nr.	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2023	Trendi
1	Shpenzimet e planifikuara	391,497.4	280,403.9	
2	Shpenzimet faktike	239,381.6	237,547.2	
Raporti		61.2%	84.7%	

Burimi: Bashkia Dropull

Sa më sipër **u konstatua** se ka diferenca të dukshme midis treguesve në hartimin e planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave të veta në vlerën 108,507.5 mijë lekë dhe shpenzimeve të tyre në vlerën 84,362 mijë lekë, kështu nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2022 dhe 2023 të ketë mosrealizime, vlera e të cilit vjen me trend në rënie dhe që paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

në mijë lekë

Emërtimi	2022	2023		Vlera & Trendi	
	Fakt	Plan	Fakt	Diferenca	i mosrealizimit
Shpenzime	239,381.6	280,403.9	237,547.2	(-)1,834.4	
Të Ardhura	258,590.0	280,403.9	270,381.4	11,791.4	

Burimi: Bashkia Dropull

- Nga auditimi rezultoi se: Bashkia Dropull ka patur financime të huaja nga Ambasada Japoneze për vitin 2023;
- Bashkia Dropull nuk ka aplikuar për kredi në vitin 2023 (as në periudhat paraardhëse);
- Bashkia Dropull nuk ka patur subvencione nga shteti;
- Bashkia Dropull ka përfituar nga FSHZH sipas kërkesave të bashkisë:

***Për periudhën objekt auditimi, gjatë vitit 2023 janë dërguar kërkesa për blerje mallrash në FSHZH si më poshtë:**

1. Kërkesë drejtuar FSHZH me nr. 1712 prot, datë 11.10.2022 me objekt “Kërkesë për furnizim Blerje Materiale elektrike për Bashkinë Dropull”.

Bazuar në kërkesën e paraqitur, me shkresën nr 1744/1 prot, datë 14.10.2022, nga FSHZH është paraqitur Marrëveshja Kuadër nr. 2347 Prot., datë 15.08.2022 me objekt: “Loti 2 - Blerje Materiale elektrike sipas kërkesave të Bashkisë Dropull” me fond limit në shumën 956,686 lekë pa Tvsh, me vlerë kontrate në shumën 956,686 lekë pa Tvsh dhe në shumën 1,148,023.2 lekë me Tvsh, me OE “F”.

Bazuar në marrveshje me nr. 3221/1 prot. dt.19.10.2022 midis Bashkise Dropull dhe FSHZH-së, për të tre objektet.

Mallrat janë bërë hyrje në magazinën e Bashkisë Dropull me fletëhyrjen nr. 143/1 datë 27.10.2022. Këto mallra janë shpërndarë për objektin “Rruga Hyrëse e fshatit Sofratikë” të cilat janë bërë dalje me fletëdaljet nr. 145 datë 25.05.2023 dhe flete daljet: 71 dt.26.02.2024.

2. Kërkese drejtuar FSHZH me nr1712 prot, datë 11.10.2022 me objekt “Kërkese për furnizim Blerje Materiale ndërtimi për Bashkinë Dropull”.

Bazuar në kërkesën e paraqitur, me shkresën nr1744/1 prot, datë 14.10.2022, nga FSHZH është paraqitur Marrëveshja Kuadër nr. 3108 Prot., datë 11.10.2022 me objekt: “Loti 1 - Blerje Materiale ndërtimi sipas kërkesave të Bashkisë Dropull” me fond limit në shumën 1,734,482 lekë pa Tvsh, me vlerë kontrate në shumën 1,734,482lekë pa Tvsh dhe në shumën 2,081,378.4 lekë me Tvsh, me OE “V”.

Mallrat janë bërë hyrje në magazinën e Bashkisë Dropull me fletëhyrjen nr. 175, datë 06.12.2022. Këto mallra janë shpërndarë për objektin “Rruga Hyrëse e fshatit Sofratikë” të cilat janë bërë dalje me fletë daljen nr. 235 dt.14.07.2023 dhe për objektin:”Rruga hyrëse e fshatit Vrisera” me fletë daljen nr. 235 dt.14.07.2023.

3. Kërkese drejtuar FSHZH me nr. 1712 prot, datë 11.10.2022 ,me objekt “Kërkese për furnizim materiale mobilimi urban për Bashkinë Dropull”.

Bazuar në kërkesën e paraqitur, me shkresën nr 1744/1 prot, datë 14.10.2022, nga FSHZH është paraqitur Marrëveshja Kuadër nr. 2349 Prot., datë 15.08.2022 me objekt: “Loti 4 - Blerje Materiale mobilimi urban sipas kërkesave të Bashkisë Dropull” me fond limit në shumën 950,000 lekë pa Tvsh, me vlerë kontrate në shumën 950,000 lekë pa Tvsh dhe në shumën 1,140,000 lekë me Tvsh, me OE “L. K.” ShPK.

Bazuar në marrveshje me nr. 3221/1 prot. dt.19.10.2022 midis Bashkise Dropull dhe FSHZH-së, për të tre objektet. Mallrat janë bërë hyrje në magazinën e Bashkisë Dropull me fletëhyrjen nr. 152, datë 04.11.2022.

Këto mallra janë shpërndarë për objektet:1- “Rruga Hyrëse e fshatit Sofratikë” dhe 2- “Rruga hyrëse e fshatit Vrisera” të cilat janë bërë dalje me fletëdaljet: nr.18 dt.21.03.2023,nr.60 dt.28.02.2023 nr. 71, datë 26.02.2024.

***Për periudhën objekt auditimi, gjatë vitit 2023 janë kryer shpenzime nga të ardhura e Bashkisë Dropull me procedura prokurimi si më poshtë:**

1. Me urdhër prokurimi nr. 518/1 prot, datë 20.03.2023, është kryer procedura e prokurimit me objekt “*Blerje materiale ndriçimi*”, me fond limit në shumën 1,400,650 lekë, në të cilën kanë marrë pjesë 3 Operatorë ekonomikë dhe është shpallur fitues OE “E. L.” me vlerë kontrate në shumën 1,555,680 lekë.

Me urdhër shpenzimin nr. 220 datë 19.06.2023 është likujduar fatura me nr. 111/2023 dt 24.05.2023 dhe në shumën 1,078,080 lekë. Mallrat janë bërë hyrje me fletëhyrjen nr. 80 datë 24.05.2023 Për këto mallra është krijuar komisioni i marrjes në dorëzim i cili ka mbajtur aktin e marrjes me datë 24.05.2023.

Me urdhër shpenzimin nr.334 datë 14.08.2023 është likujduar fatura me nr.104 dt 14.07.2023 dhe në shumën 420,000 lekë. Mallrat janë bërë hyrje me fletë hyrjen nr. 104 datë 14.07.2023 Për këto mallra është krijuar komisioni i marrjes në dorëzim i cili ka mbajtur aktin e marrjes me datë 14.07.2023.

Me urdhër shpenzimin nr. 416 datë 23.10.2023 është likujduar fatura me nr. 229/2023 dt 17.10.2023 dhe në shumën 57,000 lekë. Mallrat janë bërë hyrje me fletë hyrjen nr. 133 datë 17.10.2023 Për këto mallra është krijuar komisioni i marrjes në dorëzim i cili ka mbajtur aktin e marrjes me datë 17.10.2023.

2. Me urdhër prokurimi nr. 1286 prot, datë 01.09.2023, është kryer procedura e prokurimit me objekt “**Blerje pajisje mobilje për shkollën e mesme Bularat**”, me fond limit në shumën 1 539 327 lekë, në të cilën kanë marrë pjesë 6 Operatorë ekonomikë dhe është shpallur fitues OE “E”/SH me vlerë kontrate në shumën 1 467 816 lekë.

Me urdhër shpenzimin nr. 463 datë 01.12.2023 është likujduar fatura me nr. 1405/2023 DT 21.11.2023 dhe në shumën 1 467 816 lekë. Mallrat janë bërë hyrje me fletëhyrjen nr. 145 datë 21.11.2023 Për këto mallra është krijuar komisioni i marrjes në dorëzim i cili ka mbajtur aktin e marrjes me datë 21.11. 2023.

▪ Një përmbledhje e procedurave të prokurimit referuar regjistrin të parashikimeve dhe regjistrin të realizimeve të zhvilluara nga Bashkia Dropull gjatë vitit 2023 pasqyrohet si më poshtë:

Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit për vitin 2023 Bashkia Dropull					
Nr. i Procedurave BVV	Vlera totale/ në lekë	Nr. i procedurave të prokurimit	Vlera totale/ në lekë	Numri total procedurave	Vlera totale/ në lekë
25	13,063,877	5	93,097,584	30	106,161,461
Regjistri i realizimeve të procedurave të prokurimit për vitin 2023 Bashkia Dropull					
Nr. i Procedurave BVV	Vlera totale/ në lekë	Nr. i procedurave të prokurimit	Vlera totale/ në lekë	Numri total procedurave	Vlera totale/ në lekë
32	10,894,176	12	121,691,483	45	132,585,659

Burimi: Bashkia Dropull/Punoi: Grupi i auditimit

Nga informacioni i pasqyruar në tabelë *rezulton* se nga Bashkia Dropull janë parashikuar 30 procedura prokurimi në vlerën totale 106,161,461 lekë nga të cilat: 25 procedura BVV në vlerën 13,063,877 lekë dhe 5 procedura prokurimi në vlerën 93,097,584 lekë; janë realizuar 45 procedura prokurimi në vlerën totale 132,585,659 lekë nga të cilat: 32 procedura BVV në vlerën 10,894,176 lekë dhe 12 procedura prokurimi në vlerën 121,691,483 lekë.

▪ Një pasqyrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet faktike të 2 viteve të fundit në tabelën e mëposhtme, *rezulton* se vlera e të ardhurave ka trend në rritje nga viti në vit, ndërsa vlera e shpenzimeve ka trend në rënie.

në mijë lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2023	Trendi
1	Të ardhurat faktike	258,590.0	270,381.4	↗
2	Shpenzimet faktike	239,381.6	237,547.2	↘

Burimi: Bashkia Dropull

➤ **Miratimi i buxhetit faktik:**

Bashkia Dropull me VKB nr. 6 datë 29.02.2024 ka miratuar Raportin vjetor të monitorimit dhe realizimit të buxhetit faktik për vitin 2023, në zbatim të Ligjit nr. 139 /2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 44.

➤ **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak:**

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimit nr. 22 dt.30.07.2018 “Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, rezulton se janë bërë raportimet 4, 8 dhe 12 mujore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, sipas formateve të përcaktuara nga MFE: me shkresën nr. 764 prot., datë 19.05.2023 Raporti i monitorimit për 4 mujorin e parë; me shkresën nr. 1387 prot., datë 26.09.2023 Raporti i monitorimit për 8 mujorin; me shkresën nr. 335/1 prot., datë 29.02.2024 Raportimi 12 mujor. Këto raportime janë dërguar në MFE në rrugë elektronike nga adresa zyrtare institucionale dhe postare në afat; Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion Raporti i Monitorimit të buxhetit të vitit 2023 është miratuar me VKB nr. 6 datë 29.02.2024 dhe është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë.

➤ **Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës:**

Me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë, Fondi i kontigjencës dhe Fondi i Emergjencës, vlerat e planifikimit dhe përdorimit të tyre pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.

Në mijë lekë

Emërtimi	Plan 2023	Fakt 2023	
Fond Rezervë	0	0	
Fond Emergjence	6,000	0	
Fond Kontigjence	0	0	
Mbrojtja Civile	43,158.9	30,197.6	Diferenca
Totali	49,158.9	30,197.6	19,961.3

Burimi: Bashkia Dropull

Përdorimi i këtyre fondeve realizohet me miratimin e Këshillit Bashkiak. Me VKB nr. 73 datë 21.12.2021 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm” **u konstatua** se në buxhetin vjetor të vitit 2023 nuk është planifikuar Fondi Rezervë dhe Fondi i Kontigjencës, në kundërshtim të ligjit nr. 9936/2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” ku përcaktohet se këto fonde llogariten deri në masën 3% të buxhetit pa transfertat e kushtëzuara.

Fondi i Emergjencës është planifikuar në vlerën 6,000 mijë lekë dhe përfaqëson fondet që bashkia planifikon në rastet e fatkeqësive natyrore, të cilat për vitin 2023 nuk janë shpenzuar;

➤ **Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile:**

Referuar kritereve të përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e këtij fondi, nga ana e tyre, Pushteti Vendor/Bashkitë kanë për detyrim të miratojnë a) strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë; b) vlerësimin vendor të riskut; c) planin vendor të emergjencave civile; ç) planin e zhvillimit urban, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

Nga sa më lart, nga auditimi *rezulton* se Bashkia Dropull për vitin 2023 fondin për emergjencat civile ka planifikuar në vlerën e 43,158.9 mijë lekë nga i cili ka shpenzuar 30,197.6 mijë lekë dhe vlera prej 19,961.3 mijë lekë është trashëguar për vitin pasardhës. Ndërsa nga të ardhurat e veta “fondi i emergjencës” është planifikuar në vlerën 6,000 mijë lekë. Në arsyetimin tonë kjo tregon për shpërndarje racionale në përdorimin e tij sipas hallkave të procesit, duke i kushtuar më shumë rëndësi masave paraprake për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore.

Fondi që bashkitë duhet të kenë është në masën 4% të shpenzimeve buxhetore të fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 65/1.

➤ **Realizimi i Investimeve:**

Planifikimi dhe realizimi i investimeve për vitin 2021 dhe 2023 për bashkinë Dropull, me burim "financimi nga të ardhurat e veta" [AV] dhe "transferta e pakushtëzuara", pasqyrohet në tabelën më poshtë:

në mijë lekë

230-231	2022	2023			
	Fakt	Plan	Fakt	Diferenca ndaj planifikimit	Diferenca ndaj faktit
	97,632.8	72,113.0	64,293.6	(-7,819.4)	(-33,339.2)

Burimi: Bashkia Dropull

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2023 investimet kanë mosrealizim kundrejt planifikimit me një diferencë në vlerë prej (-)7,819.4 mijë lekë, por në krahasim me vitin 2022 ka një rënie prej (-)33,339.2 mijë lekë.

Nga informacioni dokumentar i vënë në dispozicion, rezultoi se në vitin 2023 janë 13 projekte me burim nga të ardhurat e bashkisë në vlerën totale 145,052 mijë lekë; dhe 6 projekte me burim nga granti në vlerën totale 413,138 mijë lekë; vetëm për vitin 2023 vlera e planifikuar në buxhet është prej 72,113 mijë lekë nga 145,052 mijë lekë të vlerës totale të tyre.

Duke iu referuar të dhënave në tabelën e mëposhtme “të investimeve” nga të ardhurat e vet Bashkisë Dropull, rezultoi si më poshtë vijon:

230-231	Burimet e Financimit	Viti 2023		%
		Plan	Fakt	
	Të ardhurat e veta	24,545.0	23,732.6	96.7
Transferta specifike/sectoriale	8,363.0	8,363.0	100	
Transferta e pakushtëzuar	39,205.0	32,198.0	82.1	
Totali	72,113.0	64,293.6	89.2	

Burimi: Bashkia Dropull

Konstatohet se mosrealizimi buxhetit për “investimet” në arsyetimin e grupit të auditimit, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin e viteve paraardhëse, pavarësisht faktit që të ardhurat veçanërisht të ardhurat e veta, kanë ardhur në rritje nga viti në vit, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, Ligji nr. 67 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 36, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizmit faktik të tyre në vitet paraardhëse.

➤ **Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.**

Përsa i përket situatës së pandemisë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se Bashkia Dropull gjatë vitit 2023 nuk ka patur fonde të planifikuara dhe rrjedhimisht as të shpenzuara për nevoja specifike të situatës.

Nga analiza e të dhënave të buxhetit rezulton se ka diferenca të dukshme midis treguesve në hartimin e planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta në vlerën 108,507.5 mijë lekë dhe shpenzimeve të tyre në vlerën 84,362 mijë

lekë, kështu nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2022 dhe 2023 të ketë mosrealizime, ndonëse vlera e të cilit vjen me trend në rënie nga 61.2% në vitin 2022 në 84.7% në vitin 2023.

5. Me VKB nr. 73 datë 21.12.2021 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm” rezultoi se në buxhetin vjetor të vitit 2023, nuk është planifikuar Fondi Rezervë dhe Fondi i Kontigjencës, në kundërshtim me ligjin nr. 9936/2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” ku përcaktohet se këto fonde llogariten deri në masën 3% të buxhetit pa transfertat e kushtëzuara.

6. Nga auditimi rezultoi se në vitin 2023 janë nisur 13 projekte me burim nga të ardhurat e bashkisë në vlerën totale 145,052 mijë lekë; dhe 6 projekte me burim nga granti në vlerën totale 413,138 mijë lekë; vetëm për vitin 2023 vlera e planifikuar në buxhet për këto investime është 72,113 mijë lekë nga 145,052 mijë lekë të vlerës totale të tyre. Nga analiza e treguesve të tabelës së të ardhurave të veta, rezulton se diferenca mes realizimit faktik të të ardhurave të veta ndaj planifikimit ka trend në rritje si edhe realizimi i të ardhurave të veta; Kjo ka sjellë që në vitin 2023 “Investimet” kundrejt planifikimit të kenë një mosrealizim prej (-)7,819.4 mijë lekë dhe kundrejt faktit të vitit 2022 të jenë prej (-)33,339.2 mijë lekë.

Ky konstatim sipas grupit të KLSH-së, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat për asnjë nga vitet (2022 dhe 2023) nuk janë realizuar, veprime këto që bien ndesh me Ligjin nr. 67 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 36, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre në vitet paraardhëse.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “c” dhe “ç”; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, ligjin nr. 88, datë 18.12.2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, Aktin Normativ Nr.15, datë 15.4.2020, Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 65/1; Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve: (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si Ministrinë e linjës etj.).

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet duhet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës (progresive). Me fondet e vitit buxhetor ushtrimor, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të pa likuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për

shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministritë e linjës apo FZHR është konfirmuar se nuk ka detyrime të prapambetura.

Në PBA 2023-2025 dhe Planin vjetor 2023, Bashkia Dropull ka planifikuar fonde me qëllim mos lënien jashtë buxhetimit të programit “likujdimi i detyrimeve të prapambetura”¹¹.

Situata e detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhëse në buxhetet respektive për vitin 2023, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

Në lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2022	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2023	Total detyrime	Shlyerja gjate 3 mujorit të tretë 2023	Mbetja në fund të vitit 2023
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministritë e linjës	180.191.049			180.191.049	0
b. Investime nga Bashkia					0
Investime					0
Mallra dhe shërbime	8.960.119	0		4.480.060	4.480.059
Vendime gjyqësore					0
Të tjera ...					0
Totali	189.151.168			184.671.109	4.480.059

Burimi: Bashkia Dropull

Me mbylljen e vitit ushtrimor, rezultojnë edhe vlerat e sakta të detyrimeve; gjithashtu kolona e gjendjes në fund të vitit 2022 është në vlerën e 189,151,168 lekë (investime nga ministritë e linjës dhe mallra dhe shërbime).

Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë edhe në rrugë elektronike.

Raportimi në ministri është bërë sipas udhëzimit nr. 2 datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, pika 106, ku citohet:

“Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara që jo më vonë se data 10 Prill 2020 për remujorin e parë, 10 Korrik 2020 për tremujorin e dytë, 10 Tetor 2020 për tremujorin e tretë dhe 30 Janar 2021 për tremujorin e katërt, të dërgojnë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë informacionin me shkrim dhe në rrugë elektronike për detyrimet e prapambetura sipas Shtojcës 5, “Raportimi periodik për detyrimet e prapambetura” bashkëlidhur këtij udhëzimi.”¹²

Raportimi në degën e thesarit është bërë sipas udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

- Deri në 31.12.2022 është në vlerën totale 189,151,168 lekë, ku 8,960,119 lekë janë për “detyrime për shërbime” nga të ardhurat e veta; 180,191,049 lekë “për investime” nga ministritë e linjës.;

- Për vitin 2023 nga vlera e planifikuar e miratuar me VKB për likujdim prej 184,671,108 lekë, nga të cilat nga ministritë e linjës është paguar shuma e plotë prej 180,191,049 lekë dhe nga të ardhurat e bashkisë është paguar shuma 4,480,060 lekë ose 50% e saj, duke trashëguar për tu likuiduar në vitin 2024 detyrimin në vlerën 4,480,059. Rezulton se në total janë likuiduar gjatë vitit 2023 shuma prej 184,671,108 lekë ose 97.6% e saj. Situata është me trend përmirësimi të dukshëm, rezultuar kjo me moslindjen e detyrimeve të reja gjatë vitit 2023. Një pasqyrim të detajuar të detyrimeve të prapambetura për periudhën deri më 31.12.2023, jepen në tabelën e mëposhtme:

¹¹ Sic është përmendur edhe më lart, në PBA 2023-2025, nuk është planifikuar fond në buxhet për programin detyrime të prapambetura.

¹² Në raportimet e bëra respektohet viti ushtrimor në të cilin realizohen shpenzimet vjetore të planifikuara në PBA

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emerimi i detyrimit te prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2021	Vlera e planifikuar për likuidim në planin e buxhetit 2023 për detyrimet e prapambetura	Vlera e paguar gjatë vitit 2023 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të paguara më 31.12.2023 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2023)	Detyrimi prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2023 (situata më 31.12.2023)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2023
1	2	3	4	5	6=3-5	7	8=6+7
I. Detyrime që kanë si burim financimi të ardhurat e veta							
4864100	Detyrime për vendime gjyqësore paga						
4864200	Detyrime për sherbime	8,960,119	4,480,059	4,480,060	4,480,059	0	4,480,059
4864300	Detyrime për mirembajtje						
4864400	Detyrime për investime						
4864400	Detyrime për nga Ministrite e Linjes (specifiko FZHR etj...)						
4865600	Detyrime për mallra						
4864900	Detyrime te tjera/V.Gjyq						
	Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta						
II. Detyrime te prapambetura nga granti (FZHR etj (Ministrite e linjës)							
4864400	Detyrime për Investime nga Ministrite e Linjes (Min. e Infrastruktures)	180,191,049	180,191,049	180,191,049			0
4864100	Detyrime për vendime gjyqësore (Min. e Brendshme per punonjes te GJ.Civile)	0	0	0	0	0	0
	Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi Grantin	0	0	0	0	0	0
Detyrime ne total nga të ardhurat e veta +grantit(I+II)		189,151,168	184,671,108	184,671,108	4,480,059	0	4,480,059

Burimi: Bashkia Dropull

Në mënyrë analitike po pasqyrojmë detyrimet e prapambetura, vitin e krijimit, likuidimet pjesore apo të plota, vlera e detyrimit e mbartur për vitin 2023.

I DETYRIMET ME BURIM FINANCIMI FONDET E BASHKISE

A. Vendimet Gjyqësore

Nr	Kreditori	Vlera sipas V.Gjykates	GJENDJE 31.12.2021	PAGUAR 2023	Detyrim i krijuar në 2023	GJENDJE 31.12.2023	burimi financimit
NUK KA							

Bashkia Dropull nuk ka detyrime të prapambetura për vendime të proceseve gjyqësore.

B. Detyrime për Investimet (Fatura të palikuiduara)

Nr	Emërtimi i Objektit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Numri i faturës	Data e Fatutës	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2022	Shtesat gjate vitit 2023	Shlyerjet gjatë vitit 2023	Gjendja 31.12.2023
1	Supervizim Rikonstruksion rruga terihat sofratik	Z. & co	08.05.2023	168/2023	26.12.2023	0	573,102	0	573,102

2	Rikonstrukcion I rruges terihat	L.T.E.C.	20.04.2023	112/2023	26.10.2023	0	821,710		821,710
Totali i detyrimit									1,394,812

Janë 2 investime të planifikuara dhe të kontraktuara me dy subjekte të ndryshme, për të cilat janë paraqitur në bashki për tu paguar 2 fatura në vlerën totale 1,394,812 lekë. Nga auditimi rezulton se brenda vitit ushtrimor 2023 nuk është bërë asnjë pagesë , pra për njëjën prej tyre është kaluar kufiri kohor prej 60 ditësh;

Nga libri i bankës 2024 u verifikua se:

- fatura nr. 168/2023 datë 26.12.2023 është paguar me USH nr. 21 datë 22.01.2024 në vlerë të plotë;

- fatura nr. 112/2023 datë 26.10.2023 është paguar me USH nr. 98 datë 26.03.2024.

Rezultoi se mospagesa për faturën e parë nuk është bërë brenda afatit për mungesë të fondeve dhe se nga subjekti na u komunikua se vlera e saj prej 821,710 lekë se u harrua të deklarohej si detyrim i prapambetur i tij (gabim njerëzor).

C. Detyrime për Mallra dhe Shërbime (fatura të palikuiduara)

Nr	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Numri i faturës	Data e Faturës	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2022	Shtesat gjate vitit 2023	Shlyerjet gjatë vitit 2023	Gjendja 31.12.2023
1	ENERGJI	FSHU	25.08.2022			8,960,119	0	4,480,060	4,480,059
2	KESHILLTARET								741,047
	% POSTA								547,525
	NDIHME EKONOMIKE								87,713
	UJI								236,376
	CELULAR								16,000
									14,500
	Totali i detyrimit dhjetor 2023								1,643,161
Totali									6,123,220

Konkluzion: Nga auditimi rezultoi se Bashkia Dropull është debitore për “investime” të vitit 2023 ndaj një subjekti në shumën e detyrimit prej 821,710 lekë;

-“për mallra e shërbime” të muajit dhjetor të cilat paguhen në muajin pasardhës janar 2024 në shumën totale prej 1,643,161 lekë; (kjo vlerë nuk hyn te detyrimet e prapambetura)

- ndaj ish-OSHEE tani FSHU, ka lidhur një akt marrëveshje në datën 25.08.2025 për pagesën e detyrimit të akumuluar prej 8,960,119 lekë në dy vite 2024 dhe 2025 me 4,480,059 lekë për secilin vit.

- nuk ka detyrime për vendime të proceseve gjyqësore për dëmshpërblim page, shpronësime etj.

II DETYRIME ME BURIM FINANCIMI NGA BUXHETI I SHTETIT(GRANTI).

	Emërtimi	OBJEKTI	Numer fature/date	GJENDJE 31.12.2022	PAGUAR 2023	DETYRIMI I KRIJUAR GJATË 2023	GJENDJE ME 31.12.2023	burimi financimit
1				0	0	0	0	granti

	TOTALI DETYRIMEVE NGA FZHR etj	0	0	0	0
2					
	TOTALI DETYRIMEVE NGA MINISTRI TE LINJËS		0	0	0
	TOTALI DETYRIMIT INVESTIME			0	0
	TOTALI I DETYRIMIT I + II				

Burimi: Bashkia Dropull

Konkluzion: Bashkia Dropull nuk ka detyrime të mbartura nga viti 2023 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2024 për “investime” nga ministrinë e linjës;

- Nuk ka detyrime të mbartura nga viti 2023 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2024 për “mallra e shërbime” nga ministrinë e linjës;

- Nuk ka detyrime për vendime të proceseve gjyqësore për dëmshpërblim page, shpronësime etj.

➤ **Programimi i fondeve për faturat e pa likuiduara në fund të periudhave ushtrimore:**

Nga auditimi i PBA 2023-2024/Planit vjetor 2023, referuar edhe tabelës së programeve buxhetore të planifikuara, rezultoi se nuk është planifikuar veçmas fondi në *programin 04960 “planifikim për detyrimet e prapambetura”*. Nga auditimi i likuiditeteve rezulton se nuk kanë lindur detyrime të reja gjatë vitit 2023 por janë trashëguar për vitin 2024 gjysma e vlerës totale të detyrimit të prapambetur mbartur nga viti 2022 për “mallra e shërbime”.

Situata e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit ushtrimor 2023 dhe klasifikimi i bashkisë mbi shkallën e vështirësisë financiare është si më poshtë:

në lekë

Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore			
Nr.	EMERTIMI	Vlera për periudhën e raportimit (Fakt viti 2023)	Vlera e Buxhetit vjetor (Plan viti 2023)
I	Të ardhurat e Pushtetit Vendor	84,389,000	106,005,000
1	Taksat e veta vendore	20,872,000	26,673,000
a.	Taksa mbi pasurinë	19,298,000	20,100,000
b.	Biznesi i vogel	133,000	123,000
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	511,000	5,450,000
d.	Taksa të tjera vendore	930,000	1,000,000
2	Të ardhura jotatimore	55,971,000	72,412,000
a.	Tarifat e shërbimeve publike	24,702,000	26,154,000
b.	Tarifa administrative	4,017,000	7,004,000
c.	Të tjera jo tatimore	27,252,000	39,254,000
3	Taksa të ndara	7,546,000	6,920,000
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	0	100,000
b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	4,379,000	4,200,000
c.	Renta minerare	1,000	120,000
d.	Tatim mbi të ardhurat personale	3,166,000	2,500,000
e.	Të tjera	0	0
II	Shpenzime te Buxhetit Vendor	237,547,000	280,403,900
1	Shpenzime Korrente	173,253,000	208,290,900
a.	Paga dhe fond i veçantë për paga	98,973,000	109,309,100
b.	Kontributi për Sigurime Shoqërore	16,454,000	18,280,300
d.	Shpenzime Operative	52,149,000	68,576,000

e.	Të tjera korrente	5,677,000	12,125,500
2	Shpenzime Kapitale	64,294,000	72,113,000
3	Burimet e Financimit	270,381,647	291,997,000
a.	Të ardhurat e veta vendore	84,389,000	106,005,000
b.	Transferta e pakushtezuar	114,865,025	114,858,000
c.	Transferta specifike/transferta e pakushtezuar sektoriale	51,919,718	51,926,000
d.	Të ardhurat e pa-planifikuara (TE TRASHEGUARA NGA 2022)	19,207,904	19,208,000
f.	Financimi i huaj		
g.	Huamarrja Vendore Vjetore		

Burimi: Bashkia Dropull

Nr	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a.1	Marrëveshje financimi (kredi, overdraft etj)	0		
a.2	Tituj të emtuar	0		
a.3	Garanci për të tretë	0		
b	Hua afatshkurtër	0		
b.1	Marrëveshje financimi (kredi, overdraft etj)	0		
b.2	Tituj të emtuar	0		
b.3	Garanci për të tretë	0		
II	Detyrime të prapambetura	4,480,059		2.23%
Llogaria ekonomike	Emërtimi			
4864100	Vendime gjyqësore	0		
4864200	Det.prap.shërbime	0		
4864201	Det.prap.Energji elektrike	4,480,059		
4864300	Det.prap.mirëmbajtje	0		
4864400	Det.prap.Investime	821,710		
4864500	Det.prap.Rimbursim TVSH	0		
4864600	Mallra	0		
4864900	Det.prap.te tjera	0		
4864601	Det.prap. sig. shoqërore	0		
4864602	Det.prap. sig. shëndetsore	0		
4864603	Det.prap.ardhura personale	0		
4864604	Det Prap. Tatime të tjera	0		
4864901	Paga	0		
4864902	Shpronësime	0		
4864903	Trans. individe	0		
4864904	Trans .subjekte	0		
III	Totali (I+II)	5,301,769	237,547,000	2.23%

Burimi: Bashkia Dropull

Rasti i vështirësisë ku ndodhet njësia e vetëqeverisjes vendore				
Situata Normale e gjendjes financiare	Probleme financiare	Vështirësi financiare	Vështirësi serioze financiare	Paaftësi paguese
	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 15%	Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 25%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 80%	Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 130%
2.23% normale	0	0	0	0

Burimi: Bashkia Dropull

Nga informacioni i pasqyruar në tabelë dhe i raportuar në MFE, rezulton se Bashkia Dropull paraqet një situatë normale të vështirësisë financiare, e cila është e trashëguar nga vitet parardhëse dhe i përket faturave të papaguara ndaj OSHEE tani FSHU.

Për sa më sipër përgjegjësia kryesore për veprimet apo mosveprimet i ngarkohet Titullarit të bashkisë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të Riskut, GMS dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, përcaktuar në Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar.

Mbi planifikimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të krijuara nga detyrimet kontraktuale për mallra, shërbime dhe investime u konstatua se: në PBA 2023-2025/Planit vjetor 2023, referuar edhe tabelës së programeve buxhetore të planifikuara, u konstatua se fondi për detyrimet e prapambetura nuk është planifikuar veçmas në programin 04960 “planifikim për detyrimet e prapambetura”, por është përlogaritur i përfshirë në fondin e secilit program që mbart detyrime; mos ndarja e fondeve sipas programeve përkatëse pra sipas destinacionit të përdorimit, ka sjellë likuidimin pjesor apo të plotë të detyrimeve të prapambetura (sipas rastit) dhe pamundësi likuiditeti të të gjitha faturave për "mallrave e shërbime" e "investimeve" brenda afatit 60 ditor për mungesë fondesh, duke riskuar për lindjen e detyrimeve të reja. Rezultoi se vlera e detyrimeve të prapambetura sipas bilancit përputhet me atë të raportuar në MFE. Në gjykimin e grupit të auditimit planifikimi i fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në programin përkatës 04960, do të rezultonte me një menaxhim më me efektivitet të fondeve për çdo program të buxhetuar, në rast se nuk do të ishin reduktuar numri i programeve buxhetore nga MFE nëpërmjet udhëzimeve përkatëse: Udhëzimit nr. 23 datë 30.07.2018, Udhëzimit nr. 7 datë 25.02.2022 etj.

- Bashkia Dropull është debitore për “investime” ndaj një subjekti në vlerën 821,710 lekë, për 1 faturë të vitit 2023 në tejkalim të afatit 60 ditor dhe e pa deklaruar si detyrim i prapambetur;
- Bashkia Dropull është debitore nga OSHEE tani FSHU për “shërbime” në vlerën debitore progresive 4,480,059 lekë, pagesë e cila bëhet me këste sipas akt marrëveshjes së lidhur mes palëve.

Për sa më sipër përgjegjësia kryesore për veprimet apo mosveprimet i ngarkohen:

Titullarit të bashkisë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të Riskut, GMS dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, përcaktuar në Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar.

2.5. “Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor”.

Në lidhje me këtë nënpikë u kërkua dokumentacioni si më poshtë:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Dropull për miratimin e paketës/ve fiskale të vitit 2023, me ndryshime;
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet, familjarët, taksat e tokës, etj;
- Dokumentacioni i sektorit të taksave dhe tarifave vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga Programi Excel i mbajtjes së sistemit të taksave;
- Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, për taksat dhe tarifave vendore;
- Pasqyrat financiare për vitin 2023. Miratimet e buxheteve në lidhje me planifikimin e të ardhurave për vitin 2023;

- Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimin faktik të të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacioni në lidhje me agjentët tatimorë, rakordimet me ta, me thesarin, etj.;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik dhe zyra e tatim-taksave.

Viti 2022			
Nr	Njësi Administrative	Nr. Fshatra/lagje	Nr. Banorë
1	Dropull i Sipërm	18	
2	Dropull i Poshtëm	16	
3	Pogon	7	
Totali		41	

Burimi: Bashkia Dropull

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatua si më poshtë vijon:

➤ **Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

Për vitin 2023 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 2, datë 04.01.2023 me nr. 3 prot., datë 04.01.2023, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Dropull dhe Njësi Administrative Dropull i poshtëm, Dropull i Sipërm, Pogon dhe MZSH-së”, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së Ardhurave dhe Tarifave [DTT], e cila sipas strukturës së vitit 2023 është e përbërë nga 1 sektor dhe në total ka 6 punonjës; Struktura e Drejtorisë së të Ardhurave dhe Tarifave përbëhet: Drejtori (1), përgjegjësi (1) që mbulon taksat dhe tarifat e biznesit të madh e të vogël; 1 specialist për debitorët familjarë; 1 specialist për taksat e tarifat e familjarëve; dhe 2 punonjës mbështetës për taksat në Njësitë Administrative.

Struktura e Drejtorisë së të Ardhurave - [DA] për vitin 2023 është si më poshtë:

Nr.	Emri Mbiemri	Funksioni sipas Strukturës	Profili arsimor	Niveli	Pozicioni i punës
1.	L.Xh.	Drejtor	Ekonomist	M.shkencor	
2.	J.M.	Përgjegjës	Financë	-/-	Taksat e tarifat për biznesin e madh e të vogël
3.	M.M.	Specialist Tatim Taksa	Ekonomist	-/-	Debitorët familjarë
4.	L.Q.	Specialist Tatim Taksa	Ekonomist	M.Profesional	Taksa e tarifa për familjarë
5	N.H.	Punonjës mbështetës	E përgjithshme	I mesëm	NJA Pogon
6	E.Xh.	Punonjës mbështetës	E përgjithshme	-/-	NJA Dropull i Sipër NJA Dropull i Poshtëm

Burimi: DTT/Bashkia Dropull

Drejtorja e të Ardhurave Vendore [DAV] në analizat periodike që zhvillon mbi aktivitetin e drejtorisë në vjeljen e taksave e tarifave apo pagesat e detyrimeve të prapambetura, për çdo raportim të transmetuar nga personat përgjegjës, harton dhe një plan masash periodike për përmirësimin e punës në arritjen e objektivave. Në fillim të çdo viti DAV bën raportimin vjetor mbi analizën e të ardhurave vjetore të Bashkisë që për vitin 2023 është me nr. 164 prot., datë 01.02.2024. Specialistët bëjnë verifikime në terren për pajisjen e subjekteve me tabela, për ndryshime të objekteve ku ushtrohet biznesi etj. Informacioni i mbledhur përpunohet nga specialisti i biznesit, i cili mbështetur te paketa fiskale e vitit ushtrimor, bënë rilloaritjen e taksave

dhe tarifave për çdo biznes. Nisur nga karakteristika e pozicionit gjeografik, komuniteti i Bashkisë Dropull është emigrator, dhe kjo është arsyeja që DA e ka copëtuar në 4 periudha 3 mujore mundësinë e pagesave të taksa e tarifave vjetore nga ana e komunitetit. Kjo ka sjellë mosrespektim të pagesave të taksa e tarifave brenda afateve të përcaktuara, por pagesat vjetore të arkëtuara brenda vitit ushtrimor. Paketa fiskale e miratuar nga KB me Vendimin nr. 63 datë 24.11.2022 dhe me nr. 1970 prot., datë 24.11.2022 dhe Planin vjetor 2023 ka parashikuar për vitin 2023 në vlerë 106,005 mijë lekë ku përfshihen: të Ardhura nga taksa lokale në vlerën 26,673 mijë lekë; të Ardhura nga taksa të ndara në vlerën 6,920 mijë lekë; të Ardhurat nga tarifavat vendore në vlerën 26,154 mijë lekë; të Ardhura të tjera (qira nga asetet, gjobat, shitja e asetëve, grante ndërkombëtare etj) në vlerën 46,258 mijë lekë. Realizimi i tyre për vitin 2023 ka qenë 84,389 mijë lekë.

-DAV Bashkia Dropull informacionin tatimor e përpunon në paketën Microsoft Office 2013 - programi *excel*. **U konstatua** se mungesa e një sistemi IT bashkëkohor vetëm për të ardhurat vendore, sjellë vështirësi në administrimin e informacionit tatimor nga ana e DAV, për të gjitha subjektet tatimpaguese të biznesit të vogël edhe të biznesit të madh, klasifikimi sipas kategorisë së detyrimit, interesat, rregjistrimin e gjobave dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit etj.

- DAV verifikon dhe përditëson dokumentacionin e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore.

➤ **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve**

Për vitin 2023, Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 63, datë 24.11.2022, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1164/1 prot., datë 09.12.2022. Nga të dhënat e **pasqyrës përmbledhëse** më poshtë, rezulton se për vitin 2022 të ardhurat nga taksat dhe tarifavat janë realizuar në vlerën 59,698 mijë lekë ose masën 83.9%; ndërsa për vitin 2023 janë realizuar në vlerën 84,389 mijë lekë ose në masën 79.6%. Pra nga viti 2022 në vitin 2023 ka patur një rritje të të ardhurave në vlerë prej 24,691 mijë lekë.

-*Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin*, me ndryshimet në kuadrin ligjor tatimor nuk planifikohet, por në vitin 2023 është arkëtuar shuma 20 mijë lekë si detyrim i prapambetur

- Për *Taksa e kalimit e të drejtës në pronësi* referuar paketës fiskale, rezulton se për dy vitet e njëpasnjëshme 2022 e 2023 nuk është parashikuar vlerë, për shkak të mungesës së bashkëpunimit me ASHK Rajonale Gjirokastrë. Drejtoria e të Ardhurave Vendore *nuk ka bërë* rakordimet me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Gjirokastrë (ASHKT), por rakordimet i bën nëpërmjet Degës së Thesarit Gjirokastrë;

- Nga ana e DAV na u komunikua se me UK Dropull nuk ka patur bashkëpunim për të marrë mbi vete rolin e agjentit tatimor. Tani UK Dropull i ka kaluar UK Rajonale Gjirokastrë.

- Rolin e UK Dropull si agjentit tatimor e ka luajtur Zyra e postës filliali Gjirokastrë, nëpërmjet Akt marrëveshjes nr. 531 prot., datë 29.03.2023 me objekt “ Mbi arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore: taksë e tokës, e truallit, e ndërtesës, tarifë pastrimi, ndriçimi –shërbim varrezash, qira trualli, si dhe çdo lloj takse apo tarife tjetër të Bashkisë Dropull”.

Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2022/2023

në 000/lekë

Nr	Lloji i Taksës	Viti 2022			Viti 2023		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
I	Të ardhura nga Tatimet						
1	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	0	50		0	20	
Nëntotali I			50			20	

II	Të ardhura nga Taksat						
2	Taksë mbi Biznesin e vogël						
3	Taksa e ndërtesës	9,500	9,339	98.3	9,500	9,137	96.2
4	Taksa mbi tokën bujqësore	7,800	7,889	101.2	7,800	7,758	99.5
5	Taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve	3,400	4,187	123.2	4,200	4,379	104.3
6	Taksa e ndikimit në infrastrukturë	5,000	3,613	72.3	5,450	511	9.4
7	Të ardhura personale	1,700	2,486	146.3	2,500	3,166	126.6
8	Taksë tabelle	1,000	985	98.5	1,000	930	93
9	Taksë hoteli	123	121	98.4	123	113	92
10	Taksë parkimi	100	133	133	100	140	140
11	Taksë për hapësirë publike	100		0	100	0	0
12	Taksë e rentës minerare	120	2	1.7	100	1	1
13	Taksë mbi truallin	2,500	2,686	107.4	2,800	2,402	85.8
14	Taksa mbi kalimin e te drejtes se pasurise te paluajtshme	100		0	100	0	0
	Nëtotal II	31,443	31,441	99.9	33,793	28,537	84.5
III	Tarifat						
	Tarifë pastrimi	12,760	12,808	100.4	13,160	12,554	95.4
	Tarifë shërbime të tjera publike						
	Tarifë leje transporti	100	70	70	100		0
	Tarifë urbanistike	1,300	175	13.5	1,300	159	12.2
	Tarifë regjistrimi biznes i ri	50	67	134	50	36,226	
	Tarifë ndriçimi rrugor	1,000	843	84.3	1,000	832	83.2
	Të ardhura të tjera (administrative-rregullatore)	1,975	1,975	100	1,914	2,082	109
	Tarifë vendore për varreza	500	467	94	500	424	85
	Tarifë vendore për leje shfrytëzim karburanti	1,000	1,329	133	1,000	1,267	127
	Të ardhura nga shërbimi MZSH	200	58	29	200	88	44
	Të ardhura nga shfrytëzim karrierash	150	27	18	150		0
	Tarifë vendore për certifikatë përdorimi		505				
	Tarifë vendore e sistemime të jashtme për leje ndërtimi		30				
	Tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi		26				
	Tarifë vendore për shqyrtim ose nxjerrje dosje		8				
	Tarifë vendore për konfirmim hartash						
	Tarifë vendore për leje ndërtimi		143				
	Tarifë vendore për piketim objekti		66				
	Tarifë vendore për kontroll shfrytëzim territori					50	
	Nëntotali III	19,035	18,597	97.7	19,424	17,668	91
IV	Të tjera (të ardhura jotatimore)						
	Qira toke bujqësore	60	105	175	105	105	100
	Shitje dhe privatizim banese						
	Qira kullote	4,550	3,106	68.3	4,760	3,427	72
	Tarifë shfrytëzimi lënde drusore	10,000	112	1.1	5,054	4,731	86.5
	Shitja e produkteve pyjore	200	227	114	200		0
	Të ardhura nga shitja e mallrave (vadiçja)	1,500	1,040	69.4	1,500	1,135	75.7
	Të ardhura nga shitje Trualli	1,500	642	43	1,500	684	45.6
	Të ardhura nga qiradhënia/ndërtesa	50	57	114	126	171	136
	Të ardhura, sponsora dhe garanci	1,000	1,662	166	38,943	27,252	70
	Detyrime te prapambetura						
	Kamatvonesa						

Gjopa të Policisë Bashkiake	200	489	244.5	500	461	92.2
Gjopa të IMTV						
Të tjera të ardhura (pronat fondi pyjor)	1,600	122	7.6	120	122	101.7
Të ardhura të tjera	30	2,049	68.3	30	76	253
Nëntotali IV	20,690	9,611	46.5	52,838	38,164	72.3
GJITHSEJ I+II+III+IV	71,168	59,699	83.9	106,055	84,389	79.6

Burimi: Bashkia Dropull

➤ **Analizë e planifikimit të të ardhurave dhe e realizimit të tyre për vitin 2023**

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelën përmbledhëse rezulton si mëposhtë vijon:

- TNI për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 5,450 mijë lekë dhe është mundur të vilet 511 mijë lekë ose 9% e vlerës së planifikimit, me një rënie prej 3,102 mijë lekë më pak se në vitin 2022;
- Taksë për zënien e hapësirës publike, për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 100 mijë lekë dhe është arkëtuar 0 (zero) lekë për dy vite radhazi 2022 e 2023;
- Taksa e rentës minerare, sipas parashikimit për vitin 2023 është në vlerën 120 mijë lekë, rezulton se gjatë vitit 2023 është mundur të arkëtohen për llogari të bashkisë 1 mijë lekë ose 1% e vlerës së parashikuar dhe në krahasim me vitin 2022 kjo vlerë ka ardhur në rënie me 1%;
- Taksa e kalimit të pronësisë për vitin 2023 nuk ka arkëtime, parashikuar në vlerën 100 mijë lekë. Duhet theksuar se edhe për vitin paraardhës 2022 nuk ka arkëtime për llogari të Bashkisë Dropull.

➤ **Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:**

Konstatohet se në Rregulloren e brendshme të institucionit të miratuar, nuk është caktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me agjentët tatimorë, si dhe krijimin e një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët:

1. Për Taksa vjetore e mjeteve të përdorura, mbledhet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor/DRSHTRR Gjirokastër”, për llogari të Bashkisë Dropull. Në zbatim të ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar dhe në mbështetje të gërmës “b”, të pikës 2, në nenin 25 “Të ardhurat nga taksat e ndara” të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njësive përkatëse i kalojnë 25% e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura.

2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, mbledhet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria Rajonale e Tatimeve (DRT) Gjirokastër”. Në zbatim të ligjit nr. 181 datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32 datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël” Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore ku biznesi i tatueshëm është i vendosur, Administrata Tatimore Qëndrore, brënda datës 10 të muajit pasardhës, bën transferimin e të ardhurave nga ky tatim. Me ndryshimet në kuadrin ligjor Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin nuk vilet, shfuqizuar me Ligjin nr. 29/2023, datë 30.03.2023.

3. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mbledhet nga Agjenti Tatimor “Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) tani ASHK Vendore

Gjirokaštër”. Deri tani ASHK Vendore Gjirokaštër nuk ka patur bashkëpunim me Bashkinë Dropull. Ndonëse nga ana e Bashkisë Dropull kanë vijuar kërkesat nga shtatori i vitit 2023 e deri më 31.12.2023, nuk është arritur asnjë bashkëpunim mes tyre. për dërgim informacioni mbi numrin e kalimeve të pronësisë, vlerën totale të tyre me qëllim rakordimin e vlerës së derdhur nëpërmjet Degës së Thesarit Gjirokaštër me vlerën e përlllogarit. Me kërkesën drejtuar ASHK Drejtoria Qendrore, konfirmohet fillimi i bashkëpunimit midis dy institucioneve, me raportimin listës emërore të procedurave të kalimit të pronësisë së objekteve të paluajtshme. Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme tani ASHK Rajonale, janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë si komision 3% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë jo me vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria.

U konstatua se deri në 31.12.2023 rakordimet me ASHK Vendore Gjirokaštër, për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, nuk janë kryer.

4. Bashkia Dropull vjelë rentën minerare, për gjashtë subjekte të regjistruar për aktivitete shfrytëzimi të vendburimeve me minerale brenda territorit të Bashkisë Dropull. Kjo realizohet nëpërmjet akt rakordimeve mujore me Drejtorinë e Doganave dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokaštër. Kjo verifikuar edhe nga Regjistri i lejeve minerare aktive të AKBN-së (Agjencia Kombëtare e Burimeve Nayrore)¹³.

Nr në Regjistrin e AKBN	Nr. Lejes	Data	Emri i subjektit	Nipt	Emertimi i vendburimit	Lloji i mineralit	S=km ²	Totali i Pagesave	E ardhura e bashkisë
97	762/1	23.12.2014			Frashtan/Dropull	Gëlqeror pllakor	0.01	198,998	9,924.70
101	772/1	10.02.2015			Derviçan/Dropull	Gur Gëlqeror	0.01	188,281	9,414.05
149	953/1	21.06.2016			Jergucat/Dropull	Gëlqeror pllakor	0.0298	201,500	10,075.00
153	966/1	24.06.2016			Jergucat/Dropull	Gëlqeror pllakor	0.045	123,182	6,159.10
363	1591	14.11.2012			Dervican/Dropull	Gëlqeror pllakor	0.0509	198,998	9,949.90
					Jergucat/Dropull	Nxjerrje guri		209,412	10,470.60
6							0.1457	1,119,867	55,993.35

➤ **Detyrimet nga qiratë e sipërfaqeve pyjore/tokave bujqësore**

Bashkia Dropull ka sipërfaqe bujqësore në pronësi të saj transferuar me VKM nr. 433/2016 si mëposhtë:

Emërtimi i asetit	Sip. në ha
Pyje	10,641.01
Kullotë	14,911.99
Toka joproductive	28.10
Shkëmbore e ujore	30.03
Totali	25,611.13

¹³<http://ëëë.akbn.gov.al/rregjistri-i-lejeve-minerare-aktive/>

Tokat bujqësore të Bashkisë Dropull sipas njësive administrative pasqyrohen si më poshtë:

Njësi Administrative	Sipërfaqja në ha		Boniteti
	Të ndara	Të pandara	
Dropull i Poshtëm	3366	71	-
Dropull i Sipërm	2591	148	-
Pogon	661	161	-
Totali	6618	380	

Burimi: DAMMT/Bashkia Dropull

U konstatua se nga ana e DAUPLK¹⁴ nuk është bërë klasifikimi i tokës bujqësore sipas bonitetit, në moszbatim të ligjit nr. 9244 datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” i ndryshuar; VKM nr. 121 datë 17.02.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna/Bashki” i ndryshuar pika IV, si dhe paketës ligjore mbi administrimin e tokës bujqësore.

▪ Tabela e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore në Bashkinë Dropull për vitin 2023

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Administrimit të Ujrave, Pyjeve, Livadheve dhe Kullotave [DAUPLK], rezultoi se kjo drejtori ka dërguar çdo vit Këshillit të Qarkut Gjyrokastër, Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, informacionin mbi treguesit kadastral të përditësuar për ndryshimet në nivel vendor të fondit pyjor e kullor.

Fondi Pyjor e Kullor

Njësi Administrative	Sipërfaqja në ha			
	Kullota	Pyje	Inproduktive	Shkëmbore e ujore
Dropull i Poshtëm	4962.1	1071.22	-	21.46
Dropull i Sipërm	3673.2	3365.03	28.1	-
Pogon	6276.69	6204.76	-	8.57
Totali	14911.99 ha	10641.01	28.1	30.03

Burimi: DAUPLK/Bashkia Dropull

▪ Nga auditimi rezultoi se Bashkia Dropull ka dhënë toka bujqësore, sipërfaqe pyjore dhe kullimore me qira, si më poshtë:

Nr	Subjekti	Kontrata/tokë bujqësore	Data	Afati ne vite	Siperfaq ne ha	vlera e kontrates ne leke	Debitor vetëm viti 2023	Debitor progresiv 31.12.2023
1	J.L.	kultivim peme frutore	4/22/2011	99 vjet	3.5 ha	21,000.00	0	0
2	F.L.	kultivim peme frutore	4/22/2011	99 vjet	1.8 ha	11,400.00	0	0
3	2B+K shpk Bularat	kultivim peme frutore	3/11/2013	35 vjet	0.7 ha	4,453.00	0	0
4	B. S. shpk Krioner	kultivim peme frutore	3/13/2013	35 vjet	1.49 ha	9,300.00	0	0
5	Th.Q.	kultivim peme frutore	3/30/2017	35 vjet	1.65 ha	14,893.00	0	0
6	Dh.Gj.	kultivim patate	5/18/2022	10 vjet	0.17 ha	1,149.00	0	0
7	Dh.Gj.	kultivim geshtenja	11/23/2022	99 vjet	5.9 ha	42,645.00	0	0
7	TOTALI				15.21	104,840.00	0	0

Burimi: DAUPLK/Bashkia Dropull

¹⁴ Drejtoria e e Administrimit të Ujrave, Pyjeve, Livadheve dhe Kullotave

Nga auditimi rezulton se janë lidhur 7 kontrata për marrje me qira të tokës bujqësore dhe se nuk ka detyrime të pa arkëtuara.

Numri i subjekteve	Emërtimi i kontratës/kullota	Sipërfaqja në ha	Vlera në lekë	statusi
33	Kontrata pranverore	6,178.41	1,909,844	arkëtuar
39	Kontrata dimërore	4,037.4	1,006,410	arkëtuar
72	Totali	10115.81	2,916,254	√

Punoi: Grupi I auditimit

Nga auditimi rezulton se janë lidhur në total 72 kontrata për marrje me qira të kullotave dhe se nuk ka detyrime të paarkëtuara. Nga analiza e informacionit dokumentar dhe ai në tabelë rezulton se arkëtimi është realizuar pa u lidhur kontrata, me qëllim garantimin e vjeljes së detyrimit, por edhe parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura nga qiradhënia.

➤ Detyrimet e familjarëve

- Njoftimet e bëra për familjarët, masat e marra dhe masat shtrënguese

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave dhe Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifave vendore për abonentët familjarë. Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë, në lidhje me taksat dhe tarifave vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj, por edhe në standat e bashkisë apo Njësitë Administrative. Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë në rrugë zyrtare me anë të shërbimit postar, por edhe dorazi nëpërmjet punonjësit e saj me qëllim njoftimin e taksapaguesve për të paguar në kohë detyrimin. Për vjeljen e detyrimeve të familjarëve (taksa e ndërtesës, ndriçim, gjelbërim, pastrim) Bashkia Dropull nuk ka lidhur marrëveshje me UK sha për të luajtur rolin e agjentit tatimor.

Por drejtoria e të ardhurave vendore DAV në bashkëpunim me zyrën e “Posta shqiptare” sha filiali Gjirokastrë bën të mundur vjeljen e detyrimeve nga abonentët familjarë.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, në çdo rast kërkohet vërtetimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga komuniteti. Në Aneksin nr. 1 dhe 2, pika 2.6, “Përmbledhëse e familjarëve debitorë të vitit 2023”, “Përmbledhëse e familjarëve debitorë për vitin 2023 në numër Progressive sipas llojit të taksave”, bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.

Më poshtë janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e biznesit dhe familjare për taksat dhe tarifave vendore si vijon:

Përshkrimi	Nr.	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2022	Nr.	Borxhi i Krijuar gjatë vitit 2023	Nr	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2023
Debitorë biznes i madh	7	855,887	3	310,394	7	989,420
Debitorë biznes i vogël	3	45,183	5	61,488	7	95,356
Nëntotali I	10	901,070	8	371,882	14	1,084,786
Debitorë taksa e ndërtesës familje	1104	1,842,779	577	586,142	947	1,547,601
Debitorët taksat familje (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim)		2,409,132		935,153		2,144,517
Debitorët taksa e tokës bujqësore		6,619,233		1,059,766		3,131,732

Debitorët taksa e ndikimit në infrast.						
Debitorët nga qiratë	0		0		0	
Nëntotali II	1104	10,871,144	577	2,581,061	947	6,823,850
Total Borxhi tatimor	1114	11,772,214	585	2,952,943	961	7,908,626

Burimi: Bashkia Dropull/DTT

Konstatim: Nga të dhënat pasqyruar në tabelë **rezulton** se ka një rënie të numrit të debitorëve familjarë:

- [taksa e ndërtesës+taksa e tokës bujqësore +taksa familjare] nga 1104 në total në mbyllje të vitit 2022 me vlerën totale progresive prej 10,871,144 lekë, në 947 debitorë me një vlerë totale prej 6,823,850 lekë; diferenca nga viti 2022 në vitin 2023 prej 4,047,294 lekë më pak; duhet theksuar fakti që vlera e detyrimit ka ardhur në rënie për çdo kategori të taksës familjare: Debitor Taksa e ndërtesës nga 1,842,779 lekë në mbyllje të vitit 2022, në 1,547,601 lekë në mbyllje të vitit 2023 pra me një vlerë në rënie prej 295,178 lekë; Debitor Taksa familjare nga 2,409,132 lekë në mbyllje të vitit 2022, në 2,144,517 lekë në mbyllje të vitit 2023 me një vlerë në rënie prej 264,615 lekë; Debitor taksa e tokës bujqësore nga 6,619,233 lekë në mbyllje të vitit 2022 në 3,131,732 lekë në mbyllje të vitit 2023, me një vlerë në rënie prej 3,487,501 lekë; Vlera prej 6,823,850 lekë konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë.

- Për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe për qiratë, ndaj bashkisë Dropull *nuk ka debitorë*.

Konstatohet se numri i debitorëve nga biznesi i madh dhe ai i vogël kanë ardhur me rritje nga 10 debitorë në total në mbyllje të vitit 2022 me vlerën progresive të debisë prej 901,070 lekë, në 14 debitorë në mbyllje të vitit 2023 me vlerë progresive të debisë prej 1,084,785 lekë.

Vlera prej 7,908,626 lekë konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Dropull, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjarë deri në datën 31.12.2023. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar.

➤ **Taksa e tokës bujqësore:**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore për vitin 2023 është prej 7,800 mijë lekë dhe është arritur të vilen 7,758 mijë lekë ose 99% e saj;

Emërtimi	Plan 2022	Fakt 2022	%	Plan 2023	Fakt 2023	%
Taksa e tokës bujqësore	7,800	7,889	101	7,800	7,758	99

➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

- Situata mbi numrin e bizneseve të vogla e të mëdha, regjistruar për herë të parë, çregjistruar apo pezulluar (për bizneset me aktivitet sezonal) për vitin 2022 në Bashkinë Dropull, është si mëposhtë:

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi vogël	2023	143	2	3	142
2	Biznesi i madh	2023	82	3	2	83
(1+2)	Gjithsej	2023	225	5	5	225

Burimi: Bashkia Dropull

- Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelë, **rezulton** se Bashkia Dropull e ka mbyllur vitin 2022 me **225** biznese aktive në total, prej të cilëve 143 janë biznes i vogël dhe 82 janë biznes i madh; janë në total **5** regjistrime të reja nga të cilat 2 janë regjistrim për herë të parë si biznes i vogël dhe 3 si biznes i madh.

- Kanë mbyllur aktivitetin gjithsej **5** biznese prej të cilëve 3 janë biznes i vogël dhe 2 janë biznes i madh.

- Bashkia Dropull në fund të vitit 2023 ka të regjistruar në total **225** biznese sa edhe në mbyllje të vitit 2022, prej të cilëve 142 janë biznes i vogël dhe 83 janë biznes i madh.

Pra rezulton me të njëjtin numër biznesesh prej **225** në total, prej të cilëve 142 janë biznes i vogël dhe 83 janë biznes i madh.

- Subjekte fizike të pezulluara gjatë vitit 2023 në Bashkinë Dropull janë si më poshtë vijon:

Subjekte të pezulluara para vitit 2023	28
Subjekte të pezulluara gjatë vitit 2023	2
Nëntotali I	30
Subjekte të çrregjistruara gjatë vitit 2023	3
Nëntotali II	3
Totali	33

Burimi: Bashkia Dropull

- Një përmbledhje të debisë së vitit 2023 pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

	KATEGORIA E SUBJEKTIT	Nr. i subjekteve	DEBIA
A	Biznesi i Vogël	7	95,356
B	Biznesi i Madh	7	989,420
C	Kategoria Familjare	947	7,659,685
	TOTALI	961	8,744,461

Burimi: DTT/Bashkia Dropull

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:**

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave dhe Tarifave/Bashkia Dropull në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, rezulton se Taksa e ndikimit në infrastrukturë është aplikuar bazuar në Udhëzimin nr. 3, d atë 28.12.2016. Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për çmimin e kostos së ndërtimit për m² për Bashkinë Dropull. Llogaritja e vlerës është (Sip. Objektivit* 32,105 * 0.5 %). Grupi auditues kërkoi nga Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit regjistrin e plotë të përfituesve nga legalizimet dhe që janë të detyruar të paguajnë taksën e ndikimit në infrastrukturë sipas akteve ligjore. Ky regjistër është përpiluar nga informacioni shkresor që ASHK Drejtoria Vendore Gjirokastër dhe ajo e Përgjithshme në periudha një mujore i kanë dërguar Bashkisë Dropull, listën e qytetarëve/subjekteve, të cilëve iu është miratuar leja e legalizimit. **Rezulton** se nuk kryhet Akt Rakordimi mes Bashkisë Dropull/DTT dhe ASHKDV Gjirokastër, por Bashkia Dropull mjaftohet vetëm me informacionin mujor shkresor që i nis zyrtarisht ASHK-DV Gjirokastër dhe paraqitja në zyrat e Bashkisë e vet qytetarëve të interesuar për të bërë pagesat. Ky informacion duhet të përmbajë të gjithë parametrat mbi të cilët llogaritet taksa e ndikimit në infrastrukturë.

- Të ardhurat nga TNI për vitin 2023 janë si më poshtë:

Leje Legalizime	Sipërfaqe /m ²	Detyrimi	Statusi
10	1395.7	227,595	√
Leje Ndërtimi			
7	2145.02	297,716	√

Nga auditimi dhe nga informacioni i pasqyruar në tabelën përmbledhëse të të ardhurave të Bashkisë Dropull, **rezulton** se në vitin 2023 janë arkëtuar 511 mijë lekë, ku përfshihen të ardhurat nga legalizimet në shumën 227 mijë lekë dhe ato nga lejet e ndërtimit 297 mijë lekë.

Nga informacioni në tabelë rezulton se janë dhënë 7 leje me një vlerë totale të taksës prej 297,726 lekë, të cilat janë vjelë.

Gjithashtu Drejtoria e Shërbimit Urban dhe e Shërbimeve Publike/Bashkia Dropull, ka të plotësuar në regjistrin e vet elektronik të dhënat që përmban Vendimi për lejen e legalizimit: numrin e Zonës kadastrale, numrin e pasurisë, numrin e Vendimit, datën e miratimit, sipërfaqen etj; Kjo sjell dhënien e informacionit të detajuar mbi detyrimin e secilit subjekt për taksën e ndikimit në infrastrukturë, (pasqyruar te tabelat në Projekt Raportin e Auditimit dërguar në Bashkinë Dropull me shkresën nr. 431/2 prot datë 27.05.2024.)

➤ Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifat vendore.

Nga auditimi i të dhënave, rezultoi se detyrimet e papaguara ndër vite (progresive) deri në 31.12.2022 janë 8,772,214 lekë për 1114 debitorë: 1104 debitorë familjarë, 7 debitorë nga BM dhe 3 debitorë nga BV; Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2023 janë bërë pagesa nga 581 debitorë në vlerën e 3,816,530 lekë, ku arkëtimet nga debitorët familjarë zënë 95.1% e totalit të arkëtimeve ose 46.1% e totalit të detyrimeve familjare; për vitin 2023 është krijuar debi e re në vlerën totale prej 2,952,943 lekë: ku 2,581,061 lekë nga taksat e tarifa familjare, 310,394 lekë nga BM dhe 61,488 lekë nga biznesi i vogël. Në fund të vitit 2023 debia progresive është në vlerën 7,908,626 lekë: 6,823,850 lekë nga debitorët familjarë ose 86.3% e vlerës totale; 989,420 lekë nga debitorët e biznesit të madh [BM] ose 12.5% e vlerës totale dhe 95,356 lekë nga debitorët e biznesit të vogël [BV] ose 1.2% e vlerës totale progresive të debisë.

Një informacion i përmbledhur pasqyrohet në tabelën e mëposhme:

Nr	Debitorët	Nr. debitor	Debia 2022	Nr. I pagesave	Vlera e paguar	Gjendje nga 2022	Nr. Debitor 31.12. 2023	Debi e 2023	Vlera e debisë progresive 31.12.2023
		1	2	3	4	5=(2-4)	6	7	8=(5+7)
1	Familjarë	1104	7,871,114	577	3,628,355	4,242,789	947	2,581,061	6,823,850
2	B. Madh	7	855,887	3	176,860	679,026	7	310,394	989,420
3	B.Vogël	3	45,183	1	11,315	33,868	7	61,488	95,356
Totali		1114	8,772,214	581	3,816,530	4,955,683	961	2,952,943	7,908,626

Burimi: DTTV/Bashkia Dropull

Nga analiza e debitorëve, **rezulton** se:

1. Debitorë pa shpresë arkëtimi janë dy (2), në vlerën totale 47.730 lekë;

Debitorë nga 3 deri në 5 vite është një (1), në vlerën 551.480 lekë;

Debitorë nga 2 deri në 3 vite janë dy (2), në vlerën lekë 269.066 lekë;

Debitorë problematikë = 5 (pesë) në shumën progresive 868,276 lekë

Konstatohet se në Bashkinë Dropull nuk janë zhvilluar takime të GMS ku të trajtohen problematikat për (pa)mundësinë e vjeljes së detyrimeve të debitorëve problematikë, dhe si

rrjedhje në mungesë të një analize të mirëfilltë, nuk ka një plan masash konkrete për arkëtimin e tyre.

2. Aplikimi i penaliteteve dhe shkresa për bllokimin e llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë;

3. Njoftimi i subjekteve debitore dhe familjare kryhet me anë të shërbimit postar, por edhe nëpërmjet punonjësve të mbledhjes së taksave në terren verbalisht dhe shkresë-njoftimeve.

Sa me sipër arrihet në konkluzionin se nga struktura tatimore e bashkisë Dropull, për asnjë nga subjektet, që janë debitorë në vite, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar *kallëzim penal*, bazuar në nenin 181, “*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se:

“*Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.*”

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar neni 9 “*Të drejtat dhe përgjegjësitë*” pika 1.3., ku përcaktohet se:

“*1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.*”

Neni 35, “*Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore*”, me ligjin nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “*Për sistemin e taksave vendore*”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

➤ **Taksë parkimi.**

Kjo taksë u vilet poseduesve të automjeteve të ndryshme të cilët parkojnë në vende publike. Struktura përgjegjëse për vjeljen e kësaj takse është DTTV në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e shërbimeve/ transporti bazuar në kontratat që lidh me subjektet apo individët që janë të interesuar për vend parkimi. Sipas VKB nr. 63 datë 24.11.2022 niveli i kësaj tarife është:

Për autobuzët - 10,000 lekë në vit;

Për mikrobuzët - 5,000 lekë në vit;

Për taksit - 5,000 lekë në vit;

Për ATP (3.5T) - 2,000 lekë në vit;

Kamiona (mbi 3.5T) – 3,000 lekë në vit;

Ambulantët - 15,000 lekë në vit.

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën përmbledhëse të të ardhurave, rezulton se për vitin 2022 janë parashikuar 100 mijë lekë dhe janë vjelë 133 mijë lekë; për vitin 2023 janë parashikuar 100 mijë lekë dhe janë vjelë 140 mijë lekë ose 7 mijë lekë më shumë se viti paraardhës.

III. Burimi i krijimit të të ardhurave jotatimore

➤ **Nga gjobat**

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave në Paketën fiskale të miratuar janë parashikuar tarifa gjobash për 13 kategori

të ndryshme kundravajtjesh.

- Kështu duke iu referuar tabelës përmbledhëse të të ardhurave, rezulton se janë parashikuar për vitin 2022 vlera prej 200 mijë lekë dhe janë realizuar 489 mijë lekë; ndërsa për vitin 2023 janë parashikuar 500 mijë lekë dhe realizuar 461 mijë lekë. Rezulton se vlera e gjobës përfshin vetëm vlerën e gjobave të llogarituara nga Drejtoria e të ardhurave për mospagesë në afat të taksa e tarifave vendore. Nga viti 2022 është trashëguar vlera progresive prej 1,353,985 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 kjo vlerë ka pësuar rënie në 835,835 lekë ose me 518,150 lekë më pak.

- Gjoha nga Policia bashkiake dhe nga IMTV për vitin 2023 **nuk ka**.

➤ **Shlyerja e detyrimeve të prapambetura/ me këste**

Nga DTT /Bashkia Dropull për shlyerjen e plotë të detyrimeve të prapambetura, është aplikuar edhe lidhja e Akt marrëveshjeve për pagesë me këste nga ana e debitorëve. Situata e detyrimeve për subjektet të cilat kanë lidhur Akt marrëveshje me Bashkinë Dropull gjatë vitit 2023, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

nr	Akt-marrëveshja	Subjekti	Detyrimi total	Shuma e paguar	Afati I likuidimit	Statusi
1	Nr. 203/1 Prot, date 02.05.2023	A.	200,000	200,000	06.05.2023-06.05.2024	√

Burimi: DAV/Bashkia Dropull

➤ **Nga Qira Trualli/të tjera**

Nga auditimi i dokumentacionit shkresor dhe statistikor (tabelar) rezultoi se **nuk ka** truall të dhënë me qira.

➤ **Nga Qira Ndërtese**

Nga të dhënat pasqyruar në tabelën përmbledhëse të të ardhurave, rezulton se për vitin 2022 janë parashikuar 50 mijë lekë të ardhura nga qiratë dhe janë realizuar 657 mijë lekë; gjatë vitit 2023 janë parashikuar 126 mijë lekë të ardhura dhe janë realizuar 171 mijë lekë.

Lista e Objekteve të dhëna me Qira

Nr	Subjekti	vendndodhja	Sipërfaqe m2	Vlera sipas kontratës
1	O.S.	Dervician	34.5	33,534
2	F.N.	Selo	81	78,732
3	V.V.	Goranxi	60	58,320
3			175.5	170,586

Burimi: DAV/Bashkia Dropull

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore [DAV], dhe nga verifikimi i regjistrit në QKB, rezulton se në Bashkinë Dropull gjatë periudhës objekt auditimi, kanë ushtruar aktivitetin e tregëtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë ndër vite 7 subjekte. Nga auditimi *rezulton se* nga inspektimet e kryera në terren, subjektet që tregtojnë hidrokarbure në terren e ushtrojnë normalisht aktivitetin dhe se rezultojnë *aktiv* në QKB.

Nr	Emri I Subjektit	NIPT	Vendndodhja	Fillimi (data)	Mbarimi (data)	Niveli I tarifës sipas VKM nr.344	Pagesa deri ne vitin 31.12.22	Pagese gjate vitit 2023	Detyrime per tu paguar per autorizimin
1	B.P. shpk	K.	Kakavi	27,10,22	27.10.23	200,000	270,000	200,000	0
2	A. shpk	L.	Vrisera	01.11.23	01.11.24	200,000		200,000	0
3	A.&CO	L.	Dervician	11.12.19	11.12.24	1,000,000		0	0
4	A- TU shpk	J.	Sofratike	07,09,20	07.09.23	600,000	288,000	312,000	0
5	K.Shpk	K.	Gorice	02.09.20	02.09.25	1,000,000		0	0
6	A.A. shpk	K.	Haskove	06.05.23	06,05,24	200,000	200,000	170,905	eshte shlyer pjesa qe i takon 2023
7	B.M. shpk	L.	Sofratike	27,04,20	27.04.23	600,000	216,000	384,000	0

Burimi: BashkiaDropull

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se nga Bashkia Dropull gjatë vitit ushtrimor 2023 kanë ushtruar aktivitetin 7 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, *rezulton se vetëm 2 subjekte janë pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 dhe kanë paguar rregullisht detyrimet, 2 subjekte në vlerën e 1,000,000 lekë secila dhe 2,000,000 lekë në total; 2 subjekte janë pajisur me autorizim 3 vjeçar dhe kanë paguar detyrimin në vlerën 1,200,000 lekë; dhe 3 subjekte janë pajisur me autorizim 1 vjeçar dhe kanë paguar detyrimin në vlerën totale prej 600,000 lekë. Pra deri në 31.12.2023 për subjektet që tregtojnë hidrokarbure, nuk ka detyrime të papaguara.*

IV. Përjashtimet nga Taksat dhe Tarifat/Kategoritë sociale përfituese

➤ Taksa mbi Ndërtesën

Referuar VKB nr. 63 datë 21.12.2022 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Dropull 2023”, janë miratuar 10 kategori që përfitojnë lehtësira dhe përjashtime nga taksa mbi ndërtesën. Struktura përgjegjëse është Drejtoria e të Ardhurave Vendore Dropull [DAV].

➤ Taksa mbi Tokën bujqësore

Referuar VKB nr. 98 datë 24.12.2021, përfitojnë lehtësira dhe përjashtohen nga taksa mbi tokën bujqësore ata posedues toke për 5 vitet e para nga çasti i mbjelljes së tokës me vreshtari dhe dru frutorë. Struktura përgjegjëse është DTT Vendore Dropull. Nga kjo Drejtori na u konfirmua se *nuk ka asnjë përfitues* për taksën e tokës bujqësore.

- Një përmbledhje e përfituesve dhe e vlerës së papaguar, si efekt i paketës fiskale të miratuar për vitin 2023, pasqyrohet si më poshtë:

Nr.	Përfituesit	TAKSA				TARIFA		Shuma vjetore	
		nr. familje	Toka		Ndërtesa		Truall		Tarifa
			m2	vlera	m2	vlera			
1	Familje/pensionist i vetëm	23	-	-	2248	20,457	-	-	20,457
2	Familje nën minimum jetik + ndihmë ekonomike	59	558,637	70,409	6174	56,183	1,581	76,500	204,673
TOTALI		82		70,409		76,640	1581	76,500	225,130

Burimi: DAV/Bashkia Dropull

Nga sa më sipër *rezulton* se DTTV/Bashkia Dropull ka një informacion të plotë për përfituesit, duke dhënë vlerën e tarifës së plotë që duhet të paguanin këta përfitues në rast se nuk do të klasifikoheshin në kategoritë përfituese të mospagesës/lehtësira të taksës së tokës dhe ndërtesës, tarifa e truallit dhe ato familjare.

E gjitha kjo për të analizuar efektin financiar që ka në buxhetin e bashkisë nga njëra anë dhe atë social për komunitetin nga ana tjetër.

➤ **Komisioni i Apelit Administrativ [KAA]**

- Me shkresën nr. 508/2 prot., datë 23.03.2021 drejtuar Këshillit Bashkiak nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore/Bashkia Dropull, është kërkuar të shqyrtohet materiali shoqërues dhe të miratohet Komisioni i Apelit Administrativ [KAA] për taksat dhe tarifat vendore. Me Vendimin nr. 15 datë 31.03.2021 dhe nr. 581/3 prot., datë 31.03.2021 është miratuar nga KB kjo kërkesë.

- Me Urdhrin nr. 47/1 datë 20.04.2021 dhe nr. 697 prot., datë 20.04.2021 të Kryetarit të bashkisë është ngritur KAA me pesë anëtarë;

- Me Urdhrin nr. 47/2 datë 20.04.2021 dhe nr. 697/1 prot., datë 20.04.2021, është caktuar sekretare e KAA.

Nr	Anëtarët e komisionit	Pozicioni në KAA	Pozicioni në strukturë
1	P.Dh.	kryetar	Zv/Kryetar
2	E.M.	anëtar	Jurist
3	L.Xh.	-//-	DAV
4	Th.P.	-//-	DMF
5	A.T.	-//-	DPZHT
	J.M.	sekretare	Specialiste DAV

Burimi: DAV/Bashkia Dropull

Nga auditimi rezultoi se KAA deri më 31.12.2023 nuk ka patur asnjë rast për tu trajtuar, lidhur me pretendime të taksapaguesve familjarë apo biznesi të Bashkisë Dropull.

Konkluzion:

Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultuan të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Dropull për periudhën deri në 31.12.2023 në vlerën totale (progresive) **7,908,626 lekë**.

1. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave të familjarëve për vitin 2023 në vlerën **2,581,061 lekë** dhe në vlerën progresive **6,823,850 lekë**.

2. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit të vogël për vitin 2023 në vlerën **61,488 lekë** dhe vlera progresive **95,356 lekë**.

3. Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit të madh për vitin 2023 është **310,394 lekë** dhe në vlerën progresive **989,420 lekë**.

- *Struktura dhe programi IT për administrimin dhe mbledhjen e taksave e tarifave Vendore.*

1. Nga auditimi rezultoi se Drejtoria e të AV Bashkia Dropull informacionin tatimor e përpunon në paketën Microsoft Office 2013 - programi *excel*. U konstatua se mungesa e një sistemi IT bashkëkohor vetëm për të ardhurat vendore, sjellë vështirësi në administrimin e informacionit tatimor nga ana e DAV, për të gjitha subjektet tatimpaguese të biznesit të vogël edhe të biznesit të madh, klasifikimi sipas kategorisë së detyrimit, interesat, rregjistrimin e gjobave dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit etj.

II Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

2. Për Taksa e kalimit e të drejtës në pronësi referuar paketës fiskale, rezulton se për dy vitet e njëpasnjëshme 2022 e 2023 nuk është parashikuar vlerë, për shkak të mungesës së bashkëpunimit me ASHK Rajonale Gjirokastrë. Drejtoria e të Ardhurave Vendore *nuk ka bërë* rakordimet me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Gjirokastrë (ASHKT), por rakordimet i bën nëpërmjet Degës së Thesarit Gjirokastrë;

III Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta

3. Nga auditimi u konstatua se në Rregulloren e brendshme të institucionit të miratuar, nuk është caktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me agjentët tatimorë, si dhe krijimin e një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët.

4. Për Taksa vjetore e mjeteve të përdorura, mblidhet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor/DRSHTRR Gjirokastrë”, për llogari të Bashkisë Dropull. Në zbatim të ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar dhe në mbështetje të gërmës “b”, të pikës 2, në nenin 25 “Të ardhurat nga taksat e ndara” të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njëjësive përkatëse i kalojnë 25% e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura.

5. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mblidhet nga Agjenti Tatimor “Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) tani ASHK Vendore Gjirokastrë”. Deri tani ASHK Vendore Gjirokastrë nuk ka patur bashkëpunim me Bashkinë Dropull. Ndonëse nga ana e Bashkisë Dropull kanë vijuar kërkesat nga shtatori i vitit 2023 e deri më 31.12.2023, nuk është arritur asnjë bashkëpunim mes tyre. Për dërgim informacioni mbi numrin e kalimeve të pronësisë, vlerën totale të tyre me qëllim rakordimit e vlerës së derdhur nëpërmjet Degës së Thesarit Gjirokastrë me vlerën e përllogaritur. Me kërkesën drejtuar ASHK Drejtoria Qendrore, konfirmohet fillimi i bashkëpunimit midis dy institucioneve, me raportimin listës emërore të procedurave të kalimit të pronësisë së objekteve të paluajtshme. Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme tani ASHK Rajonale, janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë si komision 3% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë jo me vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria. U konstatua se deri në 31.12.2023 rakordimet me ASHK Vendore Gjirokastrë, për taksën e kalimit të të drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, *nuk janë kryer*.

6. Bashkia Dropull vjelë rentën minerare, për gjashtë subjekte të regjistruar për aktivitete shfrytëzimi të vendburimeve me minerale brenda territorit të Bashkisë Dropull. Kjo realizohet nëpërmjet akt rakordimeve mujore me Drejtorinë e Doganave dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë. Kjo verifikuar edhe nga Regjistri i lejeve minerare aktive të AKBN-së (Agjencia Kombëtare e Burimeve Nayrore).

IV Detyrimet e familjarëve

7. Nga auditimi dhe informacioni në tabelën e detyrimeve u konstatua se ka një rënie të numrit të debitorëve familjarë dhe të vlerës së detyrimit:

- [taksa e ndërtesës+taksa e tokës bujqësore +taksa familjare] nga 1104 në total në mbyllje të vitit 2022 me vlerën totale progresive prej 10,871,144 lekë, në 947 debitorë me një vlerë totale prej 6,823,850 lekë; diferenca nga viti 2022 në vitin 2023 prej 4,047,294 lekë më pak; duhet theksuar

fakti që vlera e detyrimit ka ardhur në rënie për çdo kategori të taksës familjare: Debitor Taksa e ndërtesës nga 1,842,779 lekë në mbyllje të vitit 2022, në 1,547,601 lekë në mbyllje të vitit 2023 pra me një vlerë në rënie prej 295,178 lekë; Debitor Taksa familjare nga 2,409,132 lekë në mbyllje të vitit 2022, në 2,144,517 lekë në mbyllje të vitit 2023 me një vlerë në rënie prej 264,615 lekë; Debitor taksa e tokës bujqësore nga 6,619,233 lekë në mbyllje të vitit 2022 në 3,131,732 lekë në mbyllje të vitit 2023, me një vlerë në rënie prej 3,487,501 lekë; Vlera prej 6,823,850 lekë *konsiderohet e ardhur e munguar* për buxhetin e bashkisë.

- Nga ana e Drejtoria e Administrimit të Ujrave, Pyjeve, Livadheve dhe Kullotave [DAUPLK] nuk është bërë klasifikimi i tokës bujqësore sipas bonitetit, duke vjelë nga familjet që disponojnë tokë bujqësore me një vlerë joreale të taksës së tokës bujqësore referuar kjo klasifikimit në “Paketën fiskale” vjetore të miratuar nga Këshilli Bashkiak Dropull, në moszbatim të ligjit nr. 9244 datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” i ndryshuar; VKM nr. 121 datë 17.02.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna/Bashki” i ndryshuar pika IV, si dhe paketës ligjore mbi administrimin e tokës bujqësore.

V Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave, debitorët

8. Nga analiza e debitorëve, *rezulton se:*

Debitorë pa shpresë arkëtimi janë dy (2), në vlerën totale 47.730 lekë;

Debitorë nga 3 deri në 5 vite është një (1), në vlerën 551.480 lekë;

Debitorë nga 2 deri në 3 vite janë dy (2), në vlerën lekë 269.066 lekë.

Debitorë problematikë = 5 (pesë) në shumën progresive 868,276 lekë

Konstatohet se në Bashkinë Dropull nuk janë zhvilluar takime të GMS ku të trajtohen problematikat për (pa)mundësinë e vjeljes së detyrimeve të debitorëve problematikë, dhe si rrjedhojë në mungesë të një analize të mirëfilltë, nuk ka një plan masash konkrete për arkëtimin e tyre.

9. Nga auditimi rezulton se Bashkia Dropull për vitin 2023 ka patur të njëjtin numër biznesesh prej **225** në total, prej të cilëve 142 janë biznes i vogël dhe 83 janë biznes i madh; janë regjistruar përgjithmonë 3 biznese; Megjithatë u konstatua se numri i debitorëve nga biznesi i madh dhe ai i vogël kanë ardhur me rritje nga 10 debitorë në total në mbyllje të vitit 2022 me vlerën progresive të debisë prej 901,070 lekë, në 14 debitorë në mbyllje të vitit 2023 me vlerë progresive të debisë prej 1,084,776 lekë. Vlera prej 1,084,776 lekë *konsiderohet e ardhur e munguar* për buxhetin e bashkisë.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të Bashkisë”; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 42, “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, “Raportimi financiar” nënpika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat

Kombëtare” Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve; Me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,,,”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 2/1; nenin 35 të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4. E VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar si dhe kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9 dhe 15 të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar; të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;

Për veprimet e mosveprimet e mësiëprme mbajnë përgjegjësi:

1. Dh.T., me detyrë Kryetar i Bashkisë
2. L.Xh., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore
3. J.M., Përgjegjëse e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore
4. M.M., me detyrë Specialist Tatim taksa
5. L.Q., me detyrë Specialist Tatim taksa
6. Ll.N., me detyrë Drejtori i DAUPLK
7. A.T., me detyrë Drejtor i DSHUSHP.

2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.3.3. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe magazinës.

2.3.4. Verifikimi i inventarëve të Aktiveve Afatgjata Materiale sa prej tyre janë me çertifikatë pronësie.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

-Pasqyrat Financiare për periudhën ushtrimore raportuese (janar-dhjetor 2023).

-Ditarët e kontabilitetit për periudhaën raportuese ushtrimore viti 2023.

-Listë pagesat me përzgjedhje të periudhës raportuese ushtrimore e vitit 2023.

-Dokumentet e bankës dhe të arkës për periudhën raportuese ushtrimore të vitit 2023.

-Akrakordimet e kryera me degën e thesarit Gjirokaster për periudhën raportuese të vitit 2023.

-Dokumentet e inventarizimit fizik të AAGJM, etj, për periudhën raportuese ushtrimore viti 2023.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

I-Përshkrimi i situatës.

Auditimi u krye sipas programit të auditimit pika 3. Vlerësimi Raportimit Financiar dhe për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për periudhën raportuese ushtrimore viti 2023 japin paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë të analizuara me nënpikat sa më poshtë:

- Nënpika 3.1.** Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;
- Nënpika 3.2.** Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.
- Nënpika 3.3.** Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe magazinës.

-Nënpika 3.1 Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

Në procesin e auditimit mbi plotësinë dhe saktësinë e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike të ndodhura për gjatë periudhës raportuese ushtrimore (01.01.2023 deri 31.12.2023) në Bashkinë Dropull u konstatua se: Pasqyra e pozicionit financiar, Njësia Publike Bashkia Dropull periudha 2023 (*Formati nr.1*) është depozituar në Degën e Thesarit Gjirokastrë me shkresë nr.415 prot, datë 20.03.2024 e konfirmuar nga dega e thesarit duke respektuar afatin ligjor i përcaktuar deri në datën 31 mars të vitit pasardhës, veprim në përputhje me UMFE nr.08, datë 09.03.2019 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme*”.

Mbajtja e kontabilitetit për vitin 2023.

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

Është plotësuar bilanci për periudhën raportuese ushtrimore viti 2023 me pasqyrat financiare dhe anekse të tyre e konkretisht me përbërjen si vijon:

- Formati 1- Pasqyra e pozicionit financiar (bilanci);
- Formati 2- Pasqyra e performancës financiare (klasifikimi sipas natyrës ekonomike), pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Formati 3- Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floë), sipas metodës direkte;
- Formati 4- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Formati 5- Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;
- Formati 6- Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
- Formati 7- Pasqyrat anekse statistikore, Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, nga të cilat;
- Format 7/a-Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me kosto historike.
- Format 7/b-Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlera neto.
- Format 8- Pasqyra anekse statistikore e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2023, të pozicionit financiar për Njësia Publike Bashkia Dropull;

Të dhënat kontabël të Njesisë Dropull mbahen në format eksel, për përpunimin dhe administrimin e informacionit kontabël.

Situata: Nga auditimi mbi verifikimin e marrjes së dokumentacioneve financiarë dhe regjistrimet kontabël të kryera nga Bashkia Dropull si dhe në Njësitë vartëse, rezulton se; Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në Bashkia Dropull, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program Excel dhe jo me “*Bartës Informatik*”, të cilët janë programe informatike të pamanipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera nuk paraqesin besueshmëri duke bartur risk në vetvete pasi janë të ndryshueshme në çdo kohë, gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve

kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos kuadrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, besueshmërinë e të dhënave, cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare.

Formati nr.1, paraqitet në *Aneksin nr. xx, pika 3, "Formati nr. 1, Aktivët dhe Pasivët" për vitin 2023, Bashkia Dropull, bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.*

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2023, të pozicionit financiar Bashkia Dropull; Formatin nr.1, paraqitet në të dhënat e mëposhtme:

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si në vijim:

Aktivët neto janë të barabarta me Aktivët-Pasivët =	1,801,935,737 lekë.
Aktivët	1,888,622,737 lekë.
Pasivët	86,687,000 lekë.
Aktivët neto	1,801,935,737 lekë.

Aktivët afatshkurtra

Aktivët afatshkurtra më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **132,098,157 lekë** dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekujvalentët e tyre" në shumën 88,126,069 lekë;

Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues" në shumën 12,576,723 lekë;

Llogaritë e Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" në shumën 26,915,305 lekë.

Llogaritë e Klasës 4 "Të tjera aktive afat shkurtra" në shumën 4,480,060 lekë.

Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekujvalentët e tyre" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
512	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	88,126,069	56,492,949	31,633,120
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akredeitiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizjone zhvlerësimi	0	0	0
Totali		88,126,069	56,492,949	31,633,120

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull.

Vlera e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" në shumën 88,126,069 lekë, përbëhet nga: fondi i trashëguar nga transferta e pakushtëzuar, sektoriale dhe të ardhurat e veta, gjendja e llogarisë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 32,834,434 lekë, gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 55,291,635 lekë.

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2022-2023
31	Materiale	0	0	0

32	Inventar i imet	12,504,723	16,266,780	3,762,057
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces			
34	Produkte			
35	Mallra	72,000	117,000	45,000
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri			
37	Gjendje te pambritura ose pranë të treteve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Shuma te parashikuara për zhvlerësim te inventarit(-)			
	Totali	12,576,723	16,383,780	3,807,057

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull.

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Dropull në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 12,576,723 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imet” në vlerën 12,504,723lekë dhe llogaria kantabël 35 “mallra” ne vleren 72,000 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën +3,807,057 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën +3,807,057 lekë.

Llogaria 32 “Objekte inventari”, ka vlerën 12,504,723 lekë. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	16,266,780
Hyrje gjatë vitit 2022	22,077,780
Dalje gjatë vitit 2022	25,839,151
Gjendja në 31.12.2023	12,504,723

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Inventari i vitit 2023

Nga auditimi u konstatua se titullari i Bashkisë Dropull ka nxjerrë Urdhërin e inventarizimit 189, datë 18.12.2023, ku janë përcaktuar 1 (një) grupe me nga 3 (tre) anëtarë për inventarizimin dhe vlerësimin e materialeve dhe aktiveve të trupëzuara për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.

Komisioni perbehet nga:

1-P. F.

2-J. N.

3-E. L.

Me përfundimin e procesit të inventarizimit nga komisionet, janë hartuar përmbledhëset e inventareve, për llogarinë 218 “Invetarin ekonomik”, në vlerën 21,695,445 lekë, në llogarinë 32 “Inventarë i imët” në vlerën 12,504,723 lekë dhe llogarinë 35 “Mallra” në vlerën 72,000,000 lekë. Gjatë auditimit të kësaj procedure është konstatuar se: Nga grupet e Inventarizimit të aktiveve për vitin 2023, është kryer proceduara sipas kërkesave të UMF 30, datë 27.12.2011 për Menaxhimine Aktiveve në Njësitë Publike. Janë kryer inspektime fizike për të krahasuar gjendjen sipas kartelave kontabël nga anëtarët e e grupeve të inventarizimit është hartuar raport përmbledhës apo relacion për përfundimin e Inventarit i cili i është përciellë Titullarit për tu vënë në dijeni e më tej të miratojë ose jo procesin e inventarizimit.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emertimi i llogarive	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca 2023-2022
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari te ngjashme		0	0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba		0	0
431	Tatime e taksa		0	
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal		0	
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti		0	
435	Sigurime Shoqërore		0	
436	Sigurime Shëndetësore		0	
437,438	Organizma te tjerë shoqërore		0	
44	Institucione te tjera publike		0	
465	Efekte per t'u arkëtuar nga shitja letra me vlere vendosjes		0	
468	Debitorë te ndryshëm	14,071,226	15,142,326	-1,071,100
4342	Te tjera operacione me shtetin(te drejta))	12,844,079	10,272,684	+2,571,395
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit		0	
49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)		0	
	Totali	26,915,305	25,415,010	+1,500,295
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Furnitore(Debitorë),parapagime pagesa pjesore			
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin			
477	Diferenca konvertimi aktive			
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime			
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	4,480,060	192,149,454	-187,669,394
	Totali			

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull.

- Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, paraqitet për vitin 2022 në vlerën 15,142,326,lekë ndërsa në mbyllje të bilancit të vitit 2023 paraqitet në vlerën 14,071,226 lekë, me ulje në vlerën -1,071,100 lekë.

Në mënyrë analitike debitorët paraqiten në pasqyrën më poshtë:

Pasqyra analitike e llog 468, me datë 31.12. 2023.

Nr	Emri Mbiemri	Vlera	paguar 2023	krijuar 2023	Debitorët 2023
1	S. C.	1,146,550	1,146,550		
2	OE-N. Sh.P.K	410,993			410,993
3	A/GJ dhe J. sh.p.k.	61,804			61,804
4	G. M.	116,965			116,965
5	I. P.	100,000			100,000
6	Th.Q.	19,393			19,393
	SHUMA I (1-6)	1,855,705	1,146,550		709,155
7	Th.Q.	128,067			128,067
8	T-d	122,117			122,117
9	Tatimet (sipas listes)biznesi	901,070	188,175	371,882	1,084,777
10	I. D.	300,193			300,193
11	K. B.	219,020			219,020
12	P. Sh.	321,950			321,950
13	J. M.	3,555			3,555
	SHUMA II (7-13)	1,995,972	188,175	371,882	2,179,679

Nr	Emri Mbiemri	Vlera	paguar 2023	krijuar 2023	Debitorët 2023
14	Debitorë nga taksa e tokës bujqësore (III)	7,871,144	3,628,355	2,581,061	6,823,850
	Debitor nga KLSH2019				
15	ED-Konstruksion(Unaza Pogon)	1,854,605			1,854,605
16	A. konstruksion(Zyrat)	617,500			617,500
17	A. konstruksion(Uj.Manx.)	947,400			947,400
	Shuma IV(15-17)	3,419,505			3,419,505
	Debitor nga KLSH 2023				
18	R. T. &Sh. SHPK			185,561	185,561
19	K.K. SHPK			313,500	313,500
20	B. &2-T&V. H. SHPK			179,190	179,190
21	E. & B. SHPK			260,786	260,786
	Shuma V (18-21)			939,037	939,037
	SHUMA I+II+III+IV+V	15,142,326	4,963,080	3,891,980	14,071,226

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull.

Nga Drejtoria e Financës është mbajtur në mënyrë analitike (sipas njësive të varësisë dhe listave emërore) llogaria 468, e cila në fund të vitit 2023 rezulton me një ulje prej -1,071,100 lekë. Nga verifikimi i kryer rezulton që totali i llogarisë analitike në fund të vitit 2023, kuadron me llogarinë sintetike në Aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar dhe me lëvizjet e llogarinë 468 të pasqyruara në Librin e Madh (Centralizatorin 2023).

Nga shuma prej 14,071,226 lekë debitorë në 31.12.2023, shuma prej 6,823,850 lekë, ose 48,5% të debitorëve e zënë debitorët e krijuar nga taksa e tokës bujqësore.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 14,071,226 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 14,071,226 lekë. Vlera prej 17,324,138 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Në mënyrë analitike paraqitet:

Emërtimi i llogarive	Vlera në lekë
Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	3,037,973
Llogaria 467 “Kreditor të ndryshëm”	4,480,060
Paga personeli llog 42	7,901,248
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	472,395
Sigurime shoqërore llog.435	1,272,028
Sigurime shëndetësore llog.436	160,435
Totali	17,324,138
Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2023	199,423,852
Shtesa gjatë vitit 2023(D)	2,571,395
Pakësime gjatë vitit 2023 (K)	-184,671,109
Gjendja në 31.12.2023	17,324,138

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën **4,480,060** lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.20223	192,149,454

Shtesa gjatë vitit 2023	0
Pakësime gjatë vitit	187,669,394
Gjendja në 31.12.2023	4,480,060

Nga auditimi rezultoi se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në vlerën 4,480,060 lekë, kjo në zbatim të Udhëzimit MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” seksioni 3.1.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, (kosto historike)në vlerën 13,670,308 lekë.

II. AKTIVET AFATGJATA

Në formatin nr. 1 “**Aktivet Afatgjata**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 231 “Investime”) në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,146,512,087 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,709,498,783 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,146,512,087 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,709,498,783 lekë që janë të pasqyruara sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”** në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 12,665,888 lekë dhe të vitit 2023 paraqitet në vlerën 13,670,307 lekë. Po kështu dhe sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 12,665,888 lekë dhe të vitit 2023 paraqitet në vlerën 13,670,307 lekë

-**Analiza e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme, Qarkulluese dhe të tjera Aktive, llogaritë; 210, 211, 212, 213, 214, 215, 218, 31, 32, Viti 2023.**

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se, nga 193 objekte inventari të pasurive të paluajtshme me kosto historike që i përkasin llog. 210 “*Toka troje terrene*”, llog. 211 “*Pyje plantacione*”, 212 “*Ndërtesa e konstruksione*” dhe llog. 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, në vlerën 1,389,414,563 lekë, Bashkia Dropull nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 231 “Investime”) në mbyllje të vitit 2022 vlerën 1,146,512,087 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,709,498,783 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,146,512,087 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,709,498,783 lekë që janë të pasqyruara sipas llogarive analitike.

U audituan gjendja analitike kontabël e llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe Qarkulluese për koston historike për llogaritë si vijon:

-Llogaria 210 “*Toka, troje, terrene*” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 198,582 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 198,582 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 dhe vitit 2023 në të njëjtën vlerë prej 198,582 lekë.

Nr	EMERTIMI	Vlera në lekë
	Troje –terene	198.582
	shuma	198.582

Llog 211 “Pyje, Kullota, Plantacione paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë.

Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 dhe vitit 2023 në të njëjtën vlerë prej 0 lekë.

-Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 209,261,703 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 200,324,716 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/A “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 280,903,628 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 384,354,556 lekë me një diferencë në rritje prej 103,450,928 lekë përfaqësojnë shtesat e krijuara me pagesë si rezultat i investimit te kryer për rritjen e AQT në vlerën prej 70,379,339 lekë

Shtesa jashte sistemit ne vleren 8,042,475 lekë dhe 25,029,114 leke jane lëvizjet brënda sistemit. Kjo llogari kosto historike, paraqitet sipas të dhënave të inventarit në *Aneksin nr. 2, pika 3, Llogaria 212, “Ndërtime e konstruksione” për vitin 2023, Bashkia Dropull, bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.*

-Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 914,248,281 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,377,797,448 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/A “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 1,108,312,353 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 1,645,324,154 lekë me një diferencë në rritje prej 537,011,801 lekë përfaqësojnë shtesat e krijuara 537,011,801 lekë si rezultat i investimit te kryer për rritjen e AQT.

Kjo llogari kosto historike, paraqitet sipas të dhënave të inventarit në *Aneksin nr. xx, pika 3, Llogaria 213, “Rrugë, rrjete e vepra ujore” për vitin 2023, Bashkia Dropull, bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.*

Bazuar sa më sipër referuar verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe komunikimeve me përfaqësues të Bashkisë Dropull konstatohet se, nga Nëpunësi i Autorizuar në cilësinë e titullarit të njësisë publike dhe nga Drejtori i Buxhetit dhe Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues nuk janë marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, ndërtesa, pyje e kullota për Bashkia Dropull dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, për të cilat nuk mund të gjykohet nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni çka do të thotë se nuk mund të verifikohet dhe vlerësohet dokumentacioni mbështetës i tyre. E njëjta situatë konstatohet edhe në Njësitë Administrative në varësi të Bashkisë Dropull pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nuk është kryer inventarizim për zërat e mësipërm të bilancit. Referuar procesit të inventarizimit të kryer për

vitin 2023, u konstatua se verifikimi është kryer vetëm për aktivet e llog. 218 “Inventar ekonomik” dhe për llog. 32 “Inventar i imët”. Pra nuk janë ngritur komisione për kryerjen e verifikimeve të aktiveve për llogarinë 210 “Toka, troje, terrene”, për llog 211 “Pyje, kullota, plantacione” të cilat paraqiten në pasqyrat financiare me vlerat sipas tabelës më poshtë:

210	Toka,troje, Terene	198,582
211	Pyje, Kullota, Plantacione	0
212	Ndertime e Konstruksione	384,354,556
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	1,645,324,154
214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	25,081,730
215	Mjete transporti	34,789,763

Bashkia Dropull nuk ka marrë masat e duhura për të reflektuar në pasqyrat financiare në llogarinë përkatëse në total **25,311Ha (hektarë)**, nga të cilat **10,641Ha** të sipërfaqeve të pyjeve, **14,911Ha** të sipërfaqeve të kullotave, **28.1Ha** Tokë joproduktive dhe **30Ha** shkëmbore e ujore, të kaluara në favor të saj sipas VKM Nr. 433 dt 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, 34 shtojca 32, e ndryshuar. Kjo sjell rrjedhimisht mospasymir të saktë dhe të drejtë të llogarisë 211, llog. 213, në mbyllje të Pasqyrave financiare të vitit 2023.

Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 11 dhe nenin 15, me ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 dhe 12, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 74, ku ndër të tjera citohet se;

Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.

Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar pika 2.1.

Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35. Veprime këto të cilat nuk janë në përputhje me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, ku cilësohet:

*“1. Bashkia është subjekti juridik që trashëgon të drejtat e pronësisë, të luajtshme dhe të paluajtshme të Njësive që Shkrihen (NJSH). Nga momenti i konstatimit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive ajo ushtron të drejtën e pronësisë si dhe të drejta të tjera sipas mënyrës të përcaktuar me ligj.
2. NJSH-të duhet të plotësojnë dhe depozitojnë pranë bashkisë inventarin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi. Për pronat e paluajtshme inventari duhet të përmbajë edhe informacionin për fazën e regjistrimit në të cilën ndodhen”.*

-Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri paisje, vegla pune” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 18,878,278 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 21,319,703 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/A “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 21,650,930 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 25,081,730 lekë.

Kjo llogari kosto historike, paraqitet sipas të dhënave të inventarit evidentohen në *Aneksin nr. xx, pika 3, Llogaria 214, “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” për vitin 2023, Bashkia Dropull, bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.*

-Llogaria 215 “Mjete transporti” paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 10,149,752 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 17,746,285 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/A “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 22,756,659 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 34,789,763 lekë ,me nje rritje 12,033,104 lekë.

Inventari i mjeteve të transportit në fund të vitit 2023 evidentohen në *Aneksin nr. 5, pika 3, Llogaria 215, “Mjete Transporti” për vitin 2023, Bashkia Dropull, bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.*

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” në datën 31.12.2021 është në vlerën 3,834,195 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,712,478 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/A “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 19,866,402 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 19,475,855 lekë në rritje për vlerën 641,742 lekë, e cila përfaqëson shtesat e vitit për blerje të ndryshme në vlerën 220,800 lekë dhe shtesat pa pagese 420,942 si dhe pakësime ne vlerën 1,032,289 lekë per nxjerrje jashte perdorimi, të cilat evidentohen në *Aneksin nr. 6, pika 3, “Llogaria 218, Inventari Ekonomik për vitin 2023, Bashkia Dropull” bashkëlidhur Projektraportit të Auditimit.*

Pasqyra statistikore nr. 7.b “Aket afatgjata me vlerë neto”.

Nr. Reference Llogarije	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	14,901,045	2,235,157	12,665,888	9,808,800	3,706,477	5,997,534	899,630	18,712,311	5,042,004	13,670,307
201	0		0					0	0	0
202	14,901,045	2,235,157	12,665,888	9,808,800	3,706,477	5,997,534	899,630	18,712,311	5,042,004	13,670,307
203	0		0					0	0	0
21- 28	1,453,298,007	306,785,921	1,146,512,086	660,667,821	95,285,606	2,521,598	126,080	2,111,444,230	401,945,447	1,709,498,783
210	198,582		198,582					198,582	0	198,582
211	0		0					0	0	0
212	280,903,628	80,578,912	200,324,716	103,450,928	15,188,782			384,354,556	95,767,694	288,586,862
213	1,108,312,353	194,064,072	914,248,281	537,011,801	73,462,634			1,645,324,154	267,526,706	1,377,797,448
214	21,650,930	2,772,653	18,878,277	5,952,398	1,115,454	2,521,598	126,080	25,081,730	3,762,027	21,319,703
215	22,756,659	12,606,907	10,149,752	12,033,104	4,436,571			34,789,763	17,043,478	17,746,285
216	0	0	0					0	0	0
217	0	0	0					0	0	0
218	19,475,855	16,763,377	2,712,478	2,219,590	1,082,165			21,695,445	17,845,542	3,849,903
24	0		0					0	0	0
28	0		0					0	0	0
	1,468,199,052	309,021,078	1,159,177,974	670,476,621	98,992,083	8,519,132	1,025,710	2,130,156,541	406,987,451	1,723,169,090

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimit MFE nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Dropull, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%

- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

Llogaria 230 dhe 231 "Investime" për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2023, paraqiten në vlerën 30,855,489 lekë. Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten në shumën 30,855,489 lekë.

Në mëryra analitike shtesat për aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale paraqiten si më poshtë:

“Investime, llogaria analitike 23 viti 2023”

Nr.	Llogaria 212/Objekti	Vlerë në lekë
I	Blerje me pagesë	70,379,339
II	Shtesë pa pagesë	8,042,475
III	Levizjet brenda sistemit	25,029,114
	SHUMA 212	103,450,928

Nr.	Llogaria 213/Objekti	Vlerë në lekë
	Blerje me pagesë	339,687,044
	Shtesë pa pagesë	32,274,345
	Shtesa Brenda sistemit(Pakesimi nga studimet)	5,997,834
	Levizjet Brenda aktiveve(Kalim nga llogaria 231,inv.ne proces)	159,052,578
	SHUMA 213	537,011,801

Nr.	Llogaria 214/Objekti	Vlerë
	Blerje me pagesë	1,564,800
1	Shtesë pa pagesë	1,866,000
	SHUMA 214	3,430,800

Nr.	Llogaria 215/Objekti	Vlerë
	Blerje me pagesë	9,679,200
1	Shtesë pa pagesë	2,353,904
	SHUMA 215	12,033,104

Nr.	Llogaria 218/Objekti	Vlerë
I	Blerje me pagesë	2,219,590
	SHUMA 218	2,219,590

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Dropull më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2022	Viti 2023	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	1,359,046	3,037,973	-1,678,927
42	Detyrime ndaj personelit	7,189,360	7,901,248	-711,888
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	452,546	472,395	-19,849

435	Sigurime shoqërore	1,142,275	1,286,642	-144,367
436	Sigurime shëndetësore	129,457	145,821	-16,364
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	37,285,045	55,291,635	-18,006,590
467	Kreditorë të ndryshëm	189,151,168	4,480,060	+184,671,108
4341	Të tjera operacione me shtetin (detyrime)	15,142,326	14,071,226	+1,071,100
	Gjendja më fund të periudhës	251,851,223	86,687,000	165,164,223

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull.

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2022 është në vlerën 1,359,046 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Dropull më 31.12.2022. Lëvizja e llogarise 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet në tabelën si me poshtë:

Llog. 401-408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to”	
Celje e vitit 2022	1,359,046
Shtesa (K)	3,037,973
Pakësime (D)	1,359,046
Gjendja në 31.12.2022 (K)	3,037,973

Gjendja e llogarisë 401-408“Furnitorë e llogari të lidhura me to” në shumën 3,037,973 lekë përbëhet nga :

1	energji elektrike	Faturat e muajit Dhjetor 2023	741,047
2	keshilltaret-kryetaret e fshatrave	Pagesa e muajit Dhjetor 2023	547,525
3	% posta shqiptare		87,713
4	ndihma ekonomike	Pagesa e muajit Dhjetor 2023	236,376
5	Uji	Pagesa e muajit Dhjetor 2023	16,000
6	Telefon	Pagesa e muajit Dhjetor 2023	14,500
7	Investime	Fatura Dhjetor 2023	1,394,812
	SHUMA		3,037,973

- **Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”**, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Dropull paraqitet në vlerën 7.901,248 lek dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llog. 42 "Detyrime ndaj personelit"	
Celje e vitit 2023	7,189,360
Shtesa (K)	101,429,677
Pakësime (D)	100,717,789
Gjendja në 31.12.2023(K)	7,901,248

Konkretisht, sipas dokumentave të bankës të muajit Janar 2024, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		Vlera në lekë
Numër	Datë	
4	12.01.2024	5.593,915
5	12.01.2024	340,981
6	12.01.2024	224,096
7	12.01.2024	466,108
8	12.01.2024	38,232
9	12.01.2024	174,153
10	12.01.2024	91,489
1	11.01.2024	1.026.274

	Totali	7,901,248
--	---------------	------------------

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull.

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 472,395 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llog. 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"	
Celje e vitit 2022	452,546
Shtesa (K)	4,975,882
Pakësime (D)	4,956,033
Gjendja në 31.12.2023 (K)	472,395

Konkretisht, sipas dokumentave të bankës të muajit Janar 2024, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		Vlera në lekë
Numër	Datë	
1	11.01.2024	366,420
12	12.01.2024	105,975
	shuma	472,395

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull.

- **Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë perkatsisht në vlerat 1,286,642 lekë dhe 145,821 lekë.

Llog. 435 "Sigurime shoqërore"	
Celje e vitit 2023	1,142,275
Shtesa	16,864,322
Pakësime	16,719,955
Gjendja në 31.12.2023	1,286,642
Llog. 436 "Sigurime shëndetësore"	
Celje e vitit 2023	129,457
Shtesa	1,888,804
Pakësime	1,872,440
Gjendja në 31.12.2023	145,821

Konkretisht, sipas dokumentave të bankës të muajit Janar 2024, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		Vlera në lekë
Numër	Datë	
2	11.01.2024	1,286,642
3	11.01.2024	145,821
	totali	1,432,463

Llogaria 466 “Kreditore për mjete në ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Dropull, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 55,291,635 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Gjirokaster, sipas akt-akordimit datë 20.03.2024.

Llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Celje e vitit 2023	37,285,045

Shtesa	21,598,512
Pakësime	3,591,929
Gjendja në 31.12.2023	55,291,635

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull.

Në mënyrë analitike sipas objekteve dhe vitit që i përket paraqitet në pasqyrën, si më poshtë:

Nr.	Emertimi i objektit	Gjendje 2022	Hyrje 2023	Gjithsej	Pagesat 2023	Gjendja 2023	OPERATORET
1	Ujesjelles Jorgucat	2,000		2,000		2,000	M.
2	Transformator pompa	105,186		105,186		105,186	A-91
3	Ujesjells i Manxifes dhe rikonstruksion i fshatrave Selo Lovine Krioner	11,688,581	7,963,369	19,651,950		19,651,950	B.
4	Furnizim nga pus shpimi Goranxi Dervician	4,639,180		4,639,180		4,639,180	B.
5	Murri i varezave Grapsh	92,583		92,583		92,583	T-D
6	RruGa hyrese Vrisera	955,325		955,325	955,325	-	N.
7	Rikonstruksion I rrugeve te brendshem	405,333		405,333		405,333	SH.
8	Pastrim kanali Pepel	145,752		145,752		145,752	T-d
9	Rehabilitimi i digave te ujembledhesve Kakavi Likomil Peshkopi Bodrishte	1,794,658		1,794,658	1,794,658	-	2Z K.
10	Rik. i rrjet. te brendshme Zervat, vaniste...	5,773,207	6,583,639	12,356,846		12,356,846	R.
11	Rik. i rrjet. te brendshme Dervician Teri	5,165,154	1,976,332	7,141,486		7,141,486	K.
12	Rruga Bodrishte	1,115,706		1,115,706		1,115,706	P.
13	Rruga Bularat(Extrovert Road)	2,730,224		2,730,224		2,730,224	E. K.
14	Rikonstruksion I pjesshem I rrjetit rrugor Pogon	341,640	145,448	487,088	487,088	-	I/D
15	Rikonstruksion shkolla Bularat +kopshti	1,251,456	1,925,315	3,176,771		3,176,771	Gj. SHPK
16	Mbrojtja e rruges me gabion(2022)	219,996	74,628	294,624		294,624	M/S
17	Shkolla Dervician(Sociale projekt)	79,841		79,841	79,841	-	E.
18	Rikonstruksion I rrjetit rrugor Polican-Dhrimadhes		500,000	500,000		500,000	H.
19	Rikoshtuksion I rruges terihat		838,000	838,000		838,000	LTE
20	Mbrojtja eperooit te Selos,faza I		1,257,084	1,257,084		1,257,084	Ec p.
21	Strehim banesash		149,493	149,493		149,493	I
	SHUMA 231	36,505,822	21,413,308	57,919,130	3,316,912	54,602,218	
22	Riparim kanali-rezervuar Pepel	16,424		16,424		16,424	T-d
23	Mirembajtje rruge	69,315		69,315		69,315	SH.
24	Restaurim dhe pastrimi kanalit vadites rezervuari i Pepelit	336,648		336,648		336,648	T-d
25	Mirembajtje rruga Pogon	110,367		110,367	110,367	-	E.
26	Mbajtja ne gadishmeri(Mbrojtja sociale)	119,820	8,880	128,700		128,700	T-d
27	Mbajtja ne gadishmeri(Mbrojtja sociale 2023)		81,324	81,324		81,324	T-d
	SHUMA 602	652,574	90,204	742,778	110,367	632,411	
	SHUMA 231+602	37,158,396	21,503,512	58,661,908	3,427,279	55,234,629	
	Gjendja Civile	126,656	95,000	221,656	164,650	57,006	
	Gjithsej	37,285,052	21,598,512	58,883,564	3,591,929	5,291,635	

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull.

Llogaria 467 "Kreditorë të ndryshëm", paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat për vitin 2023 paraqiten në shumën 4,480,060 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2023 paraqitet si më poshtë:

Llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm"	
Celje e vitit 2022	189,151,168
Shtesa	0
Pakësime	184,671,108
Gjendja në 31.12.2022	4,480,060

Këto vlera janë paraqitur në mënyrë analitike dhe përbëhen nga Fatura të palikujduara sipas pasqyrës si më poshtë:

Gjendja e llogarise 467 (shpenzime 602) me 31.12.2023.

Nr	Emertimi	fatura tatimore numer dhe date	SHUMA
1	Energji elektrike	Akt mareveshje dt.25.08.2022	4,480,060
	SHUMA		4,480,060

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull.

LLogaria 85 "Rezultati i ushtrimit", paraqitet me tepriçë kreditore në vlerën 32,834,434 lekë dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që Bashkia Dropull trashëgon për t'u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me degën e thesarit mbi fondet që trashëgohen.

Llog. 85 "Rezultati i ushtrimit"	
Celje e vitit 2023	19,207,904
Shtesa(te ardhurat)	251,173,450
Pakësime	237,546,920
Gjendja në 31.12.2023	32,834,434

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull.

e Performancës financiare (F2).

Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Dropull më datë 31.12.2023 janë të kuadruara me Degën e Thesarit Gjirokastër, konkretisht:

Rakordimi të ardhurave

Emërtimi	Vlera sipas Pasqyrës së Performancës	Dokumentimi	Vlera	Diferenca
-Të ardhurat e krijuara gjatë vitit	84,389,252	Akt-Rakordimi me Degen e thesarit 20.03.2023	84,389,252	0
-Granti nga buxheti	130,112,651		130,112,651	0
-Financim i pritshëm nga buxheti	14,071,226		14,071,226	0
-Financim i pritshëm nga buxheti	16,705,456		16,705,456	0
-Fonde buxhetore të trashëguara	2,502,449		2,502,449	0
-Fonde buxhetore të trashëguara	3,807,057		3,807,057	0
-Të ardhura të trashëguara (rez)				
-Llog 73 Ndryshi i gjendjes 0me(+)				
Totali të ardhura	250,588,091		250,588,091	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull.

Rakordimi i Shpenzimeve

Emertimi	Sipas Situacionit	Detyrimet e vitit 2022	Detyrime të vitit 2023	Sipas Pasyrës së Performancës
600	103,396,912	7,189,360	96,207,552	103,396,912
601	16,864,322	1,271,732	15,592,590	16,864,322
602	52,351,632	1,811,592	50,540,040	52,351,632
604	4,663,880	0	4,663,880	4,663,880
606	36,669,854	0	36,669,854	36,669,854
63				3,807,057
8423				
8421				
8424				

Totali	213,946,600	10,272,684	203,673,916	217,753,657
---------------	--------------------	-------------------	--------------------	--------------------

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull.

Diferenca në shumën 3,807,057 lekë midis shpenzimeve të paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare dhe Situacionit vjen nga ndryshimi i gjendjes së inventarit .

Në fund të vitit ushtrimor të dy llogaritë e klasës 6 “shpenzimet” dhe klasës 7 “të ardhurat”, janë mbyllur duke debituar dhe kredituar respektivisht llogarinë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore”, konkretisht:

Rakordimi të ardhura, shpenzime dhe rezultati

	Emërtimi Burimi	Pasqyra	Situacioni	Diferenca
I	Totali të ardhura	250,588,091	250,588,091	0
II	Shpenzime	217,753,657	217,753,657	0
III	Rezultati i vitit ushtrimor	32,834,434	32,834,434	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull.

Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati nga veprimtaria" paraqitet në shumën 32,834,434 lekë, e njëjtë me Pasqyrën e Performancës Financiare paraqitet në shumën 32,834,434 lekë.

Pasqyra e flukseve monetare (F3)

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2023. Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor 2022 zë vlerën 56,492,949 lekë, dhe përbëhet nga mjetet në ruajtje në vlerën 37,285,045 lekë plus të ardhurat e trashëguara 19,207,904 lekë.

Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor 2023 zë vlerën 88,126,069 lekë, përbëhet nga mjetet në ruajtje në vlerën 55,291,635 lekë plus të ardhurat e trashëguara në vlerën 32,834,434 lekë.

Nga kontrollet e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2023, e paraqitur në lart rezulton në shumën 88,126,069 lekë dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Mjetet monetare dhe ekujvalentët e tyre" e cila paraqitet në shumën 88,126,069 lekë.

Plotësimi i Pasqyrës së Flukseve monetare është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.6 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetare”.

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4)

Nr.	Referenca	EMERTIMI	Fonde baze dhe Grante Kapitale	Rezerva	Fonde te Tjera te veta	Rezultatet e Mbartura Tepricioe/Deficit	Rezultatet e Ushtrimit Tepricioe/Deficit	GJITHESEJ Aktive/neto Fonde/ Neto	
Reshti	a	b	c	1	2	3	4	5	6
1	101	I.AKTIVET NETO/FONDET NETO	1,325,048,577			460,099,072	-3,807,057	1,781,340,592	
2		II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO(1+2)	62,272,658	0	13,626,530	-19,886,007	-35,418,036	20,595,145	
3		1.NGA BURIME TE BRENDSHME	61,065,415	0	13,626,530	-19,886,007	-35,418,036	19,387,902	
4	105,	Nga grantet e brendshme kapitale(+)						50,534,558	
5	016, 105	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne naty	0				12,013,779	12,013,779	
6	1014, 116	Nga Shitjet e AAGJ(+)	0					0	
7	12	Nga Rezultatet e mbartura(+,-)	39,093,911			-19,886,007		19,207,904	
8	85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)	19,207,904		13,626,530			32,834,434	
9	111	Nga Rezervat (+,-)	0					0	
10	115	Nga Fondet e veta te investimeve (+,-)	2,763,600					2,763,600	
11	15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime(+,-)	0					0	
13	1013	Nga konsumi i AAGJ(-)					-97,966,373	-97,966,373	
14	1015	Nga nxjerrjet jashtepedorimit dhe demtimet(-)	0					0	
15	107	Vlera te AAGJ, te Caktuara ne perdorim(+,-)	0		0			0	
16	109	Diferenca nga Rivleresimi I AAGJ(+,-)	0					0	
17		2.NGA BURIME TE JASHTME	1,207,243	0	0	0	0	1,207,243	
18	106,	Nga grantet e Jashtme kapitale(+)	1,207,243					1,207,243	
19	016, 106	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne naty	0					0	
20		TOTALI I FONDEVE TE VETA(I+II)	1,387,321,235	0	13,626,530	440,213,065	-39,225,093	1,801,935,737	

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull.

Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar", në shumën 1,801,935,737 lekë. Në këtë pasqyrë janë paraqitur saktë grantet bazë (çelja e vitit), rezultati i vitit të mëparshëm si dhe rezultatet e ushtrimit. "Fonde bazë".

Vlera prej -97,966,373 lekë, përfaqëson amortizimin vjetor (shtesa)

Vlera prej 32,834,434 lekë, përfaqëson rezultatit financiar të vitit ushtrimor pasqyruar në llog.85. Nga auditimi rezultoi se fondet neto të pasqyruara në Pasqyrën "Ndryshimi në fondet neto/aktivet neto" në shumën 1,801,935,737 lekë kuadron me pasqyrimin e tyre në pasqyrën e "Pozicionit financiar".

Plotësimi i Pasqyrës së Aktiveve neto/Fonde neto është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.5 "Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto".

Shënimet shpjeguese (Pasqyra F5):

Plotësimi i kësaj pasqyre është bërë në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 8, datë 03.09.2018, pika 3.7 "Rregullat për dhënien e shpjegimeve për pasqyrat financiare individuale". Nga Bashkia Dropull është plotësuar Pyetësori dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasyrave financiare vjetore".

Pasqyrat statistikore.

Pasqyra statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit"

Numër llogarie	Emërtimi	Vlera D	Vlera K	Teperica
	Shpenzimet për investime	280,090,972	436,288,773	33,355,489
230	Shpenzime afatgjata jomateriale			
231	Shpenzime Afatgjate materiale	277,590,972	433,338,773	30,855,489
	Burimet për investime			

Numër llogarie	Emërtimi	Vlera D	Vlera K	Teperica
26	Shpenzime për aktive Afatgjata financiare	2,500,000	2,950,000	2,500,000
1051	Grante kapitale nga nivele të tjera			
1059	Grante të brendshme kapitale në natyrë			
11	Fonde të tjera të veta			
115	Caktim fondi për investime nga rezultati			
	Balanca	280,090,972	436,288,773	33,355,489

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull.

Vlera prej 277,590,972 përfaqëson shpenzimet për investime të cilat janë të rakorduara me Degën e Thesarit Gjirokaster.

Plotësimi i Pasqyrës së Statistikore “Investimet dhe burimi i financimit” është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.8.1 “Rregulla për plotësimin e pasqyrës statistikore të investimeve dhe burimeve të financimit të tyre”.

Pasqyra statistikore nr. 8 “Numri i punonjësve dhe Fondi i pagave”.

Në këtë pasqyrë është dhënë informacion mbi numrin e punonjësve, fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat.

Për periudhën objekt auditimi u morën për verifikim 3 listëpagesa të Bashkisë Dropull e konkretisht listëpagesat për muajt Prill, gusht dhe nëntor 2023, nga ku rezultoi se:

Plotësimi i Pasqyrës së Statistikore “Numri i punonjësve dhe fondin e pagave” është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.8.4 “Rregulla për plotësimin e pasqyrës statistikore mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave”.

-Është mbajtur dhe përditësuar libri i pagave dhe ditari i pagave.

-Nga auditimi i listë-pagesave u konstatua se listë-pagesat hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruara me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga specialisti i pagave, nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues.

-Nga ky sondazh u verifikuan përcaktimi i niveleve të pagave dhe pagesa e tyre, ku rezultoi se: ato ishin në përputhje me nivelet e përcaktuar për shtesat e pozicionit si dhe shtesat e pagës së grupit përputheshin me nivelin e arsimit sipas përcaktimeve të lidhjes nr.5 të VKM të pagave dhe sipas kategorisë 3 së kësaj njësie vendore. Gjithashtu liste pagesat janë të shoqëruara dhe në përputhje me liste prezencat përkatëse.

-Përmbledhëset janë të kuadruara me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe titullari.

-Për të gjithë periudhën e kontrolluar, janë përllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat.

-Janë respektuar dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e punës.

- Auditim mbi administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare dhe letrave me vlerë. Rregullaritetin i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga

punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

- Auditim mbi administrimin e asetëve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Në zbatim të programit të auditimit nr. 431/1 datë 03.04.2024, u kërkua informacion në lidhje me evidentimin e të dhënave mbi pronat që Bashkisë Dropull të cilat i janë transferuar me VKM në periudha të ndryshme ushtrimore nga ku rezultoi se:

Numri i pronave të transferuara me VKM sipas listës përfundimtare të inventarit dhe sa prej tyre janë regjistruar ne ASHK, evidentohen në aneks bashkëlishur RPA.

- Pronat e regjistruara me dokumentacion pronësor në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës të cilat nuk janë të regjistruara në Pasqyrat financiare të Bashkisë Dropull, evidentohen sipas objekteve dhe certifikatës së pronësisë evidentohen në Aneksin nr. 7, pika 3, bashkëlidhur Projektarportit të Auditimit.

Kërkese sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje dhe kullota publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e Bashkive”, i janë kaluar në pronësi sipërfaqe:

Gjithsej 25611.13 ha, nga këto:

- Pyje **10,641,01..... ha,**

- Kullotë **14,911.99..... ha**

- Toka joproduktive **28.1.....ha**

- Shkëmbore dhe ujore **30.03.....ha, konkretisht sipas tabelës më poshtë:**

Lloji	Ha
Pyje	10,641.01
Kullota, livadhe	14,911.99
Tokë inproduktive	28.1
Shkëmbore e Ujore	30.03
Total	25,611.13

Burimi i të dhënave: Bashkia Dropull.

Referuar informacionit të marrë nga Bashkia Dropull rezulton se ka plan mbarështimi të pjesshëm për ekonominë pyjore Pogon, dhe plan mbarështimi për ekonominë kullimore pyjore Goranxi –Grapsh i cili është në procesin e miratimit në Ministri.

Nga verifikimi i të dhënave rezultoi se nga transferimi i sipërfaqeve pyjore e kullimore të transferuara në Bashkinë Dropull, në total nga 25,553 Ha, janë regjistruar në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës vetëm 272,77 Ha.

Nga ana e administratës së Bashkisë është bërë identifikimi fizik por nuk është punuar për regjistrimin e pronave.

Nga pronat në pronësi/përdorim të certifikuar ose jo, për të cilat janë lëshuar me kontratë qiraje verore apo dimërore, të cilat rezultojnë të likuiduara për periudhën objekt auditimi evidentohen në Aneksin nr. 8 dhe 8/1, “Kontratat pranverore dhe dimërore” bashkëlidhur projektarportit të Auditimit.

Për veprimet e mos veprimet në lidhje me mangësitë e konstatuara më sipër, mbi vlerësimin e raportimit financiar për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023 për

paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të Bashkisë, si dhe procesin e verifikimit të inventarit të aktiveve, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi trajtuar më hollësisht në aktkonstatim ngarkohen me përgjegjësi:

1. **Z. Dh.T.**, me detyrë Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e nëpunësit autorizues.

2. **Zj. J.V.**, me detyrë Drejtor i Buxhetit dhe Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues.

2.4 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

2.4.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

2.4.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

2.4.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit në RPA dërguar me shkresën nr. 424/8 prot., datë 31.08.2023, për përmirësimin e gjendjes është kërkuar marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht dhe rekomandimet e pa zbatuara si më poshtë vijon:

a. Masa për përmirësimin e Legjislacionit në fuqi nuk është lënë masë;

b. Masa Organizative janë lënë **22**, dhe janë pranuar **22** masa: 12 masa janë zbatuar, 7 masa janë në proces zbatimi; 3 masa janë pjesërisht zbatuar dhe **0** masa pa zbatuar;

Nga auditimi i mëparshëm janë rikërkuar **3** masa organizative të cilat kanë rezultuar të pranuar nga subjekti; nga të cilat 1 masë është zbatuar; **2** masa janë në proces zbatimi;

Në total Masa organizative janë lënë **25** masa: 13 masa janë zbatuar, 3 masa janë pjesërisht zbatuar; 9 masa janë në proces zbatimi.

c. Masa për shpërblim dëmi janë lënë **4** masa në vlerën 939,037 lekë të cilat janë pranuar: **4** masa po në vlerën 939,037 lekë dhe janë pjesërisht zbatuar;

Nga auditimi i mëparshëm është rikërkuar **1** masë në vlerën totale 3,419,505 lekë dhe pranuar nga subjekti e cila rezulton e zbatuar.

Në total Masa shpërblim dëmi janë lënë **5** masa në vlerën totale 4,358,542 lekë: 1 masë në vlerën 3,419,505 lekë zbatuar dhe 4 masa në vlerën 939,037 lekë janë pjesërisht zbatuar.

d. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, TNI, etj (të ardhura të munguara) në bashkinë Dropull janë lënë **5** masa në vlerën totale 11,002,930 lekë nga të cilat: 4 masa janë zbatuar dhe 1 masë është në proces zbatimi;

Nga auditimi i mëparshëm është lënë 1 masë në vlerën totale 8,772,214 lekë dhe i përkasin 1114 taksapaguesve e cila rezulton në proces;

Në total janë lënë **6** masa: 4 masa janë zbatuar dhe 2 masa janë në proces zbatimi.;

e. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike, është lënë **1** masë nga auditimi i mëparshëm (rikërkuar) e cila është pranuar nga subjekti dhe rezulton e pazbatuar.

f. Masa disiplinore janë lënë për **14** punonjës, e cila rezulton e papranuar nga Kryetari i Bashkisë;

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1. Hartimi i programit (Plan veprimt) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, sic është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

- Bashkia Dropull ka hartuar dhe miratuar nga kryetari i bashkisë Planin e veprimeve “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna në raportin përfundimtar të auditimit” dërguar me shkresën nr. 424/8 prot., datë 31.08.2023, duke plotësuar edhe rubrikën mbi nivelin e zbatimit të tyre. “Plani i veprimt” është dërguar në KLSH me nr. 1348 prot., datë 20.09.2023 dhe rezulton të jetë hartuar, miratuar dhe dërguar në KLSH brenda afatit 20 ditor, gjë që ka ndikuar edhe në angazhimin brenda afatit të strukturave ngarkuar me përgjegjësi, në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit ” Bashkia Dropull **ka kthyer përgjigje** zyrtare në KLSH brenda afatit 20 ditor nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon “Planin e Veprimeve”, duke shprehur qëndrimin e saj për pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.

Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit).

- Bashkia Dropull iu përgjigj kërkesës së grupit të auditimit dërguar në rrugë elektronike për çdo rekomandim të lënë, duke bërë me dije statusin e zbatimit të tyre: Në zbatim të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 30 pika 2, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojë brenda afatit 6 mujor nga data e mbërritjes së RPA shkresërisht me objekt “Raportim mbi zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit” dërguar me shkresën nr. 424/8 prot., datë 31.08.2023, mbërritur dhe regjistruar në Bashkinë Dropull me nr. 1073/2 prot.dt.06.09.2023. Nga auditimi rezultoi se ky raportim është bërë me nr. 272 prot., datë 20.02.2024, brenda afatit 6 mujor.

Zbatuar

3. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, sic përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

- Bashkia Dropull **ka raportuar** në Këshillin Bashkiak lidhur me “Gjetjet dhe Rekomandimet e lëna në RPA të KLSH-së” me Njoftimin nr. 248/1 prot., datë 13.02.2024 është futur në rendin e ditës pika 6.

Zbatuar

B. Masa organizative.

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Dropull 25 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht nga të cilat: 13 masa janë zbatuar, 8 masa janë në proces zbatimi, 4 masë është pjesërisht zbatuar. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se plani i shpenzimeve në fillim të vitit është miratua në vlerën 220,105 mijë lekë, gjatë vitit ka pësuar rritje kryesisht për investime nga Ministria për ujësjellës, donacione nga projektet e BE si dhe ndihma ekonomike dhe paaftësi në vlerën 423,152 mijë lekë pra shpenzimet buxhetore gjithsej për vitin janë në vlerën 643,257 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 483,747 mijë lekë ose 75%.

U konstatua se ka diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit për disa zëra të shpenzimeve buxhetore, që mbulohen nga të ardhurat e veta, kështu shpenzime operative është planifikuar në vlerën 55,003 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 34,719 mijë lekë, ose në masën 63%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 54,328 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 12,301 mijë lekë, ose në masën 23 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Dropull në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara.

Për periudhën e vitit 2022 janë parashikuar realizimi i procedurave të vlerë të lartë dhe të ulët në artikullin (602/231) në shumën 130,994,200 lekë, *nga e cila*: prokurime me vlerë të lartë 115,340,010 lekë për 13 procedura dhe prokurime me vlerë të vogël me vlerë 15,654,191 lekë kjo për 40 procedura.

Në fakt nga të parashikuara janë realizuar vlera 109,954,949 lekë, *nga e cila*: procedura me vlerë të lartë 99,617,511 lekë dhe procedura me vlerë të vogël 10,337,438 lekë.

Vlera e fondeve të pa likuiduar të kontratave të lidhura dhe të përfunduara, në fund të vitit 2022, për artikullin (602/231) janë në vlerë 181,550,095 lekë, *nga e cila*: procedura me vlerë të lartë 180,191,049 lekë dhe procedura me vlerë të vogël janë 1,359,046 lekë.

Situata financiare e Bashkisë Dropull, sipas të dhënave të shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 dhe gjendjes së faturave të palikujduara në fund të periudhës ushtrimore paraqitet në nivelit 3.44 % të shpenzimeve vjetore të miratuara, të dhënat të cilat tregojnë se kjo bashki nuk është në vështirësi financiare, veprime në mospërputhje me pikën (a) të nenit 5 dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe vendimet përkatëse të këshillit bashkiak.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe sektorët e tjerë të bashkisë, të marrin masa për hartimin e një buxheti sa më real në raport me strukturën aktuale të bashkisë, të planifikimit të procedurave të prokurimit për investime/shërbime dhe blerje mallrash sipas nevojave që vetë bashkia ka dhe jo të planifikohen jashtë mundësive reale të cilat dështojnë në fazën e zbatimit të tij.

1.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve (Sektori i Menaxhimit të kontratave), të marrin masa për likuidimin e të gjitha faturave të depozituara me dokumentacion të rregullt ligjorë, si dhe të verifikojnë në cdo fazë afatet e përfundimit të punimeve dhe dorëzimit të faturave brenda afatit ligjorë. Në rast të evidentimit të vonesave të llogaritjet penalitet për kamatëvonesë, si dhe t’i kërkohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë llogaritjen e penaliteteve për TVSH e shitjes për vonesa në deklaram jashtë afateve.

Nga verifikimi rezultoi se: Me hartimin e PBA 2024-2026 dhe Planit vjetor 2024, Kryetari i Bashkisë në cilësinë e NA dhe kryetarit të GMS, Koordinatori i Riskut dhe Koordinatori MFK, Drejtoria ekonomike dhe menaxherët e tjerë të njësisë, kanë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Pra ***Rekomandimi 1.1*** është pranuar nga subjekti dhe ***në proces zbatimi.***

Nga verifikimi rezultoi se: Nga verifikimi rezultoi se Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve ka marrë masat për verifikimin dhe likuidimin e faturave me dokumentacion të rregullt, me përjashtim të faturave të pa paguara për punimet në ujësjellësat të

cilat i kemi deklaruar si detyrime të prapambetura, pasi janë fonde që çelen nga ministria e linjës. Pra **Rekomandimi 1.2** është pranuar nga subjekti është zbatuar.

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave vendore dhe akt akordimeve me Degën e Thesarit Gjirokastër, rezulton se:

Parashikimi për të ardhurat vendore është pjesë e parashikimeve buxhetore, duke përgatitur fillimisht në formë relacioni nga Drejtoria e të Ardhurave, sipas *Aneks 2.6.1 bashkëlidhur Raport Auditimit*.

Të ardhurat totale të Bashkisë Dropull janë realizuar në masën 84%, ku nga vlera e planifikuar prej 71,168 mijë lekë është arkëtuar vlera 59,699 mijë lekë me një mosrealizim në vlerën 11,469 mijë lekë. Në totalin e të ardhura rezulton se 11 zëra paraqiten me realizim mbi 100%, ndërsa 13 zëra paraqiten me mos realizim nga 2 deri në 90%.

Për vitin 2022 janë parashikuar 71,168 mijë lekë të ardhura nga 73,489 mijë lekë të parashikuara në vitin 2021 ose më pak për vlerën **2.321 mijë lekë**. Ndërsa në arkëtim nga 59,699 mijë lekë janë arkëtuar në vitin 2022 nga 68,755 mijë lekë të arkëtuara në vitin 2021 ose më pak për shumën **9,056 mijë lekë**. Ky mosrealizim ose planifikim dhe arkëtim i taksave e tarifave vendore me ulje nga njëra periudhë në tjetër tregon punën e pamjaftueshme të Drejtorisë së të Ardhurave vendore në menaxhimin më të mirë të të ardhurave, pasi faktorët që mund të argumentonin këtë mos realizim dhe ulje të detyrimeve, si numër i subjekteve dhe niveli i tyre sipas VKB, nuk janë faktorë të cilët mund të kenë ndikuar në këtë gjendje.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave bashkia Dropull, duhet të bëhet analizë e plotë dhe analitike e shkaqeve të mos realizimeve të të ardhurave sipas zërave, duke vlerësuar bazën e llogaritjes së detyrimeve apo dhe arsytet e tjera që kanë krijuar këtë lloj situatë, si dhe të marrin masa për një planifikim të saktë të detyrimeve nga taksat e tarifat vendore dhe rritjen e përgjegjësisë për arkëtimin e tyre.

Nga verifikimi rezultoi se: Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave /Bashkia Dropull, rezulton se nga ana e saj janë bërë analiza të punës së saj si dhe e të ardhurave të vjela gjatë vitit ushtrimor 2023. Kështu me shkresën nr. 164 prot., datë 01.02.2024 i është dërguar informacion i plotë për shqyrtim i analizës së të ardhurave të Bashkisë me argumentet përkatëse. Pra **Rekomandimi 2.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se në përgjithësi, akt-rakordimet janë mbajtur çdo muaj dhe janë regjistruar në evidencat përkatëse, si dhe protokolluar në përputhje me kërkesat e Nenit 13 të Normave Arkivore në R.Sh.

Të ardhurat nga DSHTRR derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Dropull brenda datës 5 të çdo muaji. Këto derdhje bëhen rregullisht dhe konfirmohen nga Dega e Thesarit Gjirokastër.

Konstatohet se nuk kanë mbajtur aktrakordimet me Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër, mbi nivelin e taksës së rentës minerale dhe tatimit mbi të ardhurat, sa është dhe sa duhet paguar në buxhetin e bashkisë Dropull.

Gjithashtu, nuk është bashkëpunuar me Drejtorinë ASHK Dega Gjirokastër, mbi numrin e transaksioneve të kryera, nivelin e tarifës së arkëtuar dhe xhiruar për llogari të bashkisë Dropull. Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel mesatar të realizimi. Bashkia Dropull nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e

mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm. Për sa më sipër, Bashkia Dropull nuk ka bërë asnjë lloj analize për mosrealizimin e këtyre taksave dhe jo vetëm këtyre. Në lidhje me detyrimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Dropull, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pambledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pambledhura apo të shmangura”, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 117, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, UMF nr. 26, datë 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, datë 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare” etj.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Dropull, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave.

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e të Ardhurave Vendore ka marrë masat dhe ka krijuar bazën e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, si dhe janë kryer rakordimet përkatëse.

- Kështu në Akt Rakordimin e datës 03.01.2024 mes Bashkisë Dropull dhe Postës Shqiptare/Filiali Gjirokastër “Mbi arkëtimin e Taksa e Tarifave vendore të subjekteve familjarë, për periudhën 01.12.2023 deri më 31.12.2023”; Me Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Gjirokastër për periudhën janar –dhjetor 2023; Rezultoi se Akt Rakordimet janë mbajtur sipas formularit përkatës të miratuar nga MFE.

- Nga Bashkia Dropull/Drejtoria e të Ardhurave Vendore është dërguar në ASHK shkresa me nr. 1347 prot., datë 19.09.2023 me objekt “Dhënie informacioni mbi regjistrimet e reja, ndryshimet e gjendjes së pronave dhe arkëtimin e vlerës që i takon Bashkisë Dropull”. Gjithashtu për mungesë reagimi nga ana e ASHK, iu ridërgua kërkesa duke aplikuar nga portali e-albania në datën 21.11.2023 me nr. kërkesë 8247 dhe me nr. 2039 datë 15.04.2024, si dhe ASHK (qëndrore). Nga ASHK u kthye përgjigje, por informacionin e plotë do e nisë deri në fund të muajit prill 2024. Në akt rakordimin me thesarin konfirmohet pagesa e bërë nga ASHK për llogari të Bashkisë Dropull të taksës së kalimit të pronësisë për periudhën janar –mars 2024 në vlerën 74,496 lekë që i takon një procedure. Konfirmimi është edhe me anë të dokumentit të e albania: kërkesa nr. 971 datë 26.02.2024, fatura nr. 969 datë 26.02.2024 paguar te BKT. Pra **Rekomandimi 3.1** është pranuar nga subjekti dhe është *zbatuar*.

3.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull, të marrë masa për ngritjen e një komisioni, me qëllim verifikimin e taksave dhe tarifave të vjela nga agjentët tatimorë, ku në rast se do të evidentohen diferenca të pa mbledhura për taksat dhe tarifatat vendore të cilat gjenerohen nëpërmjet agjentëve tatimorë (të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj), të fillojë procedurat për gjobitjen e agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Nga verifikimi rezultoi se: Me Urdhrin nr. 143/1 datë 15.09.2023 të Titullarit të Bashkisë Dropull dhe me nr. 1328/1 prot., datë 15.09.2023, është ngritur komisioni për verifikimin e taksave e tarifave të vjela nga agjentët tatimorë prej tre anëtarësh. Komisioni është në pritje të përgjigjes përfundimtare nga ASHK deri në 30.04.2024. Meqënëse ASHK filloi bashkëpunimin me bashkinë Dropull, komisioni nuk e shikon të nevojshme fillimin e procedurave për gjobitjen e ASHK me

50% të shumës së plotë taksave/tarifave të pambledhura. Pra **Rekomandimi 3.2** është pranuar nga subjekti dhe është *zbatuar*.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi si më poshtë:

Me VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Per transferimin ne pronësi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht ne administrim te Ministrisë se Mjedisit e te ish komunave/bashkive”, ndryshuar me VKM nr.398, datë 13.05.2020 është miratuar lista e inventarit te pyjeve dhe kullotave qe transferohen ne pronësi te Bashkise Dropull”, sipas te cilit jane transferuar **24.841,6704 ha** gjithsej, nga e cila, **13.091,0369 ha** kullota, **11.558,1446 ha pyje**, **88,63 ha** toke shkëmbore, **88,63 ha** siperfaqe rezervuari dhe **47,68 ha** siperfaqe ranishte.

Per periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, jane miratuar tarifat per dhënie me qira te sipërfaqeve kullimore e pyjore per kullota dimërore, ne mbështetje te VKM nr.632, datë 11.06.2009 “Per miratimin e tarifave te përdorimit te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje” me VKB nr. 69, datë 25.11.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr.1075/1, datë 9.12.2021. Nga kjo Bashki per periudhën e mësipërme, jane lidhur 43 kontrata qiraje per kullota dimërore me nje siperfaqe prej 4239.88 ha.

Per periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022, janë miratuar tarifat per dhënie me qira te sipërfaqeve kullimore e pyjore për kullota verore në mbështetje te VKM nr.632, datë 11.06.2009 “Per miratimin e tarifave te përdorimit te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje” me VKB nr. 69, datë 25.11.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr.1075/1, datë 9.12.2021.

Nga kjo Bashki per periudhën e mësipërme, jane lidhur 35 kontrata qiraje per kullota verore me nje siperfaqe kullimore prej 6467.59 ha, ne nje kohe, qe sipas VKB nr. 2, datë 27.01.2022 “Per miratimin e listës se kullotave te gatshme per kullotje per sezonin veror –dimërore” është miratuar per dhënie me qira siperfaqja kullimore prej 6819.68 ha.

Gjithashtu, nga ana e Drejtorisë se Administrimit te Ujrave, Pyjeve, Livadheve dhe Kullotave, nuk është hartuar regjistri i kapacitete kullimore per sipërfaqet kullimore dhe pyjore qe ka ne pronësi Bashkia, por, per sipërfaqet e dhëna me qira jane aplikuar kapacitetet e përcaktuara ne Planin e mbarëshimit per periudhën 2009 / 2019 te hartuar nga ish Drejtoria e Pyjeve e cila është hartuar per nje siperfaqe pjesore prej 5.175 ha dhe jo per gjithë sipërfaqen kullimore qe ka ne pronësi Bashkia Dropull.

Nga auditimi i dosjeve te kontratave verore dhe dimërore te lidhura, rezultoi se, është zbatuar procedura e përcaktuar ne Udhëzimin e Ministrit te Mjedisit Nr.4, datë 10.04.2008 “Per kriteret teknike te klasifikimit te kullotave e livadheve dhe procedurat per dhënien e tyre per kullotje e kositje bari”, pasi te gjitha dosjet e subjekteve qiramarrës te kullotave jane plotësuar me dokumentacionin e përcaktuar ne Udhëzimin e sipërpërmendur, qe nga kërkesa deri te proces verbali i dorëzimit te parcelave te marra me qira, me përjashtim te pikave te mëposhtme:

- Nga ana e Zyrës se Pyje kullotave nuk është shpallur lista e kullotave te gatshme per kullotje dhe sipërfaqet qe përjashtohen nga kullotja, ne muajin Shkurt te cdo viti, ne zbatim te kreut II “Procedurat e dhënies per kullote dhe kositje bari”, pika 2 te Udhëzimit te mësipërm.

- Nga ana e qiradhënësit, Bashkise, nuk jane bërë sondazhe gjate kullotjes per te mos lejuar futjen e bagëtive ne kullote jashtë kapacitetit kullisor te kontraktuar, ne kundërshtim me kreun III “Kërkesat teknike te përdorimit te fondit kullisor per kullotje”, pika 7 te Udhëzimit te mësipërm.

- Nga ana e strukturës përgjegjëse nuk është bërë verifikimi ne terren nëse është zbatuar kontrata dhe nëse ne parcele jane futur po aq krerë sa është lidhur kontrata, per te cilën, rekomandohet te behet verifikimi me nje komision te miratuar nga titullari.

- Nuk ka bashkëpunim me AZHBR Qarku Gjirokastër në lidhje me numrin e bagëtive të regjistruara për bashkinë Dropull.
 - Kontratat në çdo rast nuk kanë bërë përcaktimin se kujt akti i janë referuar për ndarjen e kullotave (*sipas vendimit të Komisionit të Ndarjes së Kullotave apo vendimit të këshillit të komunës*).
 - Nuk administrohej hartë për sipërfaqen e shfrytëzueshme.
 - Për të gjitha kontratat, konstatohet se nuk ka ekstrakt nga QKR për objektin e veprimtarisë të secilit fermer që ka përfituar kontratë, si dhe nuk ka certifikatë nga Drejtoria e Shërbimeve Veterinare për numrin e regjistrimit të bagëtive dhe matrikullin e tyre, duke mos u dokumentuar numri real i secilit blegtor.
 - Nuk është kryer inventarizimi kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës).
 - Nuk është mbajtur bilanci i fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall.
 - Nuk është bërë mbajtja, evidentimi, administrimi balancimit të fondit kullimor.
 - Lidhur me pyjet e kullotat, ndonëse kanë kaluar në pronësi, nuk janë pasqyruar në kontabilitet, llogaria nr. 211 “pyjet, kullotat dhe plantacione”, pasi aktivi i bilancit nuk paraqet fare gjendjen e kësaj llogarie, si dhe nuk është vijuar me regjistrimin e pronave të paregjistruara, pasi këto prona nuk janë të regjistruara në emër të NJQV, duke sjellë për pasojë të qenurit pronar me të drejta jo të plota por të kufizuara.
 - Nuk ka plan mbarështimi për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme.
 - Nuk janë mbajtur akte të kontrollit të përdorimit të sipërfaqes.
 - Nuk janë përcaktuar kriteret për dhënien me qira të tyre, nga ku kriteret prioritare si p.sh. fermerët me banim brenda territorit të njësisë, me vendndodhje afër kullotës, që mbarështojnë një numër të madh bagëties, të atyre që shtegtojnë tufat në ekonomi të tjera kullimore e që kanë qenë të kontraktuar sezonin e kaluar.
 - Nuk ka hartuar planet e mbarështimit të kullotave.
- Veprime në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për Fondin Kullimor”, i ndryshuar me Ligjin nr. 49/2016, neni 26, “*Bashkitë janë pronarë të kullotave që gjenden brenda territorit administrativ të tyre dhe kanë për detyrë të a) ruajnë, administrojnë dhe i përdorin kullotat dhe livadhet, në përputhje me kërkesat e këtij ligji e të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij; b) hartojnë, me shpenzimet e veta, planet e mbarështimit të kullotës apo livadhit, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për kullotat dhe livadhet*”; Ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në NJQV”; Ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”; Udhëzimi nr. 4, datë 10.04.2008, “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave, të livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”; VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullotje dhe kositje”; Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” dhe VKM nr.22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, pika 3 e vijim; pika 3/3, 5/e, dhe 6 e VKM nr. 396, datë 21.06.2006.; me nenet 11 dhe 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 28.3.2001 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, ndryshuar me ligjin nr. 10210, datë 25.3.2010, në referim të ligjit 5 “Planet e Mbarështimit”, neni 6 “Funksionimin e Shërbimit Pyjor”, neni 15/2 “Pronësia e Fondit Pyjor” të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, i ndryshuar.

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull të ngrejë një grup pune me specialist të fushës, si dhe të marrin të gjitha masa për inventarizimi kadastral pyjor për përditësimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës); mbajtjen e bilancit të fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore, fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës truall; mbajtjen, evidentimin, administrimin e balancimit të fondit kullor; pasqyrimin në kontabilitet, në llogaria nr. 211 “*pyjet, kullotat dhe plantacione*”, aplikimit për regjistrim të parcelave në ASHK Drejtoria Gjirokastër; hartimin e plan mbarështimit për secilën ngastër apo nëngastër, lidhur me kryerjen e shërbimeve mbarështuese dhe vjeljen e produkteve dytësore si bimë të ndryshme; krijimin të ardhura nga lëndët drusore, përdorimi i pyjeve për qëllime çlodhëse, të ardhura nga gjuetia e faunës, dhe hartimin e plan mbarështimit menaxhimit të pyjeve dhe kullotave; përcaktimin e kritereve për dhënien me qira të tyre.

Nga verifikimi rezultoi se: Me Urdhrin e Titullarit nr. 144 datë 15.09.2023 dhe me nr. 1329 prot., datë 15.09.2023 është ngritur grupi i punës për të zbatuar rekomandimin e lënë. Kështu komisioni ka verifikuar gjendjen fizike dhe inventarizimin e asetëve pyje, tokë e kullota. Rezulton se për asetet e transferuara me VKM nr. 433/2016 në Bashkinë Dropull, gjendja është si më poshtë:

Emërtimi i asetit	Sip. në ha	Verifikim fizik	Regjistruar në ASHK	Titull Pronësie
Pyje	10,641.01	po		jo
Kullotë	14,911.99	po		
Toka joproductive	28.10	po		
Shkëmbore e ujore	30.03	po		
Totali	25,611.13		272.77	

Nga informacioni tabelar dhe shkresor rezulton se nga komisioni i ngritur është bërë vetëm verifikimi fizik i tyre dhe se nuk i janë nënshtruar procedurave të regjistrimit dhe të pajisjes së tyre me titull pronësie në ASHK. Pra **Rekomandimi 4.1** është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

5. Gjetje nga auditimi: Auditimi për administrimin dhe dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, u krye në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8312 datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pa ndara”, VKM nr. 531 datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, Udhëzimit KM nr. 1 datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies të tokave bujqësore të pandara” Udhërit të MBU nr 10 datë 13.09.2012 “Për mënyrën e përlllogaritjes së kritereve të vlerësimit të ofertave për marrjen me qira të tokës bujqësore, të pandara” dhe Udhërit të Ministrit të M.B.U me nr 13 datë 15.01.2013 “Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore, të pandara”, *ku u konstatua se:*

Për periudhën e audituar 01.01.2022 – 31.12.2022, nga kjo bashki nuk është lidhur asnjë kontratë për dhënie me qira të tokës bujqësore të pandara, por ka në vazhdim 5 kontrata me një sipërfaqe totale prej 91.761 m², të lidhura nga ish Njësitë e Qeverisjes vendore (Komunat), e përkatësisht:

- Kontrata e lidhur me **z. F.L.** me nr rep. 1222 dhe koleksioni nr 758 datë 08.07.2011, për parcelën me nr kadastral 95/37 në fshatin Bodrishte me sipërfaqe 18.748 m², për kultivim peme frutore, me çmim 6.000 lekë/ha/vit, me afat dhënie me qira për 99 vjet.
- Kontrata e lidhur me **z. J.L.** me nr rep. 1221 dhe koleksioni nr 757 datë 08.07.2011, për parcelën me nr kadastra I 94/1 në fshatin Bodrishte me sipërfaqe 34.976 m², për kultivim peme frutore, me çmim 6.000 lekë/ha/vit, me afat dhënie me qira për 99 vjet.

- Kontrata e lidhur me subjektin **2**.me nr rep. 666 dhe koleksioni nr 303 datë 27.03.2013, per parcelën me nr kadastral 138/2 e pjesshme ne fshatin Bularat, sipërfaqen prej 7.300 m2, per nje afat 35 vjet, me tarife 6.100 lek/ha/vit kalendarik, per përdorim sipas planit te biznesit te datës 15.11.2012, ku përcakton mbjelljen e 460 rrënjëve dardhe.
- Kontrata e lidhur me **z.S.Ç.**, me nr rep. 665 dhe koleksioni nr 302 datë 27.03.2013,per parcelat 301/9 deri 301/19 tek zona kadastrale 2278, ne fshatin Krioner, per sipërfaqen prej 14.914 m2, me afat per 35 vjet, me tarife 6.200 lek/ha/vit kalendarik, per mbjellje dru frutore sipas planit te biznesit, ku përcakton mbjelljen e 315 rrënjëve ara.
- Kontrata e lidhur me **z.Th.Q.**, datë 30.03.2017, per parcelat me nr. pasurie 236/23, tek zona kadastrale 3018, ne fshatin Poliçan, per sipërfaqen prej 16.547 m2, me afat per 99 vjet, me tarife 9.000 lek/ha/vit kalendarik, per mbjellje te kulturës ara.
- Kontrata nr. 545/169 e lidhur me **z. Dh.Gj.**, datë 20.5.2022, per parcelat me nr. pasurie 456, tek zona kadastrale 2233, ne fshatin Koshivic, per sipërfaqen prej 0.1769 ha, me afat per 10 vjet, me tarife 6,500 lek/ha/vit kalendarik, per mbjellje te kulturës patate.
- Kontrata nr. 1346/447 e lidhur me **z. Dh.Gj.**, datë 24.11.2022, per parcelat me nr. pasurie 442, tek zona kadastrale 2483, ne fshatin Llongo, per sipërfaqen prej 5.9229 ha, me afat per 99 vjet, me tarife 7,200 lek/ha/vit kalendarik, per mbjellje te kulturës gështenjë.

Gjithashtu:

- Bashkia Dropull në zbatim të Udhëzimit nr. 1 datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, ka iniciuar procesin për dhënien me qira të tokave bujqësore **por pa miratim në Këshillin Bashkiak** për dhënien me qira të tokave bujqësore të lira me qëllim sigurimin e të ardhurave.
- Mungon proces verbali mbi tërheqjen e dokumentacionit te plotë të dhënies me qira te këtyre sipërfaqeve.
- Nuk disponohet regjistri i plotësuar me te gjitha te dhënat per te ndjekur kërkesat e kontratave te lidhura si dhe arkëtimet ne vazhdimësi.
- Ne kundërshtim me kërkesat e kontratës tip, kontrate e miratuar me Urdhrit të Ministrit te M.B.U me nr 13 datë 15.01.2013 “Per miratimin e përmbajtjes dhe formës se kontratës tip per dhënien me qira te tokave bujqësore, te pandara”, neni 2 “Detyrimet e qiramarrësit” pika “ dh”, ku jo te gjitha rastet është paraqitur ne Bashki, kontrata e depozituar pranë ASHK Gjirokastër, kjo per te lenë gjurme auditimit ne verifikimin e tyre.
- Ne kundërshtim me kërkesat e kontratës tip neni 3, pika “c”, kontrate e miratuar me Urdhrin e Ministrit te M.B.U me nr 13 datë 15.01.2013 “Per miratimin e përmbajtjes dhe formës se kontratës tip per dhënien me qira te tokave bujqësore, te pandara”, nga ana e qiradhënësit nuk është kryer asnjë kontroll periodik, per te verifikuar nëse qiramarrësi respekton detyrimet dhe kushtet ligjore te legjislacionit mbi token bujqësore, ato te kësaj kontrate, kriteret dhe elementet e përcaktuar ne kërkesën e paraqitur prej tij pranë autoritetit qiradhënës per marrjen me qira te pasurisë.
- Nga Bashkia Dropull, nuk është dërguar informacion me shkrim, për zyrën e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave në Këshillin e Qarkut Gjirokastrës, në lidhje me dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, në dhjetor të çdo viti, veprim jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, kreu V, pika 4.
- Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1 datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, kreu II, pika 1; VKM nr. 510 datë 10.06.2015 “Per miratimin e procedurave per transferimin e te drejtave dhe detyrimeve,

personelit, aktiveve te trupëzuara dhe te pa trupëzuara, te arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar ne njësitë e qeverisjes vendore, te prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë bashkia Dropull të ngrejë një grup pune me specialit të fushës për verifikimin e zbatimit të kontratave të qirasë së tokave bujqësore të lidhura nga ish- komunat, nëse ato shfrytëzohen për llojin e kontratës për të cilën është lidhur dhe nëse respektojnë detyrimet dhe kushtet ligjore të legjislacionit mbi tokën bujqësore.

- Për sipërfaqet e reja që do lëshohen me qira, fillimisht duhet të miratohen në Këshillin Bashkiak përpara shpalljes në ankand.

- Për të gjitha kontratat e lidhura, të informohet zyrtarisht Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokave në Këshillin e Qarkut Gjirokastër.

Nga verifikimi rezultoi se: Me Urdhrin e Titullarit nr. 143 datë 15.09.2023 dhe me nr. 1328 prot., datë 15.09.2023 është ngritur grupi i punës prej katër anëtarësh për të zbatuar rekomandimin e lënë, duke kontrolluar kontratat e lidhura nga ish-Komunat dhe janë mbajtur procesverbalet respektive: nr. 1349 prot., datë 20.09.2023; nr. 1349/1 datë 22.09.2023; nr. 1349/2 prot., datë 25.09.2023; nr. 1349/3 prot., datë 25.09.2023; nr. 1425/1 prot., datë 06.10.2023 dhe nr. 1349/2 prot., datë 25.09.2023;

- Kalojnë për miratim në Këshillin Bashkiak sipërfaqet e reja që do të lëshohen me qira;

- Nuk është dërguar informacion shkresor në DAMT në Këshillin e Qarkut Gjirokastër, pasi nga komunikimi me subjektin, rezultoi se në komisionin e marrjes në shqyrtim të kërkesave për marrje me qira të aseteve të bashkisë (llog.211 “pyje, kullota, toka”) është edhe një anëtar, specialist i fushës nga DAMT, i cili është pjesë e vendimarrjes për kontratat që do të lidhen.

Nunri i subjekteve	Emërtimi i kontratës	Sipërfaqja në ha	Vlera në lekë	statusi
33	Kontrata pranverore	6,178.41	1,909,844	arkëtuar
39	Kontrata dimërore	4,037.4	1,006,410	arkëtuar
72	Totali	10115.81	2,916,254	√

Pra **Rekomandimi 4.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2022, rezulton se në bashkinë Dropull nuk ekziston regjistri i aseteve për pronat si për kullotat, pyjet etje, si dhe nuk është kryer vlerësimi dhe inventarizimi i tyre. Vlerësimi i aktiveve nuk është bërë i mundur për arsye se duhet aktivet që të vlerësohen duhet të kenë certifikatë pronësie. Nga bashkia Dropull nuk është bërë pajisja me certifikatë pronësie, jo vetëm për arsye financiare por dhe për shkak të kryerjes së aplikimeve pranë ASHK dhe mos pajisjes me certifikatë pronësie. Nga ish komunat janë bërë aplikime dhe janë kryer pagesat për 46 prona dhe kryer pagesa me vlerë 332,000 lekë, por që nuk është bërë pajisja me certifikatë pronësie.

Për NJA Dropull i Sipërm janë 91 prona me vlerë 502,600 lekë, aplikime këto të bëra që në vitin 2014. Me shkresën nr. 180 prot, datë 25.5.2015 nga ish-komuna Dropull i Poshtëm është dërguar kërkesë Kryeregjistrusit të ish- ZVRPP Tiranë. Me datë 16.10.2019 me shkresën nr. 1815 prot, datë 16.10.2019 është ripërsëritur kërkesa për paisje me certifikatë pronësie sipas aplikimeve dhe pagesave të kryera. Nga ASHK nuk rezulton të jetë bërë shkresë për përgjigje. Nga 193 prona inventari të pasurive të paluajtshme me kosto historike që i përkasin llog. 210 toka troje terren, llog. Pyje plantacione, 212 ndërtesa e konstruksione, bashkia Dropull nuk posedon titull pronësie në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.8.2001 “për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme, kreu VI ‘Transferimi i pasurive”, pika 1 dhe 2.

Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale nuk është mbështetur në dokumentacion e duhur në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, kapitulli III pika 35.

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkise Dropull në bashkëpunim me Sektorin e Buxhetit dhe Menaxhimit të Asteve të marrë masa të menjëhershme për përmirësimin e gjendjes me parashtrimin të problematikës në GMS.

- Të ndërmarrë dhe nisë të gjitha procedurat për sigurimin e dokumentacionit vërtetues siç është titull pronësie për pronat; “toka, troje, terrene, pyje, plantacione. Ndërtesa dhe konstruksione”, për vlerësim e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve të bashkisë me qëllim paraqitje e vlerës së këtyre aktiveve në pasqyrat financiar të njësisë publike vendore.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Dropull ka marrë nasat për zbatimin e rekomandimit. Deri tani ka verifikuar gjendjen fizike të asetëve, përditësimin e tyre në tyre në regjistrin e inventareve dhe po përgatiten praktikat për aplikimim në ASHK për pajisjen e tyre me titull pronësie, ku përfshihet edhe rivlerësimi i tyre. Pra **Rekomandimi 6.1** është pranuar nga subjekti dhe është pjesërisht zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së miratimit të “Leje ndërtimi, me sipërfaqe 63.2 m²”, për të cilën është marrë vendimi **Nr.750, datë 28/4/2021**, i Kryetarit të Bashkisë Dropull për objektin “Shtese Anësore Banese Adresa e realizimit të punimeve”, me zhvillues **Th.N., u konstatua si më poshtë:**

- Nga kontrolli në sistemin e-leje konstatohet se planvendosjen e miratuar nuk është e saktë pasi nuk ka të detajuara të gjitha elementët e nevojshëm si, distancat e objektit që do ndërtohet nga objektet rreth tij, si dhe numrat e kateve në kundërshtim kjo me Kushtet Teknike të Projektimit KTP.

- Preventivi i llogaritur nga projektuesi nuk është llogaritur bazuar në çmimet e referencës për koston e ndërtimit sipas zonave përkatëse. Për ndërtime të caktuara sipas kategorive të tyre preventivi nuk mund të jetë më i ulët se kostoja e ndërtimit çmimi i të cilës është caktuar nga Enti Kombëtar i Banesave EKB. Kostoja e ndërtimit sipas EKB është 32,614 lekë/m².

- Planvendosjen e miratuar nga ana e DPZHKT bashkia Dropull nuk është respektuar distanca e objektit që do ndërtohet me kufirin e pronës, në kundërshti me Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 35 *Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës*. Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në planin e përgjithshëm vendor, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m (d= nr. K +1m) ku: d – distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. K – numri i kateve.

- Nuk është marrë mendim nga instucionit (Agjensia e Zhvillimit të territorit ASHK, UK, ASHK) për lejet, në kundërshtim kjo me Vendim Nr. 408, datë 13.5.2015 Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territori, Neni 15 pika ë) Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislationit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit, veprime në kundërshtim me çmimet e Enti Kombëtar i Banesave (EKB), *kostoja e ndërtimit sipas EKB është 32,614 lekë/m²*; VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, respektivisht nenet 15 dhe 35.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Dropull, të marrë masa për:

- Të mos pranuar preventiv fiktiv nga ana e projektuesit duke kontrolluar zërat e punës dhe llogaritur preventivin jo më pak se kostoja e ndërtimit.
- Të respektohet distancat e lejuara nga kufiri i pronës.
- Të miratuar leje ndërtimi me mendimet pozitive të aprovuara nga institucionet e nevojshme për të dhënë këtë mendim.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga DPZHT Bashkia Dropull janë marrë masat për zbatimin e kërkesave të rekomanduara. Pra **Rekomandimi 7.1** është pranuar nga subjekti dhe është pjesërisht zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së miratimit të “Leje ndërtimi, me sipërfaqe 100 m²”, për të cilën është marrë vendimi **Nr.1090, datë 27/6/2021**, i Kryetarit të Bashkisë Dropull për objektin “Shtese kati mbi objekt ekzistues – Jorgucat – Gjirokastër”, me zhvillues **R.V.**, u konstatua si më poshtë:

-Planvendosjen e miratuar nuk është e saktë pasi nuk ka të detajuara të gjitha elementët e nevojshëm si distancat e objektit që do ndërtohet nga objektet rreth tij si dhe numrat e kateve në kundërshtim kjo me Kushtet Teknike të Projektimit KTP.

- Miratuar leje ndërtimi për shtesë kati në objektin ekzistues 2 kate. Objekti në fjalë nuk është i gjithi në pronësi të personit që është miratuar leja e ndërtimit por janë pronarë familje të ndryshme. Leja e miratuar nga ana e DPZHKT bashkia Dropull është dhënë mbi tarracën e personit që ka aplikuar ndërkohë tarraca hynë tek objektet e përbashkëta referuar ligjit nr. 10112 datë 09.04.2009 “Për administrimin e hapësirave të përbashkëta” Neni 5 Objekte në pronësi të përbashkët, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10112 datë 09.04.2009 “Për administrimin e hapësirave të përbashkëta”, Neni 5.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Dropull, të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimi të tarracave ku ka bashkëpronësi dhe në mosrespektim të nenit 5 të ligjit nr. 10112 datë 09.04.2009 “Për administrimin e hapësirave të përbashkëta”, i ndryshuar.

Nga verifikimi rezultoi se: Regjistrin të lejeve të ndërtimit të miratuara gjatë vitit 2023, rezultoi si më poshtë:

Nr	Nr i Lejes	Objekti	Afati
1	342 prot., datë 21.02.2023	Rrethim prone	4 muaj
2	517 prot., datë 20.03.2023	Ndryshim i projektit gjatë ndërtimit	Afati i lejes ekzistuese
3	575 prot., datë 31.03.2023	Ndërtim objekti 2 katësh	18 muaj
4	1008 prot., datë 12.07.2023	Shtesë kati për banesë	12 muaj
5	1009 prot., datë 12.07.2023	Murr Rrethues-rrethim prone	24 muaj
6	1463 prot., datë 13.10.2023	Shtesë anësore banese	12 muaj
7	1464 prot., datë 13.10.2023	Shtresë objekti/fabrikë përpunim kartoni	12 muaj

Referuar të dhënave të tabelës konkretisht objektit të lejes së ndërtimit të miratuar, rezulton se gjatë vitit 2023 nuk ka patur aplikime dhe rrjedhimisht as miratime për tarraca në objekte me bashkëpronësi. Pra **Rekomandimi 8.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur mbi veprimtarinë e Inspektoriatit Mbrojtjes Territorit, rezulton se në bashkinë Dropull kjo strukturë nuk është e plotësuar pasi ka vetëm një person të punësuar në këtë inspektoriat. IMT nuk posedon blloqe të procesverbaleve të kundërvajtjes si dhe blloqe për daljen e vendimeve të gjobave apo prishjes së

objekteve të cilat janë në kundërshtim me ligjin 107/2014 “Për planifikimin e territorit”, si dhe ligjin 9780 “Për inspektimin e ndërtimit”.

9.1. Rekomandimi: Kryetari i bashkisë Dropull në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrin masa për ngritjen e strukturës së Inspektoratit Mbrojtjes Territorit, si një strukturë e domosdoshme nga ndërtimet pa leje.

Në rast mungesë specialisti të fushës sipas përcaktimeve të ligjore të bëhet marrëveshje me IKM të Qarkut Gjirokastrë për kontrollin e territorit.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e Titullarit dhe e DBNJ janë marrë masat që në territorin e Bashkisë Dropull në pamundësi për të patur një strukturë të plotë dhe efektive të IMTV, me shkresën nr. 146 prot., datë 13.10.2023 i është kërkuar Bashkisë Finiq bashkëpunim që IMTV Bashkia Finiq të ushtrij funksionin e vet edhe në territorin e Bashkisë Dropull. Pati një dakortësi verbale nga të dy palët, e cila u shoqërua me ristrukturim organizativ të Bashkisë Dropull pa IMTV. Në momentin e lidhjes së Akt marrëveshjes, pas verifikimeve në kuadrin ligjor u konstatua se neni 6 “bashkëpunimi dhe delegimi i përgjegjësive dhe detyrave për inspektimin ndërtimor urbanistik të bashkisë ishte shfuqizuar. Në këto kushte Drejtoria e Burimeve Njerëzore nëpërmjet një Relacioni “Për miratimin e ngritjes së IMTV dhe nivelit të pagave të punonjësve të tij për vitin 2024” drejtuar Kryetarit të Bashkisë, i ka bashkëngjitur praktikës nr. 611 prot., datë 08.05.2024 për shqyrtim në Këshillin Bashkiak. Pra **Rekomandimi 9.1** është pranuar nga subjekti, është pjesërisht zbatuar dhe në proces.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të kontratës për punë publike, me objekt: “*Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat*” Bashkia Dropull, rezultoi se investimi, nuk është marrë në dorëzim për shkak të mos plotësimit të rekomandimeve të lëna nga grupi i marrjes në dorëzim, për arsyet:

-Mos vendosje reduktor presioni, për: rezervuarin 200 m³ nr. 1 (Nga ana e Goraxisë) dhe rrjetin shpërndarës; për dhomën e komandimit rezervuari nr. 2 (Nga ana e Lazaratit) dhe rrjetin shpërndarës; për rezervuarin 200 m³ nr. 3 (Nga ana e Lazaratit) dhe rrjetin shpërndarës; për rrjetin shpërndarës fshati Sofratikë sipas projektit të zbatimit, si dhe për mos zbatimin e disa zërave të përcaktuar në proces verbalin e datës 29.03.2023 hartuar nga grupi i punës pranë Njësinë Administrative të Dropullit të Poshtëm në Bashkisë Dropull.

10.1. Rekomandimi: Bashkia Dropull në bashkëpunim me Mbikëqyrësin e punimeve dhe Kolaudatorin e punimeve, të marrin masa për marrjen në dorëzim të parakohshëm të investimit me objekt: “*Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat*”, pasi të plotësohen nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria “K.K.” SHPK rekomandimet e lëna nga grupi i marrjes në dorëzim sipas proces verbalit të datës 29.03.2023.

- Gjithashtu të merren masa të menjëhershme për vendosjen e reduktorëve të presionit, për rezervuarin 200 m³ nr.1 (Nga ana e Goraxisë) dhe rrjetin shpërndarës; për dhomën e komandimit rezervuari nr. 2 (Nga ana e Lazaratit) dhe rrjetin shpërndarës; për rezervuarin 200 m³ nr. 3 (Nga ana e Lazaratit) dhe rrjetin shpërndarës, për rrjetin shpërndarës fshati Sofratikë sipas projektit të zbatimit.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e Bashkisë janë marrë masat, konkretisht: me shkresën nr. 577/1 prot., datë 07.07.2023 është njoftuar subjekti “K.K.” shpk në dijeni të shoqërisë “G.”, referuar konstatimeve të procesverbalit të mbajtur me nr. 577 prot., dt. 29.03.2023 nga grupi i punës së Bashkisë Dropull (autoiriteti kontraktor) dhe ing. N.M.në cilësinë e mbikqyrësit të punimeve, Akt Konstatimit nr. 14 të KLSH si dhe verifikim në vend (terren) të punimeve, për marrjen e masave nga ana e tij për kryerjen e punimeve të pakryera. Në shkresë janë listuar punët

e pakryera dhe rezultati i tyre pas verifikimit në terren. Rezulton se korrigjimet janë bërë të pjesshme. Kërkesa është ripërsëritur me nr. 577/2 prot., datë 23.08.2023 si rezultat i problematikave të krijuara nga mosangazhimi për zbatimin e kërkesave të lëna në shkresën e datës 07.07.2023 dhe njoftimit të bërë në datë 19.07.2023. Pas këtyre komunikimeve, është përpiluar Procesverbali i marrjes në dorëzim (i përkohshëm) me nr. 577/3 prot., datë 24.10.2023, mes palëve: AK Bashkia Dropull/Grupi i marrjes në dorëzim, Sipërmarrësi i punimeve Shoqëria “K.K.” shpk, Mbikqyrësi i punimeve Shoqëria “G.” shpk, Drejtuesi ligjor Shoqëria “HE&SK 11” shpk. Pra **Rekomandimi 10.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 5 procedurave me vlerë të lartë me fond limit **419,885** mijë lekë të vlerësuara për auditim për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2022, janë konstatuar në shkelle të akteve ligjore e nënligjore në **aliquimin e kriterëve** të paargumentuara dhe jo në përputhje me procedurat e zhvilluara gjithsej **3** procedura me fond limit **402,919** mijë lekë, kriterë të cilat kanë ndikuar në mos pjesëmarrjen e OE ose në skualifikimin e OE me oferta të leverdishme, konkretisht:

a- *Procedura me objekt “Rikonstruksion Shkolla e Mesme e Bashkuar “Bularat”+kopesht Bularat,Dropull i Siperme” zhvilluar në vitin 2022, me fond limit 58,648,181 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 53,945,123 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “GJ.”.*

b-*P{rpedura me objekt Rikonstruksion i rrjetit te brendshëm te ujësjellësit te Dervician,Sofratik dhe Terihat ,Bashkia Dropull”, zhvilluar në vitin 2021, me fond limit 120,286,360 lekë dhe vlerë kontrte 119,025,533 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “K.K.”.*

c- *Procedura me objekt “Rikonstruksioni i rrjeteve te brendshme te ujësjellësit te fshatrave Zervat ,Vanister,Haskov,Gorice,Frashtan,Lugar dhe Grapsh, Bashkia Dropull”, zhvilluar viti 2021, me fond limit 210,633,067 lekë dhe vlerë kontrate 206,313,149 lekë, ku fitues është shpallur JV “R.”, “T.” & “Sh.” & “V.K.” ShPK.*

d- *Procedura me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve te brendshme ne fshatrat e Bashkise e mbrojtje malore” zhvilluar viti 2021, me fond limit 13,352,072 lekë dhe vlerë kontrate 13,214,300 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “M/S”.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, në lidhje me kriteret specifik, për procedurat e prokurimit të sipërcituara, konstatohet se janë vendosur pika licence me nivele të klasifikimit të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve si dhe kategori jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit. Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit. Kërkesa për mjek të përgjithshme të pambështetur në ligj, etj.

Vendosja si kriterë e licencave me nivele të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe me natyrën e objektit të prokurimit, nga njëra anë, eventualisht dhe potencialisht cënon konkurrencën, në kundërshtim me vetë qëllimin e ligjit “Për prokurimin publik”, pasi vendosja e këtyre kërkesave ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e OE, dhe nga ana tjetër, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në procedurat e prokurimit.

Mos hartimi I oponenca teknike në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 120/2020, datë 7.10.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

Nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

11.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike (Sektori i procedurave të Prokurimit) në Bashkinë Dropull, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për të gjithë procedurat që do prokurohen në fushën e investimeve, pavarësisht nga vlera nuk duhet të hidhen në prokurim pa marrë më parë miratimin nga Instituti i Ndërtimit për oponentin teknik të investimit.

Nga verifikimi rezultoi se: Regjistrin të prokurimeve të zhvilluara gjatë vitit 2023, rezultoi se janë realizuar dyzetë e pesë (45) procedura. Nga NJP janë marrë masat që në çdo procedurë të tregohet vëmendje e shtuar ndaj kërkesave të rekomanduara. Pra **Rekomandimi 11.1** është pranuar nga subjekti dhe është *në proces zbatimi*.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, mbi vlerësimin e aktivitetit të Njesisë së auditimit të brendshëm në Bashkinë Dropull u konstatua se:

1.1 Referuar Planeve Strategjike [2021-2023 dhe 2022-2024] dhe atyre Vjetorë [2021 dhe 2022], planifikimit dhe grafikut të shpërndarjes së misioneve audituese për tu realizuar nga NJAB, regjistrin dhe vlerësimin të riskut, rezulton se ndihet e nevojshme realizimi i Auditimit IT, pasi konstatimet dhe rekomandimet e të cilit përpos të tjerave, do të mundësonin lehtësi edhe në procesin auditues të fushave/sistemeve të tjera vlerësuar me risk të lartë. Kjo sipas komunikimit me NJAB vjen si rezultat i mungesës së kapaciteteve, për të cilat nga ana e NJAB *duhej të parashtrohej te Titullari me rëndësinë e duhur*.

1.2 Nga auditimi i planeve strategjike dhe vjetorë të miratuar si edhe realizimit të tyre për vitet 2021 e 2022, rezultoi se NJAB nuk ka planifikuar mision auditues për fushën e “menaxhimit të burimeve njerëzore”, duke rezultuar e klasifikuar me risk të ulët. Vlerësimi jo real me koeficientin e riskut të kësaj fushe, ka sjellë mungesën e misionit auditues të paktën këto 3 vitet e fundit në strukturën përgjegjëse të menaxhimit të burimeve njerëzore – Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme. Kjo ka sjellë mospërfshirjen në planin strategjik dhe ato vjetorë të të gjitha njësive të strukturës organizative me referim koeficientin e riskut, ku ato me risk të lartë auditohen çdo vit, me risk të mesëm në çdo 3 vjet dhe ato me risk të ulët në çdo 5 vjet, të gjitha këto në moszbatim të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, Kapitulli III, pika 3.1.2; 3.

1.3 Nga auditimi mbi rekomandimet e lëna nga NJAB në misionet audituese të realizuara në 3 vitet e fundit, rezulton se numri i rekomandimeve të lëna dhe numri i atyre të zbatuara vijnë në rënie; ndërsa rekomandimet e shprehura në vlerë mbeten në statusin “në proces”.

1.4 Nga auditimi mbi raportimin në NJAB/ Bashkia Dropull të subjekteve të audituara mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe përcjellë në Raportin Përfundimtar të Auditimit, rezultoi se nuk janë ndjekur hapat e monitorimit të tyre. Ndonëse, NJAB ka ushtruar dy misione audituese “për zbatimin e rekomandimeve të lëna në subjektet e audituara”, nuk justifikon mospërbushjen e detyrimit ligjor nga ana e subjekteve të audituara, në mos zbatim të përcaktimeve në kreun 4.1.13.1 dhe 2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit” paragrafi 3 dhe “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve” paragrafi 4, të “Manualit për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Përgjegjësi për mosraportim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga misioni auditues i NJAB, kanë edhe subjektet e audituara, në moszbatim të kreut 4.1.13.3 “Përgjegjësitë e njesisë për të zbatuar rekomandimet e auditimit të brendshëm”.

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull, të marrë masa për plotësimin e Njesisë së auditimit të brendshëm me auditues në përmbushje të kërkesave për hartimin e planeve strategjike e vjetorë nga NJAB, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin, VKM-ve dhe Manualeve, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave;

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Kryetari i Bashkisë dhe DBNJ po bëhen përpjekje për plotësimin e vendeve vakante në strukturës e NJAB, për një funksionim efektiv të saj.

Pra **Rekomandimi 12.1** është pranuar nga subjekti dhe *është zbatuar*.

12.2. Rekomandimi: Njësia e auditimit të brendshëm të bëjë një vlerësim real të koeficientit të riskut për fushat/sistemet objekt i misioneve audituese; të përfshijë në planet strategjike dhe vjetorë sektorët e fushave me risk, siç janë: zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, menaxhimi i burimeve njerëzore, sistemet e teknologjisë së informacionit të implementuar etj., duke respektuar raportin 60/40 mes sistemeve/fushave me koeficient të lartë risku ndaj atyre me koeficient të mesëm/ulët risku në hartimin e planeve strategjike e vjetor të njësisë.

Nga verifikimi rezultoi se: Planit strategjik dhe ai vjetor të miratuar nga NJAB, rezultoi me marrjen e masave për zbatimin e rekomandimit duke respektuar raportin 60/40 mes sistemeve/fushave me koeficient të lartë risku ndaj atyre me koeficient të mesëm/ulët risku në referim të vlerësimit real me koeficient risku të strukturave objekt auditimi. Pra **Rekomandimi 12.2** është pranuar nga subjekti dhe *është zbatuar*.

12.3. Rekomandimi: Njësia e auditimit të brendshëm, të ndjekë me korrektësi fazën e misionit auditues, pas dërgimit të raportit përfundimtar në subjektin e audituar; t'i kërkojë menaxherit të tij të reagojë në lidhje me rekomandimet e lëna dhe të raportojë periodikisht Njësinë e auditimit të brendshëm sipas afateve të përcaktuara në planin e veprimit.

- Drejtuesi i Njesisë së auditimit brendshëm duhet të krijojë dhe mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të rekomanduara për t'ia përcjellë menaxhimit, nëpërmjet raporteve informuese të dhëna mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, sipas Manualit të auditimit të brendshëm, i cili do të ndihmojë në hartimin e një plani strategjik e vjetor sa më efektiv për NJAB.

Nga verifikimi rezultoi se: Dokumentacioni dhe dosjet e subjekteve të audituara nga NJAB, rezultuan me marrjen e masave nga ana e saj për zbatimin e rekomandimit, duke patur komunikim të vazhdueshëm me subjektet, duke vënë në dispozicion brenda 30 ditëve planin e veprimit dhe raportimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor; Ka realizuar mision auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga vitet e kaluara dhe raportuar te Kryetari i bashkisë. Pra **Rekomandimi 12.3** është pranuar nga subjekti dhe *është zbatuar*.

13. Gjetje nga auditimi: Bashkia Dropull nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Për periudhën objekt auditimi nuk ka takime të dokumentuara të GMS, nuk janë hartuar dhe miratuar gjurmët standarde të auditimit, nuk ka hartuar Listën (hartën)/manualin e proceseve të punës, Rregullore të posaçme të konfliktit të interesit, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar edhe programe trajnimesh në njësinë vendore për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit; Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet, plane dhe raporte vjetore mbi problematikat e hasura dhe zgjidhjen që iu është dhënë gjatë veprimtarisë së njësisë publike; menaxhimi dhe mirëmbajtja e sistemeve dhe programeve IT, nuk bëhet sipas kërkesave dhe standardeve ligjore në fuqi dhe paraqet risk në komprometimin e të dhënave që këto sisteme ruajnë dhe administrojnë. Mosveprimet e mësipërme

janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, 20, 21, 22, nenin 32 të ligjit nr. 68/2017” Për financat e vetëqeverisjes. vendore”, urdhrin e Kryeministrit nr. 164 datë 05.10.2017.

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen nga menaxhimi dhe nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, të rritjes dhe forcimit të aktivitetit GMS, të koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut, të hartojë dhe të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, forcimin dhe standardizimin në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit, informimit dhe monitorimit në bashki.

Nga verifikimi rezultoi se: Në Bashkinë Dropull nga strukturat përgjegjëse janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit: kanë marrë pjesë në trajnimet e zhvilluara nga ASPA, janë zhvilluar takime të GMS, për mirëmbajtjen e sistemeve IT etj. Pra **Rekomandimi 13.1** është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në *proces zbatimi*.

13.2. Rekomandimi: GMS dhe Koordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe koordinatorit të riskut, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor për aktivitetet dhe çështjet që duhet të analizojë dhe grafikun e takimeve që do realizojë, për hartimin e raporteve vjetore, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie, për të arritur objektivat institucionale në shërbim të komunitetit.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga GMS/Bashkia Dropull janë marrë masat dhe janë hartuar dhe miratuar Plani vjetor dhe kalendari i takimeve të GMS, por i kufizuar vetëm për përgatitjen e PBA 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023 me nr. 39 prot., datë 10.01.2022; Raporti vjetor i analizës së aktivitetit të GMS për PBA 2023-2025 me nr. 114 prot., datë 20.01.2023; Pra **Rekomandimi 13.2** është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në *proces zbatimi*.

13.3. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues, Nëpunësi Zbatues dhe GMS të marrin masa për miratimin e një rregulloreje për menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e aktiveve afatgjata të njësisë nga dëmtimi dhe keqpërdorimi, në zbatim të akteve ligjore në fuqi.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Dropull ka hartuar dhe miratuar “Manualin e proceseve për menaxhimin e aktiveve vendore” me nr. 1926 prot., datë 29.12.2023. Pra **Rekomandimi 13.3** është pranuar nga subjekti dhe *është zbatuar*.

13.4. Rekomandimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme të marrë masa për të hartuar plane dhe programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë; të kontribuojë në krijimin e një strukture organizative sa më efektive, plotësimin me personel të saj, për të rritur efektivitetin e shërbimeve dhe funksioneve që i atribuon ligji në dobi të komunitetit.

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Burimeve Njerëzore mundëson njohjen e stafit me temat e trajnimeve që organizon ASPA dhe ofron për NJVQV. Stafi nga ana e vet bën përzgjedhjen e temave që i intereson për rritjen profesionale. Programe trajnimi nga strukturat e brendshme gjatë vitit 2023 nuk ka planifikuar. Pra **Rekomandimi 13.4** është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe *në proces zbatimi*.

14. Gjetje nga auditimi: Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga, shpërblime etj.), për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, u konstatua se:

1.1 Nga auditimi rezultoi se VKB nr. 62 datë 24.11.2020 dhe VKB nr. 2 datë 28.01.2021 nuk janë regjistruar në regjistrin e protokollit të bashkisë, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 9154 datë 6.11.2003 “Për Arkivat” nenet 23, 24; “Norma Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” neni 13 dhe neni 19 dhe Vendim nr. 4, datë 19.6.2017 për miratimin e “Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoriteteve publike të Republikës së Shqipërisë”.

1.2. Nga auditimi mbi hartimin dhe miratimin e strukturës organizative dhe organigramës në strukturën e Bashkisë Dropull, rezulton se njësitë përgjegjëse nuk kanë planifikuar pozicione me status “ekselent”, në mos zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 586 datë 30.08.2019; si dhe pozicione me statusin “Grup i veçantë” ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) kategori të ndryshme: persona me aftësi të kufizuar, jetimë, kryefamiljare, të komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptianë etj) si personel administrativ dhe jo vetëm, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar neni 5; Ligjin nr.93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligjin nr.15/2019 dt.13.03.2019 “ Për Nxitjen e Punësimit”.

1.3 Në Bashkinë Dropull për periudhën 2021-2022 informacioni i vënë në dispozicion nga sektori i burimeve njerëzore për punonjësit veçanërisht ata me kontratë të përkohshme (bashkë me njësitë administrative) rezultoi se në aktin e hartuar “për numrin e punonjësve të Bashkisë Dropull dhe nivelit të pagave të tyre” për tu miratuar në Këshillin Bashkiak, nuk është pasqyruar edhe numri i punonjësve me kontratë (me/pa afat apo të përkohshme) të planifikuar si dhe sektorët/drejtoritë që u nevojitet ky kontingjent, në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” neni 9 pika c, neni 54 pika dh, neni 64 pika j.

1.4.a Nga ana e Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse nuk janë bërë pjesë e Rregullores së Brendshme tek “Përshkrimet e Punës” kriteret e veçanta që duhet të plotësohen për çdo pozicion i strukturës organizative;

b Nuk ka pasqyruar numrin e të punësuarve që i nënshtrohen procedurave të Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar, në aktet e miratuara nga Këshilli Bashkiak për numrin e punonjësve dhe nivelin e pagave për vitin në vijim;

c Njoftimet për punësim me procedurën sipas Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar, janë bërë vetëm në stendat e bashkisë, dhe nuk janë publikuar në faqen zyrtare të bashkisë Dropull, nuk janë shpallur në portalin për punësim të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, nuk janë publikuar as në rrjetet sociale të Bashkisë Dropull, kjo në moszbatim të Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar, neni 19

1.5. Referuar Ligjit 152/2015 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi”, neni 7, pika 5 “Stacioni i shërbimit të MZSH-së është njësi operuese dhe inspektuese në varësi të shefit të sektorit të shërbimit të MZSH-së dhe ngrihet në çdo bashki, duke zbatuar standardin **1** zjarrfikës profesionist për **1500-2000** banorë”; pika 6 “Çdo stacion duhet të ketë jo më pak se **14** zjarrfikës, personel profesionist”, nga auditimi u konstatua se njësia e MZSH-së në Bashkinë Dropull, *nuk janë respektuar kriteret* përsa i përket numrit të personelit zjarrfikës profesionist, duke e tejkaluar me të punësuar me kontratë të përkohshme, paraqitur për miratim në Këshillin Bashkiak pa dhënë një relacion argumentues, pasi është një numër i konsiderueshëm të punësuarish sezonal për këtë sektor; nisur nga numri i banorëve, Bashkia Dropull hyn në kategorinë nga [20000-50000] banorë, duhet që njësia e MZSH-së në këtë bashki të ketë 15 zjarrfikës personel profesionist;

1.6. Nga auditimi i dosjeve të personelit në pozicionin “shofer”, rezultoi se për automjete me destinacion të veçantë, që duhet të përdoren nga drejtues që janë të pajisur me “leje drejtimi” dhe me “dëshmi aftësie profesionale” (sipas llojit të mjetit që ka në përdorim), punonjësit e punësuar

si drejtues mjete (shoferë), u konstatua se *nuk janë të gjithë të pajisur* me dokumentacionet justifikuese profesionale, në moszbatim të VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 200 datë 16.05.2019 “Për miratimin e Rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”;

1.7 Nga të dhënat e pasqyrës së pagave, rezultoi se fondi i pagave në Bashkinë Dropull për vitin 2021 zë 17.2% të buxhetit faktik dhe për vitin 2022 zë 20.5% të tij. Nga auditimi mbi planifikimin e fondit të pagave, u **konstatua** se: nuk ka fond për shpërblime mbi vlerësimin e performancës në punë të punonjësve me “Status të Nëpunësit civil”; gjithashtu për punonjësit me “kod pune” nuk zbatohet VKM nr. 68/2018 “Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore”;

1.8 Nga testimi me zgjedhje të dosjeve të personelit (kampioni që përzgjedhëm), emëruar/larguar në 2021-2022 rezultoi se përgjithësisht dosjet e personelit përmbanin dokumentacionin përkatës të dosjeve, por u konstatuan:

- Në *dosjet e personelit* mungonin: praktika e plotë e punësimit nga shpallja e pozicionit deri në emërimin e tij; vlerësimi 6 dhe 12 mujor; për pozicionet “shoferë” dhe punonjës A.Kuremenko dokumenti mbi formimin arsimor të tyre; formulari i vetdeklarimit; Kontratat e punës të paregjistruara në Protokollin e Bashkisë; Urdhri për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së punonjësit K.Gogoni duhet të përpilohej veçmas nga Urdhri për emërimin në punë të punonjësit J. Xha, ndonëse zëvendësuan njëri tjetrin;

- *Dosjet e punonjësve të larguar* nuk kishin praktikën e plotë të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga njoftimi deri në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, përfshirë dhe procesverbalin e dorëzimit të bazës materiale që ka patur punonjësi në ngarkim;

Për të gjitha këto konstatime, nuk janë zbatuar: Ligji nr. 152/2013 i ndryshuar “Për nëpunësin civil” neni 17 pika 1,4; VKM nr. 117, datë 5.3.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” Lidhja 1 e 2; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” Kreu VII, XIV.

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Burimeve njerëzore dhe e Shërbimeve të Brendshme, menaxherët e të gjitha njësive të strukturës në Bashkinë Dropull të kompozojnë dhe miratojnë një strukturë organizative, konform funksioneve që i atribuon ligji; të mundësohet trajtimi i punonjësve, të cilëve gjatë orarit zyrtar të punës nuk u janë përmbushur kërkesat e ambienteve për ngrënie me kushte higjienike të pranueshme, me qëllim motivimin e punonjësve në rritjen e efektivitetit të shërbimeve që bashkia i ofron komunitetit;

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Kryetari i bashkisë, DBNJSHM dhe GMS është kompozuar për vitin 2023 një strukturë organizative me pritshmëri funksionale dhe efektive; është planifikuar krijimi i një ambienti të brendshëm i cili do funksionojë për ngrënie nga punonjësit e bashkisë. Pra **Rekomandimi 14.1** është pranuar nga subjekti dhe *pjesërisht zbatuar*.

14.2. Rekomandimi: Drejtorja e Burimeve njerëzore dhe e Shërbimeve të Brendshme të marrë masa të regjistrojë çdo akt administrativ të miratuar konform akteve ligjore të arkivave; për hartimin e kriterëve specifike për pozicionet e veçanta në strukturë, të cilat kërkojnë arsimin profesional përkatës apo certifikatë profesionale; të shpallë në portalin e punësimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Dropull, vendet vakante

dhe për pozicionet me Kod pune; të caktojë në strukturën organizative pozicione për kategorinë “grup i veçantë”; plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin përkatës, për të rritur performancën e shërbimeve dhe arritjen e objektivave institucionale në dobi të komunitetit.

Nga verifikimi rezultoi se: Dokumentacioni i hartuar dhe miratuar nga DBNJSHM, është shoqëruar me plotësimin e formularit të përshkrimeve të punës me kriteret të veçanta sa më realiste, është bërë shpallja e pozicioneve të lira në portalin e punësimit të AKPA, plotësuar dosjet e personelit, janë punësuar persona (shtatë) me familjarë “të grupit të veçantë” etj, rezulton se nga ana e DBNJSHM janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Pra **Rekomandimi 14.2** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

15. Gjetje nga auditimi: Për sa më sipër në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, rikërkohet marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi dhe rekomandimet e pa zbatuara.

Bashkia Dropull ka detyrimin për zbatimin e tyre si më poshtë vijon:

a. Masa Organizative janë lënë **10** Rekomandime që janë pranuar nga subjekti, nga të cilat rikërkohen **3** masa të pazbatuara;

b. Masa për Uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore (të ardhurat e munguara) në bashkinë Dropull është lënë **1** rekomandim i cili rikërkohet si i zbatuar pjesërisht në vlerën e mbetur deri më 31.12.2022 prej **8,772,214** lekë për 1114 debitorë;

c. Masa shpërblim dëmi është lënë 1 masë (e rikërkuar) në vlerën 3,419,505 lekë dhe rikërkohet në vlerën e saj të plotë si e zbatuar pjesërisht (në proces gjyqësor);

Ligji nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 gërma j; Ligji nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”.

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 518/18 prot., datë 08.09.2022 si dhe Akt Verifikimit nr.1 të datës 23.03.2023, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre.

Nga sa më lart, Grupi i Auditimit të KLSH-së rikërkon si më poshtë vijon:

A. Masat Organizative

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Dropull, të marrë masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të plotë të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Nga verifikimi rezultoi se: Janë hartuar plane vjetore trajnimi, janë zhvilluar trajnime për njohjen nga ana e stafit me ligjin nr. 10296/2010 “Për MFK” dhe Manualin MFK; hartimi i regjistrit të riskut vetëm nga DBF miratuar me nr. 2345 prot., datë 17.12.2020; deri tani nuk është hartuar strategjia e riskut të njësisë. Pra Rekomandimi 15/1.1 është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

7.1. Rekomandim: Drejtoria e Buxhetit, Financës dhe Mbrojtjes Sociale në Bashkinë Dropull të kryejë veprimet e sistemimet kontabël për vlerat e detyrimeve që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit.

Nga verifikimi rezultoi se: Në Pasqyrat financiare të vitit 2023, janë bërë sistemimet kontabël përkatëse. Pra **Rekomandimi 15/7.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

4.1 Rekomandim (rikërkuar): Titullari i Bashkisë Dropull në bashkëpunim me sektorin e buxhetit dhe menaxhimin të Aseteve të marrë masa menjëherë për përmirësimin e gjendjes me parashtrim të problematikës në GMS bazuar në UMF nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar, Kreu (II), pika (16) dhe të ndërmarra të gjitha procedurat ligjore, të nisin procedurat për sigurimin e dokumentacionit vërtetues siç është titulli i pronësisë për pronat “Toka, Troje, Terrene, Pyje, Plantacione, Ndërtesa dhe Konstruksione për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve të bashkisë, me qëllim paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore bashkia Dropull më 31.12.2020.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Bashkia Dropull janë marrë masat për zbatimin e rekomandimit të lënë. (ky rekomandim është i njëjtë me **Rekomandimin 4.1** të Masa Organizative). Pra **Rekomandimi 15.1/4.1** është pranuar nga subjekti dhe proces zbatimi.

B. Masa shpërblim dëmi

11.1 Rekomandim (rikërkuar): Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Dropull të vazhdojë ndjekjen e të gjitha shkallëve të proceseve gjyqësore për arkëtimin e dëmit në vlerën **3,419,505 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria Juridike për arkëtimin e vlerës 3,419,505 lekë, ka ndjekur të gjitha shkallët e gjyqimit dhe momentalisht çështja është në Gjykatën e Apelit. Pra **Rekomandimi 11.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

C. Masa Për Uljen E Borxhit Tatimor Dhe Rritjen E Performancës Në Arkëtimin E Detyrimeve Për Taksat Dhe Tarifat Vendore, Përfshirë Dhe Detyrimet Nga Qiradhënia (Të Ardhura Të Munguara.

1.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore të marrë masa për të ndjekë të gjitha procedurat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës së detyrimeve deri më datën 31.12.2022 prej **8,772,214 lekë** për **1114** taksapaguese privat dhe familjarë.

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e të Ardhurave nga taksat e tarifat vendore, ka marrë të gjitha masat për uljen e detyrimit progresiv i cili në fund të vitit 2022 ishte në vlerën 8,772,214 lekë dhe u përkiste 1114 taksapaguesve privatë dhe familjarë. Situata paraqitet si në tabelë:

Debitorët	Numri i debitorëve	Vlera e debisë 2022	Numri që ka paguar	Vlera e paguar	Numri i mbetur i debitorëve	Vlera e mbetur nga debia e 2022
Familjarë	1,104	7,871,144	577	3,628,355	527	4,242,789
Biznes i Madh	7	855,887	3	176,026	4	649,026
Biznes i Vogël	3	45,183	1	11,315	2	33,868
Total	1,114	8,772,214	581	3,816,530	533	4,955,683

Nga tabela rezulton se gjatë vitit 2023, numri i debitorëve progresivë të fundit të vitit 2022 nga 1114 është ulur në 533, pasi 581 debitorë kanë paguar në vlerën 3,816,530 lekë. Vlera e debisë së mbetur në fund të vitit 2023 nga totali i vlerës progresive të vitit 2022 është 4,955,683 lekë. Pra **Rekomandimi 15.1/11.1** është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

B. Masa shpërblim dëmi.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “*Rikonstruksion i rrjeteve të brendshme të Ujësjellësit të fshatrave Zervat, Vanister, Haskove, Dhuvjan, Gorice, Frashtan, Lugar dhe Grapsh, Bashkia Dropull*”, me vlerë 247,136,960 lekë me TVSH, fituar nga JV “R. T.” SHPK & “Sh.” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punëve: “Zëri 1(3.46) Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krah, me seksion deri 0.75 m²”, “Zëri 3(2.47/An) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir” në vlerën **185,561 lekë pa TVSH**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 760 prot., datë 06.05.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Dropull dhe JV “R. T.” SHPK & “Sh.” SHPK.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **185,561 lekë pa TVSH** nga JV “R. T.” SHPK & “Sh.” shpk, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 760 prot., datë 06.05.2021, me objekt “*Rikonstruksion i rrjeteve të brendshme të Ujësjellësit të fshatrave Zervat, Vanister, Haskove, Dhuvjan, Gorice, Frashtan, Lugar dhe Grapsh, Bashkia Dropull*”.

Nga verifikimi rezultoi se: Me Urdhër zhblllokimi nr. 1794 prot., datë 04.12.2023 është njoftuar JV “R. T.” SHPK & “Sh.” shpk për detyrimin prej 185,561 lekë për punime të pakryera. Nga ana e tyre është njohur detyrimi dhe është dakortësuar verbalisht për likuidimin e tij në masë të plotë. Deri tani nga ana e OE nuk është bërë asnjë pagesë. Pra **Rekomandimi 1.1** është pranuar nga subjekti dhe është pjesërisht zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “*Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat*” Bashkia Dropull, me vlerë 142,830,639 lekë me TVSH, fituar nga OE “K.K.” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punëve: “Zëri 1(3.46) Gërmim kanalesh në tokë të fortë, me krah, me seksion deri 0.75 m²”, “Zëri 3(2.47/An) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir” në vlerën **313,500 lekë pa TVSH**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 793 prot., datë 11.05.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Dropull dhe OE “K.K.” SHPK.

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **313,500 lekë pa TVSH** nga shoqëria “K.K.” shpk, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 793 prot., datë 11.05.2021, me objekt “*Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat*” Bashkia Dropull.

Nga verifikimi rezultoi se: Me Urdhër zhblllokimi nr. 1795 prot., datë 04.12.2023 është njoftuar shoqëria “K.K.” shpk për detyrimin prej 313,500 lekë për punime të pakryera. Nga ana e tyre është njohur detyrimi dhe është dakortësuar verbalisht për likuidimin e tij në masë të plotë. Deri

tani nga ana e OE nuk është bërë asnjë pagesë. Pra **Rekomandimi 2.1** është pranuar nga subjekti dhe është pjesërisht zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Furnizimi me ujë nga pus shpimet i ujësjellësit rajonal Dropulli i Poshtëm dhe rrjeti shpërndarës të fshatrave Goranxi dhe Derviçan,” Bashkia Dropull, me vlerë 79,129,675 lekë me TVSH, fituar nga JV “E.” SHPK & “B.” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punëve: “Zëri 1(3.87/a) Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë e zakonshme, kategoria III, me shk. në tokë” dhe, “Zëri 2(47/an) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir” në vlerën **260,786 lekë pa TVSH**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1502 prot., datë 19.08.2020 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Dropull dhe JV “E.” SHPK & “B.” SHPK.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **260,786 lekë pa TVSH** nga JV “E.” SHPK & “B.” shpk, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 1502 prot., datë 19.08.2020, me objekt “Furnizimi me ujë nga pus shpimet i ujësjellësit rajonal Dropulli i Poshtëm dhe rrjeti shpërndarës të fshatrave Goranxi dhe Derviçan, Bashkia Dropull”.

Nga verifikimi rezultoi se: Me Urdhër zhbllokimi nr. 1796 prot., datë 04.12.2023 është njoftuar JV “E.” SHPK & “B.” shpk për detyrimin prej **260,786 lekë** për punime të pakryera. Nga ana e tyre është njohur detyrimi dhe është dakortësuar verbalisht për likuidimin e tij në masë të plotë. Deri tani nga ana e OE nuk është bërë asnjë pagesë. Pra **Rekomandimi 3.1** është pranuar nga subjekti dhe është pjesërisht zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ujësjellësi nga burimi i Manxifës & Rikonstruksion i ujësjellësit të fshatrave Selo, Llovinë, Krioner & Sotire, Faza II” Bashkia Dropull, me vlerë 393,039,116 lekë me TVSH, fituar nga JV “E.” SHPK & “B.” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërin e punëve: “Zëri 1(3.124/1a) Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zingjir” në vlerën **179,190 lekë pa TVSH**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 962 prot., datë 04.06.2020 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Dropull dhe JV “B.” & “2-T” & “V.H.” SHPK.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **179,190 lekë pa TVSH** nga JV “B.” & “2-T” & “V.H.” shpk, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 962 prot., datë 04.06.2020, me objekt “Ujësjellësi nga burimi i Manxifës & Rikonstruksion i ujësjellësit të fshatrave Selo, Llovinë, Krioner & Sotire, Faza II”.

Nga verifikimi rezultoi se: Me Urdhër zhbllokimi nr. 1797 prot., datë 04.12.2023 është njoftuar JV “B.” & “2-T” & “V.H.” shpk për detyrimin prej **179,190 lekë** për punime të pakryera. Nga ana e tyre është njohur detyrimi dhe është dakortësuar verbalisht për likuidimin e tij në masë të plotë. Deri tani nga ana e OE nuk është bërë asnjë pagesë. Pra **Rekomandimi 3.1** është pranuar nga subjekti dhe është pjesërisht zbatuar.

C. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efience dhe efektivitet të fondeve publike.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 5 procedurave me vlerë të lartë me fond limit 419,885 mijë lekë të vlerësuar për auditim për periudhën 01/01/2021 – 31/12/2022, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej 2 procedura me vlerë të fondit limit 269,281 mijë lekë ose 64% e vlerës së fondit limit të audituar, ku OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK. Në këto raste KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizues për rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë për një përdorim me efektiv të fondeve të prokuruar.

a- Procedura me objekt “Rikonstruksion Shkolla e Mesme e Bashkuar “Bularat”+kopesht Bularat,Dropull i Sipërm” zhvilluar në vitin 2022, me fond limit 58,648,181 lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 53,945,123 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “GJ.”.

b- Procedura me objekt “Rikonstruksioni i rrjeteve te brendshme te ujesjellësit te fshatrave Zervat ,Vanister,Haskov,Gorice,Frashtan,Lugar dhe Grapsh,Bashkia Dropull”, zhvilluar viti 2021, me fond limit 210,633,067 lekë dhe vlerë kontrate 206,313,149 lekë, ku fitues është shpallur JV “R.”, “T.” & “Sh.” & “V.K.” ShPK.

Në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i bashkisë Dropull, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Kryetari i Bashkisë nuk është ngritur grup pune i veçantë për të analizuar konstatimet e gjetura në rastet e OE të përmendur, por në takimet dhe analizat e zhvilluara i është kushtuar vëmendje e veçantë zbatimit të këtij rekomandimi. Rezultoi se nuk janë përcaktuar personat përgjegjës. Pra **Rekomandimi 1.1** është pranuar nga subjekti dhe nuk është zbatuar.

D. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

1. Gjetje nga auditimi: Në territorin e Bashkisë Dropull ushtrojnë aktivitet të tregtimit të hidrokarbureve, gjithsej 7 subjekte. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit (autorizime) dhe pagesat e tyre në zbatim të VKM-në nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 970, datë 2.12.2015, parashikohet se: “Pagesa për dhënie dhe përsëritjen e liçencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”... “10. Pagesa për dhënie dhe përsëritjen e liçencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë

veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera.”, rezulton se autorizimet nuk lëshoheshin për periudhën 5 vjeçare, por për periudha më të shkurtër nga një deri në 5 vite.

Për 7 subjekte që tregtojnë hidrokarbure, detyrimi sipas bashkisë është 4,800,000 lekë, nga e cila është likuajduar vlera 4,022,000 lekë, **duke mbetur pa likujdim vlera 778,000 lekë, si ardhur e munguar**, konkretisht: subjekti “B.P.” shpk në shumën **130,000 lekë**, subjekti “B.M.” shpk në shumën **384,000 lekë** dhe subjekti “A.” shpk në shumën **264,000 lekë**.

Në kundërshtim me VKM-në nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në nr. 970, datë 2.12.2015, parashikohet se: “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”... “10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera.

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave vendor të marrë masa për arkëtimin e vlerave të paarkëtuara nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve në shumën **788,000 lekë**, respektivisht: subjekti “B.P.” shpk në shumën **130,000 lekë**, subjekti “B.M.” shpk në shumën **384,000 lekë** dhe subjekti “A.” shpk në shumën **264,000 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e të ardhurave vendore ka marrë masat dhe me shkresën nr. 1338 prot., datë 18.09.2023 është njoftuar subjekti “B.M.” shpk për njohjen e detyrimit në shumën 384,000 lekë; me shkresën 1339 prot., datë 18.09.2023 është njoftuar subjekti “A.” për shumën 264,000 lekë; me shkresën nr. 1340 prot., datë 18.09.2023 është njoftuar subjekti “B.P.” për shumën 130,000 lekë. Me shkresën nr. 1459/2 prot., datë 11.10.2023 është dërguar Urdhër bllokimi llogarive bankare të këtyre subjekteve debitore, bankave të nivelit të dytë. Rezultoi se shuma totale prej 788,000 lekë është arkëtuar. Pra **Rekomandimi 2.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Dropull dhe nga auditimi u konstatua se, totali i debitorëve me 31.12.2022 është në vlerën **10,126,180 lekë**, nga të cilat: debitorë të abonentëve familjarë në shumën 7,871,121 lekë, debitorë subjekte juridik në shumën 855,888 lekë, debitorë subjekte fizik në shumën 45,183 lekë dhe kamatëvonesa nga moslikuidimin i detyrimeve në shumën 1,353,988 lekë.

Vlera prej **10,126,180 lekë**, përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Dropull.

Në totalin e detyrimeve, konstatohet se peshën kryesore e zënë detyrimet nga abonentët familjarë, të cilat janë 75.8% e totalit të detyrimit.

Për menaxhimin e taksave e tarifave vendore, Bashkia Dropull nuk kishte aktmarrëveshje me ND. Ujësjellës Kanalizime por me Zyrën e Postës Shqiptare.

Konstatohet se një pjesë e subjekteve të cilët dhe pse ushtrojnë aktivitet nga Drejtoria e të Ardhurave vendore çdo vit ju rigjenerohet njoftim detyrimi për vitin vijues, duke u lejuar që të ushtrojnë aktivitet pa bërë likuidimet e detyrimeve ndërvite. Gjithashtu dhe subjekte të cilët janë me status pasiv/ ose të mbyllur nuk kanë bërë të mundur likuidimin total të detyrimeve.

Në lidhje me masat e marra, konstatohet se në raport me vlerën e detyrimeve, nga bashkia janë marrë masa vetëm 3.4% e totalit të detyrimeve. Në krahasim me nivelin e detyrimeve në fund të

periudhës, konstatohet se procedura për zbatimin e masave shtrëngues nuk është e plotë dhe në përputhje me kuadrin ligjorë në fuqi, ku një pjesë e masave nuk është zbatuar. Mungon bashkëpunimi me DSHTRR, Drejtorinë ASHK Dega Gjirokastrë, bllokim aktivitet, sekuestrim etj.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2018 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, respektivisht nenet:

-Nuk gjen zbatim neni 89-Njoftimi dhe kërkesa për pagim të detyrimeve;

-Nenet 90-Urdhër bllokimet dhe 92-Masa për sigurimin e detyrimit tatimor, nuk janë bërë për të gjithë subjektet debitorë, duke lënë jashtë një pjesë të konsiderueshme të tyre, por dhe subjekte me detyrime nga viti në vit;

-Neni 93-Sekuestro dhe konfiskim i pasurisë dhe neni 94-Urdhër sekuestrimi, nuk gjen zbatim në asnjë moment, duke parë që një pjesë e subjekteve janë debitorë nga njëra periudhë në tjetër;

-Për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, nuk është kërkuar nga DTTV që për të gjithë subjektet të cilat janë njoftuar për pagesën e detyrimeve dhe zbatuar një pjesë e procedurave të kërkohej *kallëzim penal*, bazuar në nenin 181-Mos pagimi i taksave dhe tatimeve, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Sektorin Juridik dhe Policinë Bashkiake Bashkia Dropull, të marrin masa, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën **10,126,180 lekë**.

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e të ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Sektorin Juridik dhe Policinë Bashkiake, janë marrë masat si vijon: Me shkresën nr. 1333 prot., datë 18.9.2023 ka rinjoftuar të gjithë subjektet familjare debitorë për shlyerjen e detyrimeve; Me shkresën nr. 1341 prot., datë 18.9.2023 ka rinjoftuar të gjithë subjektet fizik/juridik debitorë për shlyerjen e detyrimeve; Me shkresën nr. 1358 prot., datë 26.9.2023 ka rinjoftuar të gjithë subjektet fizik/juridike debitorë për shlyerjen e detyrimeve; Me shkresën nr. 1459 prot., datë 11.10.2023 urdhër bllokimi llogaritë bankare të subjekteve debitorë.

Debitorët	Numri i debitorëve	Vlera e debisë 2022	Numri që ka paguar	Vlera e paguar	Numri i mbetur i debitorëve	Vlera e mbetur nga debia e 2022
Familjarë	1,104	7,871,144	577	3,628,355	527	4,242,789
Biznes i Madh	7	855,887	3	176,026	4	649,026
Biznes i Vogël	3	45,183	1	11,315	2	33,868
Nëntotali	1,114	8,772,214	581	3,816,530	533	4,955,683
Gjoha		1,353,985		518,150		835,835
Totali		10,126,199		4,334,680		5,791,518

Nga informacioni i pasqyruar në tabelë, rezulton se vlera e debisë bashkë me gjobat është në fund të vitit 2022 në shumën 10,126,199 lekë; debitorët kanë paguar nga ky detyrim shumën 4,334,680 lekë dhe detyrimi progresiv i vitit 2022 ka mbetur në vlerën 5,791,518 lekë. Pra **Rekomandimi 3.1** është pranuar nga subjekti, zbatuar pjesërisht dhe *në proces zbatimi*.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Sektori i Pyjeve dhe kullotave, rezulton se në Bashkinë Dropull operojnë me kontratë dy shoqëri të telefonisë celulare, konkretisht shoqëria “T.A.” për periudhën 2.3.2019 – 2.3.2028 për vlerën 100,000 lekë/viti, e likuiduar sipas mandate arkëtimeve dhe kontrata me shoqëria “V.A.” për periudhën 5 vjeçare nga 21.11.2017 deri me 21.11.2012 për vlerën 450,000 lekë/viti.

Nga të dhënat, për periudhën 22.11.2021 deri me 22.11.2022 nga shoqëria “V.A.” është likujduar vlera 361,250 lekë, **duke mbetur për diferencë vlera 88,750 lekë, si ardhur munguar në buxhet.**

Gjithashtu, konstatohet se në kontrata e nënshkruara:

-Nuk është përcaktuar nr. Parcelës, vendi ku ndodhet dhe kufizimet.

-Nuk është llogaritur qira per përdorim rruge per lidhjen e sipërfaqes se dhënë ne përdorim me rrjetin rrugor, për të cilën duhet të bëhet verifikimi i gjatësisë se rrugës, te llogaritet vlera e qirasë. Veprime në kundërshtim me VKM nr.1064, datë 22.12.2010 “Per disa ndryshime ne Vendimin nr.391, datë 21.06.2006 te KM “Per përcaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe te kullotave”, i ndryshuar, si dhe kushteve të zbatimit të kontratës.

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë (*Sektori i Pyjeve*), të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **88,750 lekë** ndaj subjektit “**V.A.**”, si e ardhur e munguar.

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me pagesën e tatimit në burim nga V.A. për kontratën e lidhur mes saj dhe Bashkisë Dropull për “Site 254 Policani” datë 22.11.2017, nëpërmjet shkresës nr. 29/DF/FZ prot., datë 17.10.2023, është vënë në dijeni Bashkia Dropull për pagesën e bërë nga ana e saj, në vlerën 63,750 lekë. Vlera e kontratës së nënshkruar është në shumën 425,000 lekë dhe vlera e tatimit në burim (15%) është në shumën 63,750 lekë. (vlera 88,750 lekë është lapsus). Pra **Rekomandimi 4.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë (*Sektori i Pyjeve*), për të gjitha rastet e mos likujdimet në afat ë detyrimeve kontraktuale, në zbatim të nenit 5 të kontratës të llogariten kamatëvonesat në masën 0.01% për çdo ditë vonesë nga momenti i pagesës dhe në rast refuzimi të shlyerjes të kërkohet prishja e kontratës për mos zbatim të kushteve.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Bashkia Dropull, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Bujqësisë janë marrë masat që për çdo kontratë nuk bëhet miratimi pa bërë pagesën paraprakisht. (konkretizuar me shpjegimin dhe tabelën e **Rekomandimit 4.1** te Masa Organizative). Pra **Rekomandimi 4.2** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

4.3. Rekomandimi: Drejtoria e Bujqësisë (*Sektori i Pyjeve*), të marrë masa që në fazën e hartimit të kontratave të reja bashkëlidhur të jetë dhe nr. parcelës ku ndodhet dhe kufizimet. Gjithashtu për kontratat e vijim të evidentohet dhe llogaritet detyrimi i qirasë për rrugën në përdorim dhe arkëtimin e detyrimit.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Bashkia Dropull, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Bujqësisë janë marrë masat që në çdo kontratë të specifikohen: nr. i parcelës me kufizimet si dhe nuk bëhet miratimi pa u bërë pagesa paraprakisht nga pala qiramarrëse.(konkretizuar me shpjegimin dhe tabelën e **Rekomandimit 4.1** te Masa Organizative). Pra **Rekomandimi 4.3** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

E. Masa disiplinore.

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja i rekomandojmë **Kryetarit të Bashkisë Dropull**, për fillimin ose jo të procedurave për masë disiplinore, në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 152/2013 “Për Nënpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05/03/2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin

Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale për **14 punonjës**, *respektivisht*:

1. **Z. A.T.** me detyrë drejtor DPZHKT bashkia Dropull.
3. **Z. L. K.** me detyrë përgjegjës i DPZHKT bashkia Dropull.
4. **Z. S. E.** me detyrë specialist i DPZHKT bashkia Dropull.
5. **Z. Ll.N.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të pyjeve, livadheve dhe kullotave.
6. **Z. K. M.** me detyrë Specialist i Bujqësisë për tokat.
7. **Z. L. N.** me detyrë Specialist për administrimin e kullotave/livadhe.
8. **Zj. M. Q.** me detyrë Juriste Drejtoria e Buxhet financës.
9. **Z. A.T.** me detyrë Drejtor PZHT.
10. **Z. S. E.** me detyrë specialist (ing. Elektrik) Drejtoria e Shërbimit Urban.
11. **Znj. Th.P.** me detyrë Drejtor Finance.
12. **Z. L. K.** me detyrë specialist në Drejtorinë e PZHT.
13. **Zj. A. M.** me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.
14. **Z. G. M.** me detyrë Specialist tek ND. Ujësjiellës Dropull.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e Titullarit të Bashkisë Dropull ky rekomandim nuk është pranuar dhe rrjedhimisht nuk është zbatuar. Pra **Rekomandimi** për kategorinë E “masa disiplinore” lënë për 14 punonjës të bashkisë, *nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar.*

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Dropull nuk ka hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për implementimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm sipas komponentëve të MFK. Për periudhën objekt auditimi rezultoi se: nuk ka hartuar PPV dhe SZHV, nuk ka përditësuar Rregulloren e Brendshme sipas strukturës organizative të miratuar, nuk ka planifikuar dhe zhvilluar programe trajnimit për stafin me qëllim përmirësimin cilësor të komunikimit dhe profesionalizmit, nuk ka hartuar regjistrin e unifikuar dhe strategjinë e riskut, gjurmët standarde të auditimit; nuk ka takime të dokumentuara të GMS, plane dhe raporte vjetore mbi problematikat e hasura dhe zgjidhjen që iu është dhënë gjatë veprimtarisë së njësisë publike duke zbehur rolin e tij për arritjen e objektivave të njësisë publike; nuk ka hartuar Listën (hartën)/manualin e proceseve të punës; mos implementim të sistemeve dhe programeve IT të avancuara veçanërisht në procesin e vjeljes së të ardhurave vendore dhe mirëmbajtjen e atyre ekzistuese për të minimizuar riskun e komprometimit të të dhënave që këto sisteme ruajnë dhe administrojnë; plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacion të përditësuar. Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Manualin e MFK, Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes. vendore”, Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe Ligjin nr. 7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” etj. (*Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 1, faqe 18-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Dropull të marrë masat për të hartuar një kuadër të plotë rregullash

të shkruara për implementimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm sipas komponentëve të MFK; duke përditësuar Rregulloren e Brendshme sipas strukturës organizative të miratuar, duke planifikuar dhe zhvilluar programe trajnimi për stafin me qëllim përmirësimin cilësor të komunikimit dhe profesionalizmit; implementim e sistemeve dhe programeve IT të avancuara në procesin e vjeljes së të ardhurave vendore.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, mbi vlerësimin e aktivitetit të Njesisë së auditimit të brendshëm në Bashkinë Dropull u konstatua se:

- Bashkia Dropull ka krijuar Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm [DAB] që e ushtron funksionin e vet me tre auditues në Strukturën e saj organizative (1 drejtor+1përgjegjës+1 auditues), me dy vende vakante, në kundërshtim me ligjin nr.114/2015 “Mbi Auditimin e Brendshëm”, “Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.100/2016, pika 3, 6 në VKM nr. 83 dt. 03.02.2016 “Për Miratimin e Kriteve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” i ndryshuar, si dhe Vendimeve të Kryetarit të Bashkisë Dropull “Për miratimin e Strukturës Organizative” për vitin 2023.

- Nga auditimi mbi rekomandimet e lëna nga NJAB në misionet audituese të realizuara në 2 vitet e fundit 2022 dhe 2023, rezulton se numri i rekomandimeve të lëna dhe numri i atyre të zbatuara vijnë në rritje; por rezulton se për vitin 2023 ka dhe rekomandime të pazbatuara.

- Nga Kryetari i Bashkisë dhe GMS nuk është zhvilluar një analizë mbi arsyet e moszbatimit të rekomandimeve të NJAB nga ana e strukturave përgjegjëse, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e situatës dhe arritjen e objektivave të njesisë.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 1, faqe 17-47, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë masat për plotësimin e strukturës së NJAB konform kuadrit ligjor në fuqi, për të mos cenuar efektivitetin e aktivitetit të saj për periudhën në vijim.

2.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë dhe GMS të analizojnë çdo rekomandim të lënë nga NJAB strukturave të audituara dhe veçanërisht rekomandimet me status “pa zbatuar”, duke nxjerrë arsyet dhe personat përgjegjës me qëllim përmirësimin cilësor të proceseve të punës për arritjen e objektivave institucionale.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Mbi planifikimin e PBA-ve dhe Planeve vjetore me programe buxhetore sipas prioriteteve vendore dhe institucionale u konstatua se:

- Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelat e funksioneve të bashkisë dhe programeve buxhetore të caktuara në udhëzimet e MFE, rezultoi se: fondet buxhetor për “policinë vendore” nuk janë përfshirë në programin përkatës 03140 –“shërbimet e policisë vendore”, fondet për drejtorinë e shërbimit urban dhe e shërbimeve publike ku përfshihet dhe IMTV nuk janë përfshirë në programin përkatës 06140 – “Planifikimi urban vendor”, në moszbatim të Udhëzimit nr. 7 datë 25.05.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” shtojca 1;

- Nga Bashkia Dropull, PBA 2023-2025 dhe Plani vjetor i buxhetit 2023 janë miratuar së bashku, duke mos miratuar veçmas Planin Vjetor 2023, në moszbatim të kërkesave ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 29;

- Bashkia Dropull nuk ka treguar vëmendjen e duhur në planifikimin me një vlerë të konsiderueshme fondesh duke mos i kushtuar rëndësi programit **042** “Bujqësia, pyjet, peshkimi

dhe gjuetia” në moszbatim të Ligjit nr. 9385/2005 “Për pyjet dhe kullotat” i ndryshuar me Ligjin nr. 57/2020 neni 23 pika 3,5 dhe neni 34 pika 2; programeve **052** “Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve”, **056** “Ndërgjegjësimi mjedisor”, si dhe programe që lidhen ngushtë me **051** “Menaxhimi i mbetjeve”; **072/2** “Shërbimi shëndetësor”, **036** “Marrëdhëniet në komunitet”, **041** “Mbështetje për zhvillim ekonomik-Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi” etj., të cilat nuk janë vlerësuar si programe prioritet nga bashkia Dropull. Kështu mungesa e planifikimit të fondeve apo planifikim në rënie i fondeve nga ana e bashkisë, tregon për një shërbim ku është cënuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj që i ofron komunitetit, të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 23-30.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqe 46-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Kryetari i bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik me Koordinatorin e MFK, Koordinatorin e Riskut dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që me hartimin e PBA-së dhe Planit vjetor të buxhetit, të miratojnë në Këshillin Bashkiak veçmas Planin vjetor të buxhetit; duke i kushtuar vëmendje planifikimit në buxhet të fondeve për ato programe që kanë të bëjnë kryesisht me ndërgjegjësimin mjedisor, shërbimin shëndetësor, tregjet, shërbimin urban, dhe rritjes e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të pyllëzuara.

Brenda vitit 2024 dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e të dhënave të buxhetit rezulton se ka diferenca të dukshme midis treguesve në hartimin e planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta në vlerën 108,507.5 mijë lekë dhe shpenzimeve të tyre në vlerën 84,362 mijë lekë. Kështu nga të ardhurat veta të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2022 dhe 2023 të ketë mosrealizime, ndonëse vlera e të cilit vjen me trend në rënie nga 61.2% në vitin 2022 në 84.7% në vitin 2023.

- Me VKB nr. 73 datë 21.12.2021 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm” rezultoi se në buxhetin vjetor të vitit 2023, nuk është planifikuar Fondi Rezervë dhe Fondi i Kontigjencës, në kundërshtim me ligjin nr. 9936/2008 “Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” ku përcaktohet se këto fonde llogariten deri në masën 3% të buxhetit pa transfertat e kushtëzuara;

- Nga auditimi rezultoi se në vitin 2023 janë nisur 13 projekte me burim nga të ardhurat e bashkisë në vlerën totale 145,052 mijë lekë; dhe 6 projekte me burim nga granti në vlerën totale 413,138 mijë lekë. Vetëm për vitin 2023 vlera e planifikuar në buxhet për këto investime është 72,113 mijë lekë nga 145,052 mijë lekë të vlerës totale të tyre. Nga analiza e treguesve të tabelës së të ardhurave të veta, rezulton se diferenca mes realizimit faktik të të ardhurave të veta ndaj planifikimit ka trend në rritje si edhe realizimi i të ardhurave të veta; Kjo ka sjellë që në vitin 2023 “Investimet” kundrejt planifikimit të kenë një mosrealizim prej (-)7,819.4 mijë lekë dhe kundrejt faktit të vitit 2022 të jenë prej (-)33,339.2 mijë lekë.

Ky konstatim sipas grupit të KLSH-së, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave të ardhurat për asnjë nga vitet (2022 dhe 2023) nuk janë realizuar, veprime këto që bien ndesh me Ligjin nr. 67 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 36, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre në vitet paraardhëse.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqe 46-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për

realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve sipas programeve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në PBA 2023-2025/Planit vjetor 2023, referuar edhe tabelës së programeve buxhetore të planifikuara, u konstatua se fondi për detyrimet e prapambetura nuk është planifikuar veçmas në programin 04960 “*planifikim për detyrimet e prapambetura*”, por është përllogaritur i përfshirë në fondin e secilit program që mbart detyrime. Mos ndarja e fondeve sipas programeve përkatëse pra sipas destinacionit të përdorimit, ka sjellë likuidimin pjesor apo të plotë të detyrimeve të prapambetura (sipas rastit) dhe pamundësi likuiditeti të të gjitha faturave për “*mallrave e shërbime*” e “*investimeve*” brenda afatit 60 ditor për mungesë fondesh, duke riskuar për lindjen e detyrimeve të reja. Rezultoi se vlera e detyrimeve të prapambetura sipas bilancit përputhet me atë të raportuar në MFE. Në gjykimin e grupit të auditimit planifikimi i fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në programin përkatës 04960, do të rezultonte me një menaxhim më me efektivitet të fondeve për çdo program të buxhetor, në rast se nuk do të ishin reduktuar numri i programeve buxhetore nga MFE nëpërmjet udhëzimeve përkatëse: Udhëzimit nr. 23 datë 30.07.2018, Udhëzimit nr. 7 datë 25.02.2022 etj.

- Bashkia Dropull është debitorë për “*investime*” ndaj një subjekti në vlerën 821,710 lekë, për 1 faturë të muajit tetor të vitit 2023 në tejkallim të afatit 60 ditor dhe e padeklaruar si detyrim i prapambetur.

- Bashkia Dropull është debitorë nga OSHEE tani FSHU për “*shërbime*” në vlerën debitorë progresive 4,480,059 lekë, pagesë e cila bëhet me këste sipas akt marrëveshjes së lidhur mes palëve.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqe 46-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik me Koordinatorin e riskut dhe Drejtoria e Financës dhe buxhetit, të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrin të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjeve të detyrimeve të reja dhe monitorimit të zbatimit të kontratave për investime/shërbime/mallra; për të paguar rregullisht këstet sipas akt marrëveshjes së lidhur me ish –OSHEE (tani FSHU) për likuidimin e plotë të detyrimit prej 4,480,059 lekë deri në fund të vitit 2024; për likuidimin e faturave për mallra/shërbime/investime duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi për likuidimin e tyre në afat dhe sipas radhës, për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim parandalimin e lindjes së detyrimeve të prapambetura dhe deklarimin e vlerës së saktë të tyre në MFE.

5.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe buxhetit të bëjë planifikim sa më realist të fondeve të çdo programi në PBA dhe Planin vjetor buxhetor, si për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi për likuidimin e tyre brenda afatit të përcaktuar dhe sipas radhës, por edhe për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit ushtrimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se Drejtoria e të AV Bashkia Dropull informacionin tatimor e përpunon në paketën Microsoft Office 2013 - programi *excel*. U konstatua se mungesa e një sistemi IT bashkëkohor vetëm për të ardhurat vendore, sjellë vështirësi në administrimin e informacionit tatimor nga ana e DAV, për të gjitha subjektet tatimpaguese të biznesit të vogël

edhe të biznesit të madh, klasifikimi sipas kategorisë së detyrimit, interesat, regjistrimin e gjobave dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit etj.;

- Për *Taksa e kalimit e të drejtës në pronësi* referuar paketës fiskale, rezulton se për dy vitet e njëpasnjëshme 2022 e 2023 nuk është parashikuar vlerë, për shkak të mungesës së bashkëpunimit me ASHK Rajonale Gjirokastrë. Drejtoria e të Ardhurave Vendore rakordimet i bën nëpërmjet Degës së Thesarit Gjirokastrë;

- Në Rregulloren e brendshme të institucionit të miratuar, nuk është caktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga Agjentët Tatimorë dhe mbajtjen e akt-rakordimeve, si dhe krijimin e një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët; U konstatua se deri në 31.12.2023 rakordimet me ASHK Vendore Gjirokastrë për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme dhe me DRSHTRR për mjetet e regjistruara nuk janë kryer sipas formateve të miratuara nga MFE, veprime të cilat nuk janë në përputhje me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqe 46-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë dhe DAV/Bashkia Dropull të marrin masat për implementimin e programeve kompjuterike si pjesë e rëndësishme infrastrukurore, për miradministrimin e informacionit tatimor dhe për të maksimizuar vjeljen e taksave; kjo duke krijuar një regjistër elektronik që të përmbajë gjithë të dhënat e tatimpaguesve, me të gjitha detyrimet të klasifikuara sipas kategorisë së detyrimit, kohës së krijimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit, për një menaxhim në kohë reale të informacionit.

6.2. Rekomandimi: Drejtoria e Ardhurave vendore Bashkia Dropull të marrë masat për të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimor sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Dropull nga taksat që mbledhen nga këta agjentë. Në rast se agjentët tatimor nuk realizojnë saktë mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Dropull të fillojë procedurat për penalizimin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, nga 193 objekte inventari të pasurive të paluajtshme me kosto historike që i përkasin llog. 210 “Toka troje terrene”, llog. 211 “Pyje plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në vlerën 1,389,414,563 lekë, Bashkia Dropull nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35. Veprime këto të cilat nuk janë në përputhje me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 3, faqe 97-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull, Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masat e duhura për regjistrimin e **193 objekteve** të pasurive të paluajtshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, me qëllim dokumentimin me akte pronësie të aktiveve kapitale në pasqyrat financiare të Njesisë.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, Bashkia Dropull nuk ka marrë masat e duhura për ngritjen e komisioneve përkatës për verifikimin dhe vlerësimin e zërit troje, ndërtesa, pyje e kullota për Bashkia Dropull dhe njësitë në varësi. Për këto aktive nuk është kryer asnjëherë inventar fizik në lidhje me to, për të cilat nuk mund të gjykohet nëse vlera e pasqyruar në kontabilitet, është fizikisht apo jo e disponueshme dhe e përdorshme nga institucioni çka do të thotë se nuk mund të verifikohet dhe vlerësohet dokumentacioni mbështetës i tyre. E njëjta situatë konstatohet edhe në Njësitë Administrative në varësi të Bashkisë Dropull pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se nuk është kryer inventarizim për zërat e mësipërm të bilancit. Referuar procesit të inventarizimit të kryer për vitin 2023, u konstatua se verifikimi është kryer vetëm për aktivet e llog. 218 “*Inventar ekonomik*” dhe për llog. 32 “*Inventar i imët*”. Pra nuk janë ngritur komisione për kryerjen e verifikimeve të aktiveve për llogarinë 210 “*Toka, troje, terrene*” dhe, për llog 211 “*Pyje, kullota, plantacione*”.

Veprime këto të cilat nuk janë në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08/07/2010, “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, i ndryshuar, neni 9 dhe 12, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, kreu IV, pika 74.

-Bashkia Dropull nuk ka marrë masat e duhura për të reflektuar në pasqyrat financiare në llogarinë përkatëse në total **25,311 Ha (hektarë)**, nga të cilat **10,641 Ha** të sipërfaqeve të pyjeve, **14,911 Ha** të sipërfaqeve të kullotave, **28.1 Ha** Tokë joproductive dhe **30 Ha** shkëmbore e ujore, të kaluara në favor të saj sipas VKM Nr. 433 dt. 08.06.2016 “*Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive*”, 34 shtojca 32, e ndryshuar. Kjo sjell rrjedhimisht mos pasqyrim të saktë dhe të drejtë të llogarisë 211, llog. 213, në mbyllje të Pasqyrave financiare të vitit 2023.

Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “*Për një ndryshim në Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar pika 2.1.

(*Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 3, faqe 97-118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, të kryhej analizat e situatës së aktiveve të Njësisë, të vlerësohen këto asete, të plotësohen me dokumentacion pronësor, si dhe të kryhen reflektimet përkatëse në pasqyrat financiare, me qëllim vlerësimin e pronës dhe identifikimin e saj. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masat e duhura për evidencimin e sipërfaqeve të pyjeve e kullotave të kaluara në administrim të Bashkisë Dropull me VKM përkatëse, edhe nëse ato janë të pa vlerësuara, të evidentohen në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Me mbylljen e PF të vitit 2024

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur, rezultoi si më poshtë:

KLSH ka dërguar në Bashkinë Dropull rekomandimet e auditimit të fundit me shkresën nr. 424/prot, datë 31.08.2023. Bashkia Dropull për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1348 prot, datë 15.09.2023 dhe ka hartuar planin e veprimit duke respektuar afatin ligjor prej 20 ditësh.

Gjithashtu, nga Bashkia Dropull është raportuar brenda afatit të 6 muajve, me shkresën nr. 272 prot, datë 20.02.2024. Me urdhër nr. 254, datë 10.10.2023 të Kryetarit të Bashkisë Dropull është

hartuar plani i punës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-Së, duke ngarkuar me përgjegjësi drejtoritë përkatëse. Bashkia Dropull nuk **ka raportuar në** Këshillin Bashkiak, bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm.

Nga auditimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve, rezulton si më poshtë:

g. Masa për përmirësimin e Legjislacionit në fuqi nuk është lënë masë;

h. Masa Organizative janë lënë **22**, dhe janë pranuar **22** masa: 12 masa janë zbatuar, 7 masa janë në proces zbatimi; 3 masa janë pjesërisht zbatuar dhe **0** masa pa zbatuar;

Nga auditimi i mëparshëm janë rikërkuar **3** masa organizative të cilat kanë rezultuar të pranuar nga subjekti; nga të cilat 1 masë është zbatuar; **2** masa janë në proces zbatimi;

Në total Masa organizative janë lënë **25** masa: 13 masa janë zbatuar, **3 masa janë pjesërisht zbatuar; 9 masa janë në proces zbatimi.**

i. Masa për shpërblim dëmi janë lënë **4** masa në vlerën 939,037 lekë të cilat janë pranuar: **4** masa po në vlerën 939,037 lekë dhe janë pjesërisht zbatuar;

Nga auditimi i mëparshëm është rikërkuar **1** masë në vlerën totale 3,419,505 lekë dhe pranuar nga subjekti e cila rezulton e zbatuar.

Në total Masa shpërblim dëmi janë lënë **5** masa në vlerën totale 4,358,542 lekë: 1 masë në vlerën 3,419,505 lekë zbatuar dhe **4 masa në vlerën 939,037 lekë janë pjesërisht zbatuar.**

j. Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, TNI, etj. (të ardhura të munguara) në bashkinë Dropull janë lënë **5** masa në vlerën totale 11,002,930 lekë nga të cilat: 4 masa janë zbatuar dhe 1 masë është në proces zbatimi;

Nga auditimi i mëparshëm është lënë 1 masë në vlerën totale 8,772,214 lekë dhe i përkasin 1114 taksapaguesve e cila rezulton në proces;

Në total janë lënë **6** masa: 4 masa janë zbatuar dhe 2 masa janë në proces zbatimi.;

k. Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, është lënë **1** masë nga auditimi i mëparshëm (rikërkuar) e cila është pranuar nga subjekti dhe rezulton e pazbatuar.

Masa disiplinore janë lënë për **14** punonjës, e cila rezulton e papranuar nga Kryetari i Bashkisë (*Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 4, faqe 118-148, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju **rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

A. Masa organizative.

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dropull në bashkëpunim me Sektorin e Buxhetit dhe Menaxhimit të Asteve të marrë masa të menjëhershme për përmirësimin e gjendjes me parashtrimin të problematikës në GMS.

- Të ndërmarrë dhe nisë të gjitha procedurat për sigurimin e dokumentacionit vërtetues siç është titull pronësie për pronat; “toka, troje, terrene, pyje, plantacione. Ndërtesa dhe konstruksione”, për vlerësim e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve të bashkisë me qëllim paraqitje e vlerës së këtyre aktiveve në pasqyrat financiar të njësisë publike vendore.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Dropull, të marrë masa për:

- Të mos pranuar preventiv fiktiv nga ana e projektuesit duke kontrolluar zërat e punës dhe llogaritur preventivin jo më pak se kostoja e ndërtimit

- Të respektuar distancat e lejuara nga kufiri i pronës.

- Të miratuar leje ndërtimi me mendimet pozitive të aprovuara nga institucionet e nevojshme për të dhënë këtë mendim

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve njerëzore dhe e Shërbimeve të Brendshme, menaxherët e të gjitha njësive të strukturës në Bashkinë Dropull të kompozojnë dhe miratojnë një strukturë organizative, konform funksioneve që i atribuon ligji; të mundësohet trajtimi i punonjësve, të cilëve gjatë orarit zyrtar të punës nuk iu janë përmbushur kërkesat e ambienteve për ngrënie me kushte higjienike të pranueshme, me qëllim motivimin e punonjësve në rritjen e efektivitetit të shërbimeve që bashkia i ofron komunitetit;

B. Masa shpërblim demi.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **185,561** lekë pa TVSH nga JV "R.T." & "Sh." ShPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 760 prot., datë 06.05.2021, me objekt "Rikonstruksion i rrjeteve të brendshme të Ujësjellësit të fshatrave Zervat, Vanister, Haskove, Dhuvjan, Gorice, Frashtan, Lugar dhe Grapsh, Bashkia Dropull".

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **313,500** lekë pa TVSH nga shoqëria "K.K." ShPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 793 prot., datë 11.05.2021, me objekt "Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Derviçan, Sofratik dhe Terihat" Bashkia Dropull.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **260,786** lekë pa TVSH nga JV "E." & "B." ShPK, për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 1502 prot., datë 19.08.2020, me objekt "Furnizimi me ujë nga pus shpimet i ujësjellësit rajonal Dropulli i Poshtëm dhe rrjeti shpërndarës të fshatrave Goranxi dhe Derviçan, Bashkia Dropull".

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financë Buxhet në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masat, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **179,190** lekë pa TVSH nga JV "B." & "2-T" & "V. H." ShPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 962 prot., datë 04.06.2020, me objekt "Ujësjellësi nga burimi i Manxifës & Rikonstruksion i ujësjellësit të fshatrave Selo, Llovinë, Krioner & Sotire, Faza II".

C. Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i bashkisë Dropull, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Menjëherë

B. MASA PËR ULJEN E DETYRIMEVE TATIMOR PËR RRIUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi:

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi vlerën e detyrimeve debitorë nga subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjarë më 31.12.2023, rezulton se është në vlerën 7,908,626 lekë, nga e cila: për

subjekte fizik/juridik për 14 subjekte me vlerë 1,084,776 lekë, ku në krahasim me fundin e vitit 2022 kemi një shtesë për 4 subjekte me vlerë 183,706 lekë dhe nga debitorë abonentë familja për vlerën 6,823,850 lekë për 947 familje, ku në krahasim me vitin 2022 paraqitet në ulje për vlerën 4,047,294 lekë për 157 familje.

Sipas të dhënave të kontabilitet, këto vlera rezultojnë të pasqyruara në kontabilitet dhe pasqyrat financiare viti 2023, pra janë detyrime të cilat bashkia i njeh, por që nuk ka mundur arkëtimin e tyre sipas afateve dhe brenda vitit ushtrimorë megjithëse punën e bërë.

- Nga ana e Drejtoria e Administrimit të Ujërave, Pyjeve, Livadheve dhe Kullotave [DAUPLK] nuk është bërë klasifikimi i tokës bujqësore sipas bonitetit, duke vjelë nga familjet që disponojnë tokë bujqësore me një vlerë joreale të taksës së tokës bujqësore referuar kjo klasifikimit në “Paketën fiskale” vjetore të miratuar nga Këshilli Bashkiak Dropull, në moszbatim të ligjit nr. 9244 datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore” i ndryshuar; VKM nr. 121 datë 17.02.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna/Bashki” i ndryshuar pika IV, si dhe paketës ligjore mbi administrimin e tokës bujqësore.

- Nga analiza e debitorëve, rezulton se në Bashkinë Dropull nuk janë zhvilluar takime të GMS ku të trajtohen problematikat për (pa) mundësinë e vjeljes së detyrimeve të debitorëve problematikë, dhe si rrjedhojë në mungesë të një analize të mirëfilltë, nuk ka një plan masash konkrete për arkëtimin e tyre.

(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2, faqe 46-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të përditësojë planin periodik dhe vjetor të punës për të siguruar vjeljen brenda afateve të përcaktuara të taksave dhe tarifave vendore të vitit ushtrimor si për familjarë ashtu dhe për biznesin, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 7,908,626 lekë, nga e cila: vlera 6,823,850 lekë për 947 debitorët familjarë dhe 1,084,776 lekë për 14 debitorët e biznesit;

1.2 Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit të Ujërave, Pyjeve, Livadheve dhe Kullotave të marrë menjëherë masat për klasifikimin e tokës bujqësore sipas bonitetit, me qëllim vjeljen e taksës nga familjet që disponojnë tokë bujqësore me vlerën reale sipas kategorisë së përcaktuar në Paketën fiskale të miratuar në Këshillin Bashkiak Dropull.

Menjëherë dhe në vijimësi.

C. MASA DISIPLINORE

C.1 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Dropull, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore **për 6 punonjës**, si më poshtë:

- a- “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, germa (c) e nenit 58, për 2 punonjës;**

1. Znj. Th.P., me detyrë Drejtor i Kabinetit, për problematikat e konstatuara gjatë ushtrimit të pozicionit të punës me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe buxhetit për periudhën deri në 31.10.2023, në cilësinë e nëpunësit zbatues, për parregullsitë e konstatuara në hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit dhe mos ndjekjen për zbatimin në masë të plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, për mangësitë e konstatuara për vënien në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1.; Udhëzimeve përkatëse të tij. (Trajtuar më gjerësisht në pikat 1, 2 dhe pikën 4, faqe 46-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

2. Znj. J.V., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të financës deri në 31.10.2023 dhe Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe buxhetit për periudhën nga 01.11.2023 e në vijim, në cilësinë e nëpunësit zbatues, për parregullsitë e konstatuara në hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit dhe mos ndjekjen për zbatimin në masë të plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, me detyrë Drejtor i Buxhetit dhe Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues për parregullsitë e konstatuara në hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit, mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2023, për mos pajisjen me dokumentacion pronësor të aktiveve afatgjata, regjistruar në Pasqyrat financiare të Njësisë, mos ngritjen e komisioneve për verifikimin e disa zërave të aktiveve të PF, mos reflektimin e aktiveve të kaluara me VKM përkatëse në PF, mos mbajtjen me bartës informatikë të të dhënave kontabël. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 pika 1 dhe 2. me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35, Kreu VI, me Ligjin nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 11 dhe nenin 15, me ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 9 dhe 12, Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1., Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 kreu IV, pika 74, me Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin e MFE nr. 8”, datë 9.3.2018 pika 2.1. (Trajtuar më gjerësisht në pikën 2 dhe pikën 3, faqe 97-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

b- “Vërejtje”, germa (a) e nenit 58, për 4 punonjës;

1. Z. K.L., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të buxhetit për parregullsitë e konstatuara në hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit. (trajtuar më gjerësisht në pikën 2 dhe pikën 3, faqe 97-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

2. Zj. L.Xh., me detyrë Drejtore e Drejtorisë të të Ardhurave vendore për mospërditësimin e planit vjetor dhe periodik të punës me masa efektive për vjeljen në vlerë të plotë dhe në afat të taksës dhe tarifës vendore dhe arkëtimit të debisë së prapambetur të 5 subjekteve problematike. (Trajtuar më gjerësisht në pikën 2 dhe pikën 3, faqe 97-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

3. Zj. J.M. Përgjegjëse në Drejtorinë të të Ardhurave vendore për moszbatim të plotë të detyrave funksionale përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të bashkisë lidhur me mungesën e analizës mbi vjeljen e taksës dhe tarifës vendore pa krijuar detyrime të reja dhe arkëtimit të debisë së prapambetur të 5 subjekteve problematike. (Trajtuar më gjerësisht në pikën 2 dhe pikën 3, faqe 97-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

4. Z. Ll.N. Drejtori i DAUPLK (larguar nga puna) për mos kategorizim të tokës bujqësore familjeve që e disponojnë, duke sjellë si pasojë vjelje të taksës në vlerë joreale sipas paketës

fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak. *(Trajtuar më gjerësisht në pikën 2 dhe pikën 3, faqe 97-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT